ÇMIMI: 500 LEKË (5 EURO) | (NR: 05)
JANAR 2022
www.newsbomb.al

# NEWSBOMB.al



100 MINUTAT E ANKTHIT. DEBATET MES BASHËS DHE DEPUTETËVE PËR POLICINË. KUSH ISHTE ME BASHËN NË SELI DHE ATA QË MUNGUAN

GENTI ME BERISHËN E ADELA ME BASHËN RRËFEJNË MINUTAT E TMERRIT, NJËRI PËRBALLË POLICISË, E TJETRA BRENDA SELISË

BATUTA ME TË QESHURA E DEM DOLLAPIT ME KRYEPROKUROREN ELISABETA IMERAJ PAS NGJARJEVE TË DHUNSHME

ERALD KAPRI TREGON PËRJETIMIN PERSONAL NË PROTESTË: HISTORIA NUK KA FALUR ASKËND QË KA DORËZUAR KËSHTJELLËN NGA BRENDA

PROTESTUESI ME PLUMB NË KOKË QË NGA RRËZIMI I BUSTIT TË ENVERIT NË '91: MAJË SHKALLËVE PËR TË NDËRRUAR POÇIN E DJEGUR

# DITA E THYERJES FINALE

*Në brendësi:*

SHTETI PA BREKË/ SKANDALI NISI ME TATIMET, PATRONAZHISTËT, PËRFUNDOI TE RROGAT



GARA NË FSHF/ DUKA-SHAKOHOXHA, DASHURIA QË U MBYLL ME URREJTJE

MARGARITA XHEPA SEZONI I NJË DAME DASHURIA PËR FILMIN FAMILJEN E LUSHNJEN



DOSSIER/ VASILIQIA HISTORIA E JETËS SË ZONJËS ME KËSHTJELLË DHE ME KISHË


Fiori di Bosco
KOMPLEKSI REZIDENCIAL
SHTËPIA KU DUA TË JETOJ!
GJENI
HAPËSIRËN
IDEALE PËR
Biznesin tuaj!
VENDNDODHJE STRATEGJIKE.
AMBIENTE BIZNESI ME HIPOTEKË.
INFRASTRUKTURË E PËRFUNDUAR.
Rr.
Don
Bosko
TIRANË
DON BOSKO, TIRANË
+355 69 20 73 531
SHITJET@MATRIXKONSTRUKSION.COM
WWW.MATRIXKONSTRUKSION.COM
MATRIX
KONSTRUKSION
25 VITE
Shaping life!

# EDITORIAL

# BASHA, KY FRANK UNDERWOOD NË SHTËPINË E DEMOKRATËVE

Në "House of Cards" (Shtëpia e kartave) Francis "Frank" Underwood, personi që askush nuk e merrte seriozisht në nivelet e larta të politikës, tregoi se ç'është i aftë të bëjë një person ambicioz, i heshtur, që nuk i tregon kartat e veta, nuk i tradhëton emocionet (nëse ka) dhe godet atëherë kur ti s'e pret, ku miqësia ia lë vendin kalkulimit politik dhe në finale qëllimi arrihet me çdo kusht.

Lulzim Basha, për të cilin Jozefina Topalli tha dikur "mos flisni mor marrina se nuk bëhet Luli kryetar", mëngjesin e datës 11 janar përjashtoi përgjithmonë nga partia Sali Berishën dhe tetë persona të tjerë. Po ashtu pezulloi "me efekt të menjëhershëm nga anëtarësia", praktikisht shkarkoi, edhe nëntëmbëdhjetë të tjerë. Në total, me një të rënë të lapsit, largoi njëzet e tetë figura demokrate me peshë të padiskutueshme politike. Ç'të thuash tani për Lulin? Që marrinë nga madhështia një hap e ndan?



Nga ENDRI XHAFO

Le ta marrim pak më shtruar. Nëse i huazojmë Frank Underwoodit ftohtësinë dhe zhvishemi nga emocionet, nuk mund të mos i njohim zotit Basha një meritë për mënyrën si e përballoi protestën. Çuni "skorpions" me flokët me brilantinë, njeriu që qesh, tregoi se mund të jetë edhe burrë. Po, po! Ai diti të organizojë atë pjesë të partisë që ka besnike në një akt rezistence të pamendueshme dhe, edhe me ndihmën e policisë, i bëri ballë për gati tre orë demokratëve që kishin shkuar për ta nxjerrë nga zyra. Zoti Basha e tërhoqi zotin Berisha në një kurth dhune, si për të hequr një paralele mes trumpistëve të Uashingtonit dhe trumpistëve të Tiranës, që, në finale, sulmi i 8 janarit i Tiranës t'i ngjante atij të 6 janarit mbi Capitol Hill.

Pasoja e parë direkte e dështimit në Tiranë, ishte largimi nga Shqipëria i trumpistes Evi Kokalari. Për të njoftuar rikthimin në Amerikë, mjaftoi një status i shkurtër në Facebook.

Lulzim Bashën nuk mund ta qortojë kush pse deshi të emancipohej politikisht, duke u çliruar nga hija e Doktorit. Treçereku i analistëve të Tiranës kishin 8 vjet që i kërkonin "të vriste babën". Dhe, edhe nëse nuk është bashkë-sponsor direkt në vendimin e shpalljes *non grata* të Sali Berishës, duke u ankuar ndaj tij në ambasadë me "fakte e prova", Lulzim Basha ka gisht indirekt në këtë akt përmes nevojës urgjente të ndërkombëtarëve për t'i hequr kryetarit të PD-së çdo alibi politike se "nuk më lë Doktori". Nga sot e tutje, vendime si djegia e mandateve apo mospjesmarrja në zgjedhje, do të jenë përgjegjësi vetëm e kryetarit "Luli Basha".

Sa i takon zotit Berisha, tani që nuk e largoi dot zotin Basha, çdo demokrati i lind e drejta t'i thotë: "O Doktor, po si mund të largosh Edin, kur nuk largove dot Lulin"? Sikur vetëm për këtë, Doktorit nuk i shkon përshtat një forcë tjetër politike! Sikur vetëm për këtë, bie argumenti i dy selive si zgjidhje provizore, propozuar me sarkazëm nga Edi Rama. E vetmja gjë që i mbetet Doktorit, është të thotë se e mësoi mirë nxënësin e vet. Dhe, ironike, të ndihet krenar për këtë.

NEWS BOMB .al
JANAR 2022

# PËRMBAJTJE



DITA E THYERJES FINALE 08

16 PËRJETIMI I NJË PABESIE, SI E PASHË 8 JANARIN E PROTESTUESVE!
Nga ERALD KAPRI

18 FATMIR MERKOÇI: ME PLUMB NË KOKË, MBI SHKALLË PËR TË FOLUR ME BASHËN
Nga XHON METAJ

22 RIVENDOSJA E PLURALIZMIT
Nga AFRIM KRASNIQI

24 BANAKING - SI VETË EMRI HISTORI ME KOKAINË NGA SUPERPRODHIMI
Nga SOKOL BREGU



ZGJEDHJET NË FSHF 52

**MOND DUKA - SHAKOHOXHA**
DASHURIA QË U SHNDËRRUA NË URREJTJE



NEWSBOMB.al

REVISTA NEWSBOMB.AL JANAR 2022 / NO 5

Copyright @2021, të gjitha të drejtat e rezervuara. Prodhim i kompanisë mediatike Newsbomb.al shpk, me NIPT L42417011Q. Revista publikohet një herë në muaj, 84 faqe me ngjyra. Çdo artikull, investigim, fotografi, ngjarje aktuale politiko-ekonomike-sociale si dhe argëtimi dhe fashion, janë pronë e Newsbomb.al dhe nuk lejohen të merren pa lejen e autorit dhe kompanisë për përdorim të mëtejshëm dhe publikim të paautorizuar.





**SHTETI PA BREKË**

Nga FATOS ÇOÇOLI

28





62

MARGARITA XHEPA, SEZONI I NJË DAME

Nga SUADA DACI

32 SI U ZHDUK SERVERI I TATIMEVE NË 2013

Nga NIKOLETA KOVAÇI

42 OSE S'KANË LEKË, OSE S'KANË MEND!

Nga LUELA MYFTARI

56 FUTBOLL, TEATËR DHE LUFTË GJERMANO-SHQIPTARE

Nga ERGYS ALUSHI

68 TË VARFËR NË LETRA TË PASUR NË JETË, ZBULOHEN RROGAT E FUTBOLLIT ELITAR

Nga RETIN TOKA

74 PAS FESTAVE SI TË DUKENI ORIGJINALË E TË BUKUR

76 VIT I RI, STIL I RI

Nga SUADA DACI





**SEVDAJA E ALI PASHËS PËR VASILIQINË**

Nga DORIAN KOÇI

46



NEWSBOMB.al

**JANAR**
2022




Download on the App Store

Available on the Google Play



## ABONOHU!

POSTA SHQIPTARE:

+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbombal:

+355 69 67 32 020

abonime@newsbomb.al

ADRESA:
Rruga: “Emin Duraku”,
Hyrja 1, Apartamenti 14, Tiranë

Mobile: +355 69 922 2201 | +355 69 922 2202

E-mail: info@newsbomb.al

NEWSBOMB SHPK
NIPT: L42417011Q



NEWSBOMB.al

### DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ANILA BASHA

### BASHKËPUNUAN

AFRIM KRASNIQI

FATOS ÇOÇOLI

ENDRI XHAFO

LUELA MYFTARI

ILIR XHAFAJ

ERALD KAPRI

SOKOL BREGU

NIKOLETA KOVAÇI

XHON METAJ

DORIAN KOÇI

ERGYS ALUSHI

RETIN TOKA

LINDA GURI

SUADA DACI

KADRI VOKOPOLA

### GRAPHIC DESIGN

ALTIN ALIAJ

Rolling Hills 2
Luxury Residences

Arkitekturë neoklasike - Ndjenjë unike e trashëgimisë, bukurisë dhe elegancës!




Rolling Hills 2 – Luxury Residences është projektuar enkas për ju dhe të dashurit tuaj, për një jetesë autentike dhe të shëndetshme në ajër të pastër. Vilat rezidenciale janë të dizenjuara në harmoni me relievin natyror dhe ofrojnë pamje të mrekullueshme të lindjes dhe perëndimit të diellit.

**NA KONTAKTONI:**
**+355 69 801 4999 | sales@balfinrealestate.al | www.balfinrealestate.al**


FRANC ZHURDA

# DITA E THYERJES FINALE

Nga NEWSBOMB.AL

Oborri i Partisë Demokratike me një pamje impresionuese për shkak të hapësirës, shkallëve, një dekori me flamuj të mëdhenj, dy lulishteve të vogla në anë dhe pemëve gjigande që sfidojnë gjelbërimin në zhdukje në qytet, dhe një lloj madhështie që e ofron godina e arkitekturës së regjimit komunist ndërtuar për lavdinë e propagandës së ushtrisë së kohës, mesditën e 8 janarit u shndërrua në një shesh lufte, ku u përzien rreckat e djegura të ambicies, armiqësisë, xhama të thyer, shkopinj, gurë, zemëratë, e gjitha mbuluar nga një mjegull helmuese e gazit lotsjellës. Ajo kthinë përpara Parlamentit, buzë Bulevardit Gjergj Fishta, në mes të Xhamisë së madhe dhe Katedrales Katolike, që prej 9 vitesh është shtëpia e demokratëve, ziente nga tensioni që ka kulmuar mes Lulzim Bashës dhe Sali Berishës. Nuk ka paqe. Përplasja e brirëve e 8 janarit, pas shumë betejave që nisën me 9 shtator kur Basha përjashtoi liderin historik nga Grupi Parlamentar, pasi ai u shpall non-grata nga SHBA, ishte deri më tani më shkatërrimtarja, por me gjasë jo e fundit.

Nga rastet e rralla, ndoshta unike në histori, kur më një anë kryetari i zgjedhur në Opozitë vendos dyer të blinduara hekuri për t'u mbrojtur nga anëtarët e revoltuar të partisë së tij, e ku më anë tjetër, mbështetësit e ish-kryetarit që mëton sërish të marrë drejtimin, vijnë dhe kërkojnë të marrim zyrat me forcë e instrumenta dhune.

**100 MINUTAT E ANKTHIT**

Shenjat e para të dhunës u shfaqen diku rreth orës 11 e 20, me goditjen e derës krye-



Çfarë ndodhi në selinë e partisë më të madhe opozitare, në 100 minutat e ferrit. Detaje të panjohura deri më tani, dhe një parashikim për të ardhmen e PD pas 8 janarit të dhunshëm. Newsbomb sjell për lexuesit mendimet e dy të rinjve demokratë, që ishin ndarë atë ditë. Adela në godinë, Genti në oborr.

sore të PD, kur ende nuk ishin mbledhur gjithë mbështetësit, ndërsa Sali Berisha nuk kishte dalë nga banesa e tij. Skenat me thyerje xhamash, me përpjekje spartane për t'u ngjitur në katin e dytë ku gjendeshin Basha me përkrahësit e tij, me shkallmim të dyerve të blinduara, dhe me kundërpërgjigje nga brenda me sprajt djegës për sytë, apo hedhje të sendeve të forta, zgjatën deri në orën 12 e 59 minuta, kur ndërhyri policia, me skalionet e pozicionuara ngjitur me PD, në pjesën e Parlamentit.

Kur protestuesit po lëshonin në tokë edhe derën e dytë të blinduar e pas kësaj nuk do të kishte më pengesa për t'u ngjitur aty ku ishin mbledhur dinjitarët e kontestuar prej tyre, PD zyrtarisht reagoi duke i bërë thirrje institucioneve të ndërhyjnë e të zbatojnë ligjin.

## DIBRA, I PARI DHE I FUNDIT TAKIM PËR BASHËN

Përpara fundit të vitit, në një nga mbledhjet me drejtues të PD, Lulzim Basha la porosi që të nisnin takimet në terren me demokratët dhe strukturat. Zhvillimet e fundit, konflikti me Berishën, duket se i kanë mbyllur zyrtarët, kryesinë e deputetët, në seli.

Basha tha se ai do të shkonte i pari pranë demokratëve.

Dhe u bë takimi i Dibrës. I pari, por dhe i fundit. Kjo dalje në terren, nuk shkoi sikurse mendohej të ishte. Pati kontestime, denoncime, dhe burime tregojnë se ngjalli po ashtu pakënaqësi.

Basha ka mbajtur më afër Xhemal Gjunkshin, se sa shefin politik të Qarkut, Xhelal Mziun.

Pakënaqesi që janë përmendur gjatë, edhe pse jo në publik. Por asnjë drejtues tjetër i lartë i PD nuk zhvilloi takime të ngjashme. Madje, as Basha vetë. Së fundmi, është folur sërish për të shkuar në bazë.

Por kjo mbetet një sfidë e një mision i vështirë.

Nëse takimet nuk do të menaxhohen e kontrollohen si duhet, ato mund të shndërrohen në ngjarje ku mbështetësit e Berishës në çdo qytet e rreth, kanë mundësinë të shfryjnë emocionet e zemëratën e tyre, ashtu siç dinë ata.

"Sali Berisha po rrezikon jetën e dhjetra demokratëve me aktet e dhunës së sotme. Mercenarët nën urdhrat e tij po sulmojnë godinën e PD duke vënë në rrezik real jetën e drejtuesve më të lartë të PD në qendër dhe në rrethe dhe të dhjetra demokratëve të tjerë. Gjakderdhja duhet ndalur nga institucionet ligjzbatuese. I bëjmë thirrje institucioneve të ndërhyjnë për të shmangur viktimat e dhunës së Sali Berishës mes demokratëve", ishte njoftimi që u shpërnda në media nga zyra e shtypit.

Burime tregojnë për Newsbomb, se para këtij reagimi ka patur një debat të fortë të disa bashkëpunëtorëve me Lulzim Bashën. Kryetari i PD po hezitonte që të lajmërohej policia, duke menduar se do të akuzohej për ndihmë kërkuar Ramës, derisa disa deputetë aty u shprehën se ata vetë do ta kontaktojnë z.Gledis Nano, pasi situata po dilte jashtë kontrollit dhe mund të kishte pasoja të paparashikueshme. Mes atyre dhjetra rezistentëve, kishte edhe deputete apo funksionare gra. Kjo e bënte edhe më alarmante situatën. Besohet se në këto momente është telefonuar drejtuesi i uniformave blu. Ora kishte kaluar 12 e 50 minuta. Pas këtij komunikimi, në 12 e 59 minuta, makina me ujë u fut në oborrin e PD, e po ashtu trupat me skafandra e të mirëpajisur. Për disa sekonda, protestuesit u larguan nga oborri, dhe u derdhën në bulevardin para PD. Gazi lotsjellës i përdorur nga policia ishte i papërballueshëm. Në kaos e sipër, kur mjegulla kishte mbuluar gjithë atë territor, nga kamerat që vijonin të transmetonin live, shquhet Sali Berisha me ata pak vetë që i qendrojnë gjithnjë afër, duke vendosur një maskë anti-gaz. Pas pak çastesh, edhe ai largohet nga selia e PD.

Më tej, nisin të dalin mbështetësit e Bashës, të cilët njësoj po vuanin sasinë e madhe të



Që do të ishte një ditë e ngarkuar, e zjarrtë, dhe aspak e qetë, kjo u mësua shpejt. Tensioni ishte i lartë mes demokratëve që nisën të grumbullohen në oborrin e selisë pas orës 10 të mëngjesit. Kishte kaluar ora 10 e 30 kur aty u shfaq Roland Bejko, i cili tentoi të futej në godinë nga dera e aksesueshme përbri parlamentit.

lëndës së hedhur, e cila depërtoi në godinë, duke qenë se tashmë nuk kishte më dyer e dritare për ta penguar.

Në këto minuta ankthi, Newsbomb ka mësuar se garda që e ka për detyrë mbrojtjen e Lulzim Bashës, ishte gati duke vënë në zbatim planin e evakuimit. Nëse do të kishte vonuar edhe pak ndërhyrja e policisë, kryetari i PD do të nxirrej nga godina. Nuk dihet me saktësi se në cilën rrugë, e në çfarë mënyre, por oficerët në kordinim të vazhdueshëm me komandantin e Gardës, i cili e vizitoi vetë selinë, u vunë në lëvizje dhe po bëheshin gati ta merrnin personalitetin, me ose pa konsensusin e tij.

Burime serioze i thanë Revistës Newsbomb se efektivët e Gardës ishin të pajisur me disa bombula të vogla sprajti, dhe lënda tjetër që është hedhur ndaj protestuesve, ishte ajo e fikëseve të zjarrit.

Lulzim Basha dhe drejtues të tjerë të lartë, besohet se kishin disa ditë që po kalonin gjithë kohën në godinë, madje edhe kanë fjetur aty netët e para 8 janarit.

### SHENJAT E PARA TË TENSIONIT

Që do të ishte një ditë e ngarkuar, e zjarrtë, dhe aspak e qetë, kjo u mësua shpejt. Tensioni ishte i lartë mes demokratëve që nisën të grumbullohen në oborrin e selisë pas orës 10 të mëngjesit. Kishte kaluar ora 10 e 30 kur aty u shfaq Roland Bejko, i cili tentoi të futej në godinë nga dera e aksesueshme përbri parlamentit. Turma reagoi me nervozizëm, dhe e nxori sekretarin dhe anëtarin e kryesisë me forcë në rrugë. Bejko ishte i fundit që po vinte. Deputetë, drejtues të PD, mbështetës të Bashës, ishin futur në godinë shumë më herët.

Bejko rrezikoi të bëhej shembull, e të ushtrohej dhunë ndaj tij, dhe ishin pikërisht dy tre protestues që e shpëtuan nga druri, duke e përcjellë deri afër Katedrales. Ai u shpreh më vonë i indinjuar dhe tha e kjo ishte një vepër e Berishës.

### REAGIMET E PARA, DHUNA NË MES..

Duket se Lulzim Bashës nga kjo betejë me ato pasoja katastrofike mesditën e 8 janarit, i kishte ardhur megjithatë një as nën mëngë. Atij i mbërriti falas argumenti se Berisha është dhunues, dhe kërkon të marrë me forcë selinë. E gjitha u pa në sytë e publikut. Kryetari i PD pati pasdite një komunikim me mediat ku e akuzoi Sali Berishës si nxitës të atyre ngjarjeve, dhe se tentativa e tij për gjakderdhje dhe pushtim të godinës,

## DEM DOLLAPI ME PROKUROREN IMERAJ, BATUTA QË SHKAKTOI TË QESHURA

Menjëherë pasi policia mori godinën në kontroll, mbërriti në PD prokurorja e rrethit të Tiranës, Elizabeta Iemraj. Nisën hetimet. U ngritën disa akuza për të dy palët, kryesisht për ushtrim dhune, përdorim të lëndëve të palejueshme, dhe shkatërrim prone.

Një nga momentet më interesante që mbeti në mendjen e të pranishmëve, ishte komunikimi i prokurores me Dem Dollapin, një personazh i njohur në PD, që prej vitesh i gjendet këtaj partie në ditë të vështira.

Duhet thënë se të dy, kanë origjinë të përbashkët nga Tropoja, ndoshta kjo është arsyeja e shkëmbimit miqësor dhe informal.

Sipas dëshmitarëve, Imeraj i është drejtuar atij:

Po ku je o Dem Dollapi!

Dhe militani i PD është përgjigjur:

Ja shefe, këtu ku më ka lënë Sali Berisha, me rujt PD-në.

Ky ka qenë një moment që ka shkaktuar humor dhe të qeshura tek të pranishmit, pas shumë orëve të trishta e të ngarkuara me tension.



**DEPUTETËT QË ISHIN NË SELI ME BASHËN:**

- ENKELEJD ALIBEAJ
- GAZMENT BARDHI
- ERVIN SALIANJI
- GRIDA DUMA
- AGRON GJEKMARKAJ
- FERDINAND XHAFERRI
- GRETA BARDELI
- KASTRIOT PIROLI
- ANDIA ULLIRI
- MERITA BAKIU
- SELADIN JAKUPLLARI
- LEDION NALLBATI
- ERALDA BANE
- SAIMIR KORRESHI
- ARBI AGALLIU
- XHELAL MZIU
- KRESHNIK ÇOLLAKU
- ALFRED RRUSHAJ
- DASHNOR SULA
- LEFTER GESHTENJA
- ZEF HILA
- RAMADAN LIKAJ
- FATION VEIZAJ
- ILDA DHORI
- KASEM MAHMUTAJ
- LINDITA METALIAJ

**DEPUTETËT QË MUNGUAN NË SELI**

- JORIDA TABAKU
- INA ZHUPA
- ORIOLA PAMPURI
- TOMORR ALIZOTI
- FLUTURA AÇKA
- DHURATA ÇUPI TYLI
- HELIDON BUSHATI
- EMILJA KOLIQI
- ELDA HOTI
- ZHENI GJERGJI
- ISUF ÇELAJ

**DEPUETET QË ISHIN ME BERISHËN**

- ALBANA VOKSHI
- FLAMUR NOKA
- AGRON SHEHAJ
- BELIND KELLIÇI
- EDI PALOKA
- BUJAR LESKAJ
- EDMOND SPAHO
- LUAN BAÇI
- LUÇIANO BOÇI
- OERD BYLYKBASHI
- TRITAN SHEHU
- SORINA KOTI



FRANC ZHURDA

e kthim të zyrave në bunker për të mbrojtur interesat personale, kishte dështuar.

Basha tentoi të inkurajojë mbështetësit e tij se ringritja do të ishte e fqishme, dhe shpalli se Berisha ishte braktisur masivisht nga demokratët, ata që e shoqëruan atë ditë e që shkaktuan trazirat ishin vetëm një tufë kriminelësh, sipas tij.

Nga ana tjetër, Sali Berisha akuzoi Lulzim Bashën si shkaktar të dhunës. Ai dhe mbështetësit nxjerrin vazhdimisht pamje ku synojnë të tregojnë se aktet e para dhe hedhja e lëndëve helmuese e sendeve të forta ka ardhur nga brenda godinës, në drejtim të turmës.

Edhe ata folën për kriminelë e mercenarë me precedentë penal që ishin rreshtuar me Bashën.

Kjo çështje, dhuna pra, tanimë është tema e nxehtë me të cilën do të synohet të ndikohet opinioni publik.

Besohet se Lulzim Basha ka informuar partnerët europianë dhe më tej, për çfarë ndodhi dhe i ka furnizuar ata me pamjet e demonstrimit brutal. Në këtë mënyrë, po tenton të bëjë për vete edhe publikun vendas, duke e damkosur ish-kryetarin me një hije që e ka shoqëruar atë në këto dekada, të ushtrimit të forcës.

Sali Berisha synon ta vizatojë Bashën tashmë si pengun e Edi Ramës, që merret në mbrojtje prej tij. Ai thotë se gjithçka ishte e kordinuar mes tij dhe Kryeministrit. Dhuna ndaj protestuesve, dhe plagosja e disa prej tyre, i faturohet kryetarit të PD.

Në këto ujëra vijon debati, shemria, ultimatumet, ku secila palë kërkon t'ja lërë në kurriz tjetrës, atë që ndodhi me 8 janar. Një ngjarje, që në shumicën dërrmuese të njerëzve, konsiderohet e shëmtuar.

Eshtë e qartë se ish-kryeministrit nuk i shkoi gjithçka sipas planit. Dhe kjo u pa tek fakti se ai vonoi shumë ta shpallte se kur do të ishte lëvizja e radhës. Ka pohuar në publik se protesta ishte një sukses, pasi shkallmoi dyert,

por e ka pranuar se nuk ja arriti qëllimit final.

Në një intervistë në Euronews, të hënën në mbrëmje, më 10 janar, dhe të nesërmen në ABC news, ai u shpreh se në protestën e radhës, ata do të ishin të pajisur më mirë, e do ta realizonin, atë që cilësohet si çlirim i godinës, dhe rikthim i demokratëve në shtëpinë e tyre.

Shtoi se do të jetë më diverse dhe më e pasur me elementë.

Nuk ka qendruar aspak duarkryq Lulzim Basha. Ai ka thelluar kursin e ndarjes një herë e mirë nga Berisha e mbështetësit e tij, kur mëngjesin e të martës së 11 janarit, shpalli se kryesia kishte përjashtuar përjetësisht nga PD liderin historik, dhe po ashtu kishte vendosur të mos njihte më si anëtar të saj, atë që konsiderohet si Komisioni i Rithemelimit të PD-së, mbi 20 deputetë dhe ish-drejtues të lartë të kësaj force politike.

### A KA ZGJIDHJE KRIZA?

Ndokush që besonte se protesta e 8 janarit do të sillte një kulm prej nga ku më pas do të vinte zgjidhja, është zhgënjyer. Tensioni është thelluar, palët janë ende edhe më shumë në armiqësi, sjelljet dhe qëndrimet janë radikalizuar.

Lulzim Basha pretendon se është legjitim, dhe se ai ka shumicën e demokratëve. Po ashtu, ai ka forumet drejtuese. Sali Berisha mbron tezën se Basha është shkarkuar me 18 dhjetor, nga 44 mijë anëtarë të PD. Asnjëra palë nuk e njeh tjetrën.

Dhe, askush nuk ka një parashikim se si do të zgjidhet kjo çështje.

Por fakt është se pas rizgjedhjes në korrik, pas humbjes së zgjedhjeve të 25 Prillit, Basha nuk ka më besimin e anëtarësisë. Edhe ai vetë e di këtë.

Nga ana tjetër, Sali Berisha, edhe pse i shpallur non-grata nga SHBA, dhe i kontestuar nga një pjesë e mirë e opinionit publik, mbetet padyshim një realitet në PD. I pamohueshëm. Një faktor vendimtar. Në këto kushte, mendjet e kthjellëta e racionale bien dakort se ka vetëm një shteg nga mund të dilet prej kësaj krize me shumë shtresa e të ngatërruar nga të gjitha anët.

Eshtë vetëm vota e anëtarësisë.

PD do të mund të ketë shpresa të ribashkohet edhe një herë, të pajtohet mes vedi, vetëm nëse do të vendosë që tani, të ndjekë hapat që do të sillnin një proces votimi të drejtë, të hapur e transparent, me garancinë e të dy palëve.

Sot duket e pamundur që Basha dhe Berisha ta kenë këtë vullnet apo këtë vizion që të japin e marrin mes tyre. Por ndoshta një grup themeluesish, personalitetesh në PD, të pranueshëm nga të gjithë, do të kishin forcën për të negociuar e për të ofruar në tryezë një platformë.





## RRËNIM I GODINËS, APO I IMAZHIT?

*Pas 8 janarit të palavdishëm, asnjë demokrat nuk ka arsye të ndihet krenar. Dëmi i shkaktuar në godinë, nuk është asgjë krahasuar me atë që i ka ndodhur imazhit. PD ka ofruar një shfaqje të shëmtuar me të cilën mund të argëtohet vetëm Edi Rama, e rilindja. Shqipëria megjithë problemet që ka, me gjithë tensionin social e padrejtësitë në rritje, me gjithë gjendjen shpërthyese, sërish është në një kurs normaliteti. Qytetarët nuk e dëshirojnë dhunën.*

*Pas zhvillimeve të 8 janarit, sido që të shkojë puna në PD mes palëve, kundërshtari do t'i tregojë ata me gisht, dhe e ka gati fushatën negative në përplasjen më të parë elektorale që do të ndodhë. Do të mjaftonin disa klipe nga transmetimi i asaj dite.*

*Demokratët edhe pa ndodhur kjo ishin në një gjendje dëshpërimi, duke qënë se nuk fitojnë asnjë palë zgjedhje, që prej atyre të bashkisë së Tiranës, në vitin 2011.*

*Tanimë, do të duhet të shpenzojnë shumë energji, të paimagjinueshme, jo për të konkuruar me rivalët, por për t'u rikthyer në normalitet. Çfarë oferte mund të jenë ata për të rinjtë, për shoqërinë, pas asaj që ndodhi me 8 janar.*

*Një përpjekje e mundimshme do t'i duhet Partisë se solli pluralizmin, të mbijetojë e të kthehet në kushtet që të jetë një alternativë. Nëse kanë mbetur ende fuqi mes demokratëve, pas kësaj, lypset të bindë shqiptarët se ajo është gati dhe meriton të rikthehet në pushtet.*

*Kjo, poqese palët do të gjejnë sado vonë një zgjidhje, një mirëkuptim. Çka sot duket shumë e largët. Siç po diktojnë zhvillimet, do të kemi dy parti pas 8 janarit. Dhe në këto kushte, shanset që njëra prej tyre të bëhet shumicë në vend, janë pothuajse të pamundura.*

*Kjo edhe pse pakënaqësia ndaj qeverisjes është në rritje, edhe pse sërish në ditë jo të mirë siç ishte 25 prilli, PD arriti të marrë 620 mijë vota. Për ata me kokë të esëllt, gjërat janë të qarta. Lulzim Basha nuk e ka sot besimin e anëtarësisë e njerëzve, dhe insistimi i tij për të qendruar, vetëm sa i përkeqëson kreditet në publik. Eshtë po aq e qartë, se Sali Berisha, nuk do ta ketë konsensusin e pjesës më të madhe të shoqërisë, çka e bën të pamundur rikthimin në pushtet.*

*Vetëm një gjë që mund të dalë në mes, nga kjo përplasje e egër, e paprincipte, tej çdo kufiri, mes të dyve, mund të sjellë një shpresë, e një optimizëm të regëtijë akoma mes demokratëve. Po kjo kërkon vizion dhe guxim, e sakrificë nga ata që aktualisht kanë në dorë vendimmarrjen.*







# DY TË RINJ, DY DEMOKRATË, NË KAMPE TË NDRYSHME

Adela Qemali, është një e re demokrate nga Elbasani, e angazhuar në PD qysh herët, dhe tanimë anëtare e Këshillit Kombëtar. Me 8 janar, ajo u nis drejt Tiranës, për një mbledhje të thirrur atje. Kishte një si kob se diçka do të ndodhte. Ajo është kundër dhunës. Genti Çela është nga të rinjtë e spikatur të demokratëve të Pogradecit. Një djalë i lexuar, që nuk ka munguar asnjë ditë në PD. Ai u nis me 8 janar drejt Tiranës, i qartë siç thotë, për të rikthyer legjitimitetin, dhe për të rikthyer shtëpinë e lirisë tek demokratët. Edhe ai është kundër dhunës. Adela ishte brenda në seli në ato orë ferri, Genti ishte jashtë në oborr.

Revista Newsbomb, ka biseduar me të dy këta protagonistë, që sigurisht meritojnë nga partia e tyre më shumë se sa ajo që u ofrua me 8 janar.

## GENTI ME BERISHËN: NË SELI PËR KTHIMIN E PD TE DEMOKRATËT



**Newsbomb: Si nisi dita atë 8 janar. Pra mëngjesi në Pogradec dhe ardhja në Tiranë?**

**Genti Çela:** Dita e 8 Janarit, nisi si fillimi i kthimit të PD në shinat e opozitarizmit. Ky ishte qëllimi primar i demokratëve të cilët pas një proçesi thellësisht demokratik, ku vlen të theksohet Kuvendi Kombëtar i datës 11 Dhjetor dhe më pas ratifikimi i datës 18 Dhjetor ku me parimin një anëtar një votë, z.Basha u shkarkua. Pas këtij proçesi, me një pjekuri politike, u la një afat në të cilin z. Basha do të duhej të lironte selinë. Vlen të theksohet fakti se herë pas here, nga personalitete të së djathtës, brenda dhe jashtë vendit, z.Basha i'u propozua kalimi në një garë për të shmangur kështu, përplasje apo përçarje të mundshme. Mëngjesi i 8 Janarit, e përsëris, ishte dita kur demokratët donin t'i jepnin fund, pushtimit të selisë nga të ngujuarit brenda mureve.

**Newsbomb: Cili ishte motivi, pse ishe në atë protestë. Pse po vije?**

**Genti Çela:** Urgjenca për të parë një opozitë të bashkuar dhe reale përballë pushtetit, të papërlyer dhe të paakuzuar për flirte financiare me qeverinë, është kryefjala e çdo motivi të aksioneve opozitare. Shurdhësia e kupolës drejtuese së PD ndaj anëtarësisë, ndaj shumicës së padiskutueshme, bëri të mendoj se duhet prania e çdo demokrati apo njeriu të lirë që ka vendosur të qëndrojë i tillë, i lirë dhe përballë keqqeverisjes të vendit më të varfër në kontinent.

**Newsbomb: A e prisje atë që ndodhi?**

**Genti Çela:** Absolutisht jo! Duke qenë se shkova të protestoj para shtëpisë sime politike, nuk mund të prisja se ndaj meje dhe mijëra demokratëve do të hidhej gaz helmues, shkopa dhe dyer të blinduara. Ishte trishtim dhe fyerje që ndaj anëtarësisë së PD, policia ushtroi dhunë, me kërkesë të z.Basha.

**Newsbomb: Nga mendoni se buroi kjo dhunë?**

**Genti Çela:** Protestuesit, me bindje më të plotë, ishin në formën më paqësore, si dikush që shkon në shtëpinë e vet. Brenda selisë së PD, ishin strehuar grupe mercenare, ardhur nga treva të tjera, për të dhunuar demokratët. Falë medias, sot për publikun, kemi pamje të qarta të shkopinjve, karrigeve dhe gazit që vinte nga brenda selisë.

**Newsbomb: Si e perjetove më pas, kur e gjitha mbaroi?**

**Genti Çela:** I trishtuar të them se, gazin të cilin kam provuar nga pushteti, e kisha harruar. Atë të datës 8 Janar, e vështirë se do e shlyej ndonjëherë nga kujtesa. Ishte më i hidhuri, për nga rrethanat, vendi dhe për nga ata që e kërkuan.

Skenat horror të njerëzve që kërkonin ndihmë, me frymëmarrje të bllokuar, sy të irrituar nga helmi, ishin pamjet e një tradhëtie.

Pamjet e një shfaqjeje të hapur dhe lakuriqe se dyshimet e vazhdueshme të një bashkëpunimi Rama-Basha, u faktuan para syve të të gjithëve.

**Newsbomb: Me çfarë mendimesh u ktheve në shtëpi?**

**Genti Çela:** Si mund të ndihet dikush kur dhunohet dhe helmohet nga dikush për të cilin ka punuar ta bëjë kryeministër? Thellësisht i dëshpëruar, por në anën tjetër i qartë për skemat që luhen në kurriz të demokratëve dhe që kanë kunatizuar Partinë Demokratike.

**GENTI ÇELA:** Protestuesit, me bindje më të plotë, ishin në formën në paqësore, si dikush që shkon në shtëpinë e vet. Brenda selisë së PD, ishin strehuar grupe mercenare, ardhur nga treva të tjera, për të dhunuar demokratët



**Newsbomb: A do shkoje sërish në protestë?**

**Genti Çela:** Tërheqja dhe neutraliteti në kohë krize, është fatale për dinjitetin e kujtdo njeriu të lirë dhe që ka vendosur të jetojë këtu. Shqiptarët duhet të derdhen shesheve, duke marrë në dorë fatet e tyre, duke u angazhuar në partitë tona politike dhe duke marrë përgjegjësi.

**Newsbomb: Çfarë mendon se do të ndodhë me PD?**

**Genti Çela:** Optimist për të ardhmen e afërt. Edhe nëse zëri i shumicës do të refuzohet të dëgjohet nga ishujt e mosnjohjes së realitetit, nga babilonia e humbjeve, shumica do të thotë fjalën e vet, për të mos lejuar që PD, të mbetet vegël e vogël e pushtetit. Partia Demokratike ka lindur si frymë, me qëllim të vetëm primar lirinë.

Dhe liria funksionon!



## ADELA KRAH BASHËS: DEMOKRATËT S'DUAN DHUNË, DO BASHKOHEN SËRISH

**Newsbomb: Si nisi dita atë 8 janar. Pra mengjesi në Elbasan, dhe ardhja në Tiranë, me çfarë mendimesh u nise?**

**Adela Qemali:** Dita nisi si zakonisht duke u përgatitur për të shkuar në Selinë Qendrore në Tiranë, pasi ishim lajmëruar disa ditë më parë për mbledhjen që do zhvillohej në orën 11. Në seli kam mbërritur në oren 9:45, në oborrin e së cilës ishin disa demokratë.

**Newsbomb: Cili ishte motivi, pse ishe aty. Pse po vije?**

**Adela Qemali:** Siç e përmenda dhe më lart, ne Anëtarët e Këshillit Kombëtar, dhe jo vetëm, ishim lajmëruar për një mbledhje nga Kryetari i PD, z.Lulzim Basha me rend dite: "Për ndarjen e detyrave në aksionin opozitar kundër Edi Ramës".





Gjatë zhvillimit të mbledhjes u dëgjuan zhurma që vinin nga kati i parë, ku mund të dëgjonim sharje, ofendime, mallkime adresuar jo vetëm Kryetarit por edhe ndaj çdo anëtari që ndodhej brenda në mbledhje. Kur po qëndronim në sallën e mbledhjes, papritur xhami i dritareve po tentohej të thyhej, dhe pas shumë tentativave kjo u arrit. Mund të shikoja disa persona që me ndihmën e shkallëve kishin arritur të ishin pranë dritareve, dhe me sende të forta godisnin brenda sallës ku një demokrat edhe u plagos. Në atë moment, kushdo që ishte në sallën e mbledhjeve po bënin të pamundurën që ata persona të mos hynin brenda, pasi jeta e secilit prej nesh po rrezikohej.

**Newsbomb: A e prisje atë që ndodhi?**

**Adela Qemali:** Që pas datës 9 Shtator, situata politike në PD ka pasur tensione, por kurrsesi nuk isha e përgatitur që situata të dilte jashtë kontrollit, të kishte dhunë dhe aq me tepër, nuk mendoja se, jeta e secilit prej nesh, do të vihej në rrezik. Teksa shikoja brenda ambjenteve të selisë frikë dhe terror nga ajo që vinte përtej mureve, u ndjeva e tramatizuar. Në një situatë të nxehtë dhe ku të rrezikohet jeta, vetmbrojtja është instikti i parë që çdo njeri ka.

**Newsbomb: Si e përjetove më pas atë dhunë, kur e gjitha kishte mbaruar?**

**Adela Qemali:** Kur Policia e Shtetit mbërriti në seli për të shpërndarë protestuesit, përdori gazin lotsjellës, dhe për shkak se çdo dritare e derë e godinës ishte thyer, gazi depërtoi gjithashtu në ambjentet e brendshme ku ishim ne. Mbas qetësimit nga problemet që na shkaktoi gazi lotsjellës, teksa po shikoja ambjentet e selisë u ndjeva e shokuar, e trishtuar nga ajo që kaluam.

**Newsbomb: Me çfarë mendimesh u ktheve në shtëpi, në Elbasan?**

**Adela Qemali:** Pasi dhamë të dhënat, dëshmitë, në Prokurori, e cila mbërriti në seli, u nisa drejt Elbasanit. Për shkak të shok-ut që kalova, e gjithë rruga drejt shtëpisë ishte pa fjalë dhe pa mendime, bosh. Isha e revoltuar, e fyer, e zhgënjyer dhe e shkatërruar emocionalisht.

**Newsbomb: A do shkoje sërish nëse do ketë përsëri një ngjarje të tillë?**

**Adela Qemali:** Nuk mendoj se do të ketë përsëri një ngjarje të tillë. E kam thënë dhe më parë, që jam e bindur se çdo demokrat dhe jo vetëm, është i lënduar nga ato pamje, dhe mendoj se ka sado pak reflektim nga secili. Kjo më jep siguri se, 8 janari ishte hera e parë dhe e fundit që ndodh në familjen tonë të përbashkët. Duke njohur vlerat e secilit prej nesh, parimet dhe idealet që na bashkojnë, mendoj se çdo demokrat është i distancuar nga ajo protestë e dhunshme.

**Newsbomb: Çfarë mendon se do të ndodhë me PD?**

**Adela Qemali:** Mendoj se ky ishte një proces që duhej me patjetër të ndodhte pavarësisht se dhemb shumë. PD është e vetmja forcë politike në Shqipëri me orientim Perëndimor, e cila mund ta shkëpusë hallkën e fundit nga komunizmi në politikë dhe shoqëri. Mendoj se ky proces do të marrë kohë, por jam e sigurt se Partia Demokratike do të kthehet më e bashkuar. Të gjithë së bashku kemi shumë punë përpara, kundër një regjimi që po e shkatërron çdo ditë e me shumë Shqipërinë. Më të fortë drejt së ardhmes, si e vetmja shpresë e shqiptarëve.

**ADELA QEMALI:**
Mendoj se ky ishte një proces që duhej me patjetër të ndodhte pavarësisht se dhemb shumë. PD është e vetmja forcë politike në Shqipëri me orientim Perëndimor, e cila mund ta shkëpusë hallkën e fundit nga komunizmi në politikë dhe shoqëri.






# PËRJETIMI I NJË PABESIE, SI E PASHË 8 JANARIN E PROTESTUESVE!

Nga ERALD KAPRI

Janari paska qenë muaji i nxehtë i politikës. U bënë disa të tillë. Por ky 8 Janar do të mbahet mend më gjatë dhe krijoi një precedent të panjohur më parë, por që do ndryshojë politikën shqiptare përgjithnjë.

E shtuna dukej një ditë normale. Në vitet e fundit nuk kam munguar në asnjë protestë kombëtare të organizuar nga demokratët, jo vetëm për bindjet e mia apo kontributin e dhënë në PD, por edhe për rëndësinë që ka protesta në një vend si Shqipëria.

Në telefon nisën lajmet e mbledhjes së protestuesve në selinë e PD, para orës së lajmëruar. Mendova se diçka po ndodhte, dhe u nisa menjëherë. Rrugës, pranë Kishës Katolike, u ndesha me grupin e protestuesve që shoqëronin Sali Berishën dhe më pas me vështirësi hymë në seli pasi turma ishte e pakalueshme. Ishte e vështirë të numëroje pjesëmarrësit për shkak të zonës së kufizuar. Por menjëherë nisa të dalloja fytyra familjare. U takova me disa demokratë nga Pogradeci dhe Korça. I njoh prej vitesh dhe ndjeva një admirim për ta pasi kanë qenë palca e demokratëve. Kanë dhënë shumë për PD, në ditë të mira e të këqia, dhe atë ditë ata ishin aty.

Me ardhjen e Berishës në protestë, turma nisi të lëvizë dhe të kërkojë të hyjë në seli. Dyert ishin të mbyllura dhe më pas nisën shqelmat e para për t'i hapur. Qëndrova në krah të selisë, mes demokratëve të Pogradecit, në pritje që dyert do hapeshin shpejt.

Pavarësisht lajmeve për blindime, pritshmëria nuk ishte që ato do ishin fortifikuar si këshjellë bizantine, ku nga pas dyerve, njerëz me kapuçë nisën të hedhin gaz të bardhë. Besoja se demokratët e protestës me hyrjen në seli, do qëndronin në zyrat e lira, dhe se askush nuk do guxonte të shkonte tek zyra e Bashës. Selia do ndahej në mes, dhe secili grup do vijonte me të vetën. Të paktën kështu besoja.

Por më pas ndodhi diçka e papritur. Nga brenda nisën të thyenin xhamat mbi derën nga krahu i Parlamentetit, duke krijuar një skenë paniku pasi copat po binin mbi protestuesit. Kjo e irritoi turmën pa masë. Nisën të hidhnin gurë drejt selisë, por sërish një pjesë e vogël e tyre. Pavarësisht këtij provokimi, kishte vetëpërmbajtje të madhe, aq sa edhe makina luksoze e Lulzim Bashës që ndodhej aty, nuk po prekej nga protestuesit në atë moment irritimi legjitim.

Dera më në fund u shqye dhe pati një brohoritje nga turma. Madje, shumë nisën të mbanin radhë të hynin në selinë e tyre. Por një zë i regjistruar, nisi të brohorasë nga ana e oborrit të Kuvendit. "Shmangni aktet e dhunës. Do ndërhyjmë për të shpëtuar jetën e deputetëve". Ishte megafoni i Policisë së Shtetit. Fillimisht m'u duk si një paralajmërim pa vlerë.



Ndarja e madhe ndodhi. Nuk u pranua mjeti demokratik i votës por i fortifikimit dhe i dorëzimit tek pushteti. Një pamje groteske teksa deputetë liste dilni nga selia e fortifikuar duke u kollitur nga gazi që kërkuan vetë të hidhej mbi votuesit e tyre. Kështjella e fundit ra.

Nuk e besoja kurrë se Policia do të ndërhynte ne oborrin e PD-së. Kur befas, dera u hap nga ana e Kuvendit dhe mësyri makina e ujit e Policisë bashkë me dhjetëra policë të veshur si për luftë. Nisën të hedhin ujë dhe tek këmbët e mia mbërriti një granatë gazi lotsjellës.

Turma nisi të vrapojë në panik duke krijuar një gjendje ankthi të frikshëm. Disa ishin me fëmijë në protestë dhe nisën të bërtasin nga frika. Një i moshuar u rrëzua pranë hyrjes së selisë dhe u shkel frikshëm duke i rrezikuar jetën. Falë këmbënguljes së tij, ia doli të çohet dhe të mbijetojë ndonëse ishte në gjendje të vështirë. Nisa ta ndihmoj të ecnim më tutje pasi gazi lotësjellës po bënte punën e tij. Të gjithë vraponin dhe kolliteshin. Nuk mungonin të sharat dhe mallkimet për Bashën dhe Ramën. Miku im Genti Çela ishte rrëzuar më tutje dhe ishte dëmtuar rëndë në dorë.

Trotuarët nisën të popullohеshin me njerëz që po uleshin për të marrë veten. Një situatë paniku dhe pabesie. Në shtëpinë e tyre ishin sulmuar me gazin e frikshëm që kishin përjetuar në protestat e Bashës kundër Ramës. Veçse tani gazin po ua lëshonte Basha. Ishin të njëjtët demokratë, të njëjtët njerëz që kishin dhënë gjithçka për Bashën. Është e vështirë të përshkruash atë zemërim.

Qindra demokratë nuk po lëviznin nga rrugët dhe u tentua sërish të shkohej në seli. Por Policia u tregua brutale. Makina e ujit nisi t'i shpërndajë dhe granatat e gazit u hodhën në bulevard dhe sheshe.

Ekranet dhe portalet nisën të mbusheshin me lajme dhune, akuza dhe pretendimet e Policisë së Shtetit. Orët më pas do të ishin komike. Selia e PD e dorëzuar tek shteti dhe prokurorja e akuzuar ashpër nga Basha po bënte ligjin në oborr.

Ndarja e madhe ndodhi. Nuk u pranua mjeti demokratik i votës por i fortifikimit dhe i dorëzimit tek pushteti. Një pamje groteske teksa deputetë liste dilnin nga selia e fortifikuar duke u kollitur nga gazi që kërkuan vetë të hidhej mbi votuesit e tyre. Kështjella e fundit ra.

Muajt e ardhshëm do sjellin e realitet të ri politik. Sfida e parë do të jetë e demokratëve të cilët dukshëm dhe në shumicë janë kundër kastës ilegjitime të selisë të cilën e dorëzoi për të ruajtur atë pak privilegj që u jep mandati i deputetit. Ata e dinë se nuk kanë më të ardhme politike mes demokratëve ndaj janë shndërruar si opozita e pas 2019 për të kapur ç'të munden.



Personalisht kam besuar se selia dhe vula nuk kanë asnjë rëndësi. Mbajtja e tyre me thonj vetëm sa ka shtuar irritim tek demokratët. Por e ardhmja e shkurtër nuk dihet se ku do çojë. Me shumë gjasa, mund të kemi një lëvizje të re e cila do garantojë numrat natyralë të së djathtës historike shqiptare dhe një "LSI" të re nga e djathta e cila do mund të gëzojë privilegje pushteti për pak kohë. Të humbësh një betejë është e vështirë, por të poshtërohesh është diçka tjetër.

Historia nuk ka falur askënd që ka dorëzuar kalanë nga brenda.





8 Janar 2022. Fatmir Merkoçi duke u ngjitur me shkallë tek selia e PD-së

# FATMIR MERKOÇI: ME PLUMB NË KOKË, MBI SHKALLË PËR TË FOLUR ME BASHËN

Nga XHON METAJ

Ka një plumb në kokë, marrë në protestën e 20 shkurtit 1991 kur shkoi të rrëzonte bustin e Enver Hoxhës dhe ishte vetëm 32 vjeç. Është pjekur për 30 vjet protestave kurdo ku kanë ndodhur dhe në 8 janar, 62 vjeçari, ishte i pari që hipi shkallëve tek selia e PD, për të komunikuar me Bashën, në kat të dytë. Kur e pyetën në polici pse e bëri, dha përgjigjen e jashtëzakonshme që u shkaktoi të qeshura të gjithëve: U ngjita të ndërroj poçin e llampës së djegur!

Fatmir Merkoçi është i vetmi që ka refuzuar dekoratën e ish-Presidentit Bamir Topi për 20 shkurtin dhe deklaroi publikisht se nuk do ta merrte atë dekoratë, pa i'u hequr statusi "Hero i Popullit", Enver Hoxhës. Në 8 janar, i hodhën sprai djegës në fytyrë nga selia e PD. Në këtë intervistë për Newsbomb, ai tregon historinë dhe rrugëtimin 30 vjeçar në protesta.

**Zoti Merkoçi, ju njiheni si njeriu i protestave, keni drejtuar dhe keni marrë pjesë në shumë të tilla, si ndiheni kur ua thonë këtë?**

Unë jam rritur në protesta, protestat e mia fillojnë shumë më herët sesa protestat e të tjerëve. Kam 30 vite që jam në protesta. S'ka protestë në Shqipëri që unë të kem munguar, pavarësisht se kush e thërret protestën. Edhe në protestën që u bë për rritjen e çmimeve që u improvizua nga vetë Rama, unë arrita t'jua marr mikrofonin dhe t'ua shtroj kërkesat që i do çdo njeri, por Rama kur e pa që po merrte tamam formën e protestës, urdhëroi mbylljen e saj.

**Çfarë ndodhi në 20 shkurt 1991? Si u plagosët?**

Ne vendosëm të dilnim dhe të protestonim, por nuk e dinim sesa njerëz do na bashkoheshin. Jemi takuar me grupin e studentëve tek "Shtatë Xhuxhat" dhe jemi ngjitur lart në Qytetin Studenti. Aty improvizuam një tribunë në një ballkon, ku unë mora mikrofonin dhe i thashë Mondës të nxirrte njerëzit në bulevard dhe ajo bëri thirrje "gratë dhe vajzat në bulevard". Unë mora mikrofonin dhe thirra "të gjithë në bulevard". Kur shkuam te piedestali, unë së bashku me 20-30 vetë të tjerë arritëm të hipnim





> Në 1991, unë mora mikrofonin dhe thirra "të gjithë në bulevard". Kur shkuam te piedestali, unë së bashku me 20-30 vetë të tjerë arritëm të hipnim lart. Filluam të godisnim përmendoren me duar, pasi s'kishim asgjë me vete. Ishin më shumë se 100 mijë njerëz në shesh dhe nuk ka pasur një xham të thyer



lart. Filluam të godisnim përmendoren me duar, pasi s'kishim asgjë me vete. Ishin më shumë se 100 mijë njerëz në shesh dhe nuk ka pasur një xham të thyer. Kur pushtuam piedestalin, policia përdori armë kundër nesh. Unë jam qëlluar me armë në kokë. Më dërguan në spital, sot jam gjallë vetëm falë mjekut Arjan Xhumari. Më dinin të vdekur. Kur u përmenda, fjala e parë që thashë ishte "a ka viktima?", "Jo", më tha Arjani, ndërsa duke qeshur shtoi: "Ti je duke vdekur për vete, ça viktimash thua". Dola nga spitali pas disa orësh dhe u bashkova me të tjerët. Nuk ishim nisur për të rrëzuar shtatoren, por ashtu erdhën ngjarjet.

**Përse e refuzuat dekoratën e ish-Presidentit Bamir Topi?**

Një ditë më erdhi ftesa për t'u paraqitur në Presidencë. Shkoj aty kishte personalitete të shumtë, trup diplomatik dhe plot gazetarë. Shikoj që po dekoroheshin me radhë për "20 Shkurtin" operatorë dhe gazetarë. Presidenti më jep titullin "Ithtar i Demokracisë", ndaj unë i them: "Përpara se ta marr këtë dekoratë, dua të them 2 fjalë. Ne me komunizmin jemi ndarë në 20 shkurt, ndërsa ju politikanët nuk jeni ndarë akoma, as moralisht, as ligjërisht dhe as politikisht. Përsa kohë ju nuk i hiqni titullin "Hero i Popullit" Enver Hoxhës, nuk e pranoj dekorimin". Thashë këtë dhe ika. Një diplomat gjerman më takon dhe më thotë: Sot e vrave për herë të dytë komunizmin.

**Kalojmë te protesta në selinë e PD, si e morët iniciativën për të hipur në shkallë dhe për t'u ngjitur në zyrën e zotit Basha?**

Kisha vënë një pankartë para se të fillonte protesta ku ishte shkruajtur: "Sot shpallet fituesi VIP i Big Brother". Ai ishte sinjali për të thënë se këtu ka një njeri që e komandon. Për mua, sipas të gjitha informacioneve që kisha, kjo ishte një marrëveshje mes Ramës dhe Bashës, pasi shihja deklaratat e këtij të fundit që thoshte "I kemi marrë të gjitha masat". Kam qenë në krye të protestës, aty ku mua më takon të jem, sepse përreth meje kam patur ata djem apo fëmijë të djemve të 2 Prillit të Shkodrës. Brenda partisë ndieja erë gazi. Gjatë gjithë kohës, thyheshin xhama nga brenda dhe dëgjoheshin shashka që hidheshin. Në një moment fluturon një karrige nga brenda. Pak më vonë, disa çuna sjellin një shkallë për t'u ngjitur te zyra e zotit Basha.

U ngjita në shkallë, shkova për të komunikuar me zotin Basha për hedhjen e gazit. Në momentin që hapet dritarja, pashë që ishin ulur të gjithë në tavolina, por në atë moment shfaqet një njeri me vare dhe e ngre varenë për të më gjuajtur. I them "mua do më gjuash? Gjykoj se do jetë njeri i PD-së, i cili duke më parë, mendoi se unë e njoha dhe u step. Në këtë moment vjen vrullshëm një tavolinë për të ma hedhur mua, dhe nga dera del dikush. Kam ngritur duart lart dhe i them "Lul Basha më vrit tani se vetëm kjo të ka ngelur". Në këtë moment ata ndaluan dhe e tërhoqën. Më pas doli një dorë me një bombul gazi dhe ma hodhi në surrat. Falë instiktit u mbrojta me xhup. Unë zbrita 2 shkallë më poshtë, marr flamurin e partisë dhe e vendos atje, për t'u thënë se ne jemi PD-ja, s'mund të kemi sherr me njëri - tjetrin. Unë kam parë armë brenda. Njerëz të armatosur kur ti bën mbledhje, nuk arrij ta kuptoj. Unë shkova thjesht për komunikim. Basha duhet ta kishte pranuar hyrjen time brenda.

**Pas protestës ju arrestuan? Çfarë deklaruat në Komisariat?**

Pas protestës, më marrin në telefon dhe më thonë që duhet të paraqitesha në polici. Kur shkoj atje, nuk më dhanë një letër ku të më shpjegonin përse më thirrën, thjesht më thanë se do më pyesnin për protestën. Më tha ajo zonja, "do të pyes pse hipe te shkallët? I thashë: E sheh poçin ti këtu? Me çfarë ndërrohet poçi i djegur? Me shkallë. Prandaj hipa unë, se është kryetari i djegur dhe do ta ndërroj".

**Keni patur komunikime me zotin Basha apo me zotin Berisha?**

Basha ka një vit e ca që ma ka bllokuar telefonin. Komunikimi i fundit me të ishte 2 ditë para protestës, shkova për t'u ulur dhe për të folur me atë, pasi dëgjova se ishte bunkerizuar partia. Nuk e besoja që kishim arritur deri në këtë pikë, megjithatë unë vajta për ta takuar,





për t'u ulur dhe për të folur me të, qoftë edhe për ta parë vetë. Realisht unë shkova, i rashë derës së madhe. Dikush nga brenda më tha "dil nga dera tjetër", dola nga dera tjetër. Kur kam dalë aty, ishte shoqëruesi i Bashës, më hapi derën. I thashë se do takoja zotin Basha dhe më tha "e ke te kafja". Shkova te kafja, ishte me gazetarët, po pinte kafe. I kërkova takim, nuk pranoi se ishte shumë i zënë. Meqënëse nuk pranoi, i thashë "të dola borxhit, unë kaq e kam". Ky ka qenë komunikimi i fundit, ndërsa me Berishën nuk kam asnjë lloj komunikimi. Kam qenë në Foltoren e parë, pasi vetë pozicioni që kam më detyron të shkoj t'i dëgjoj vetë. Më ulën në rresht të parë, por s'doja t'i bëja pyetje për të mos thënë "ia kanë dhënë". Por komunikim telefonik apo fizik nuk kam patur. Edhe në protestën e fundit, kur jam arrestuar dhe kam dalë, s'kam patur asnjë komunikim.

Zoti Basha vazhdon që të shkelë statutin dhe të tregohet një mini-diktator. Nuk ka asnjë pikë në statutin e partisë që mund të përjashtosh një njeri. Ta përjashtosh nga partia, do të thotë të vrasësh pluralizmin. Nuk ma vret dot mendimin, s'ka ligj të të vrasë sepse mendon, vetëm në diktaturë.

**Si ju duket vendimi i Bashës për të përjashtuar Sali Berishën përgjithmonë nga PD?**

Zoti Basha vazhdon që të shkelë statutin dhe të tregohet një mini-diktator. Nuk ka asnjë pikë në statutin e partisë që mund të përjashtosh një njeri. Ta përjashtosh nga partia, do të thotë të vrasësh pluralizmin. Nuk ma vret dot mendimin, s'ka ligj të të vrasë sepse mendon, vetëm në diktaturë. Mund ta shkarkosh si funksionar partie dhe nga Grupi Parlamentar, por jo ta shkarkosh. Nuk ka tagër, anëtar partie mund të jetë kush të dojë.

**Çfarë i kërkoni Lulzim Bashës?**

Unë i kërkoj prapë takim Lul Bashës për të zgjidhur problemin. Unë kam mënyrën për ta zgjidhur, sepse unë nuk kam konflikt interesi as me grupimin e Bashës dhe as me të Berishës. Unë jam ai Miri asnjanës, ai Miri i 30 vjet protestave, pasi nuk kam qenë kurrë funksionar i partisë apo i shtetit. Unë kam asetet e mia që nuk i ka dhënë kush nga këta. Unë kam dhënë gjakun, sepse unë jam i vdekur. Unë në 20 shkurt isha i vdekur, por falë Arjan Xhumarit jam gjallë. Përfaqësoj ata demokratë që nuk e kanë mundësinë të shprehen në media. I kërkoj Bashës të vijë të bëjë debat publik. Të marrë kë të dojë, unë do jem vetëm. Nëse më mund, unë kam për borxh t'u drejtohem të gjithë demokratëve dhe t'u them që do shkojmë të gjithë pas Bashës. Unë e pranoj fajin, por të ulet në tavolinë. Një paqe e vendosur me pushkë, është paqe e brishtë, nuk zgjat. Është e pamundur. Je njeri i bunkerizuar zotëri, si feston ti kundër vëllezërve të tu. Çfarë donin njerëzit e huaj brenda PD-së? Hajde flasim, nuk zgjidhet gjë, ti andej dhe unë këtej. Ai më ka bllokuar telefonin, si do komunikoj me të? Unë kam dhënë jetën për këtë vend, si ma mbyll mua ti telefonin? I kam kërkuar publikisht takim, ai më ka hequr edhe nga facebook-u mua.

FORTEX
nutraceuticals

# VITAMIN C 500 + ZINC+ D3 DIRECT

## PËRTHITHJE MAKSIMALE

## Rrit imunitetin

## Lufton viruset

Zn D3 C

- funksionimin normal të sistemit imunitar
- mbrojtjen e qelizave nga stresi oksidativ

## Bustina të tretshme

## Merret pa ujë

## Shtesë ushqimore





Duke pranuar tezën e Ramës "nëse nuk merreni me politikë do të merret ajo me ju" dhe të Bashës "siç është partia sot do jetë Shqipëria nesër", 30 vjet pas pluralizmit Shqipëria përballet me sfidën e rivendosjes së pluralizmit politik: pluralizëm politik me parti alternative konkurruese vs pluralizëm të kontrolluar dhe elita të emëruara.

# RIVENDOSJA E PLURALIZMIT



Nga AFRIM KRASNIQI

Më 12 dhjetor 1990 u krijua partia e parë opozitare, akt që jetësoi pluralizmin politik. Shqipëria kishte vetëm një përvojë minimale pluraliste (1920-1924), më pas vijuan regjimet autoritariste (1925-1939), periudha e pushtimit (1939-1944) dhe sistemi stalinist i partisë-shtet (1945-1990). Pa traditë, pa memorie historike, e vetizoluar gjatë katër dekadave ndaj Perëndimit dhe dy dekadave ndaj Lindjes, pa institucione fetare, pa grupe civile dhe as elementë aktiv disidencë politike, pa pronësi private dhe as qeveri në emigracion, takimi me pluralizmin ishte frymëzues, por dramatik dhe i bazuar në keqkuptime. Mijëra qytetarë të zhveshur dhe të pa ushqyer, modele Tarzani që nuk ia kishin idenë e botës, ligjit, demokracisë, lirisë, konkurrencës, meritokracisë, llogaridhënies apo transparencës, ndarjes së pushteteve dhe as rotacioneve politikë, - mbushën anijet për në brigjet italiane, për të takuar "Europën", ishin simboli më domethënës i trashëgimisë komuniste.

Në aspektin politik, Shqipëria ishte vendi i vetëm që nuk mundësoi krijimin e ndonjë partie politike nga ish të përndjekurit politik. Ata u liruan vonë, shumica rreth tre muaj pas lejimit të pluralizmit, kur ishin krijuar tashmë PD, PR, PE,




PA, etj. Shqipëria gjithashtu u bë vendi i vetëm që krahas dekretit për pluralizmin nxori dekret për mbrojtjen e emrit dhe shtatoreve të diktatorit, që ndaloi grevat e protestat dhe që ndaloi mundësinë që diaspora të ketë përfaqësim politik. Llogaria ishte e qartë: PPSH nuk e deshi dhe as e pranoi, por vetëm sa u detyrua ta ligjërojë pluralizmin për shkak të presionit, pamundësisë së menaxhimit të protestave studentore dhe pakënaqësive publike. Ajo mendoi një formë tjetër pluralizmi, një pluralizëm të kontrolluar ku 70% e subjekteve elektorale ishin organizata satelite të saj. Nga ana tjetër, opozita nisi si front, bazuar tek etja për ndryshim dhe qytetaria aktive, por me ide të paqarta për të ardhmen dhe me deficite të mëdha në formimin politik. Në thelb, të gjitha figurat politike të opozitës dhe mazhorancës së dalë nga zgjedhjet e vitit 1991 ishin produkt i elitës së emëruar të sistemit të kaluar, të kulturës së njeriut të ri dhe të shkollës izolatore apo të revolucionit kinez. Ata nuk ishin apriori kundër konceptit të partisë dhe liderit absolut, demokracisë së kontrolluar dhe vazhdimësisë së elitave, por ata thjesht ishin pro ndryshimit dhe zëvendësimit prej tyre të Byrosë, PPSH, KQ dhe nomenklaturës. Ata nuk ishin për revolucion, por evolucion.

30 vjet më vonë Shqipëria numëron mbi 130 parti politike, nga të cilat 10 janë të përfaqësuara në parlament, por vetëm gjysma e tyre marrin më shumë vota sesa pragu minimal prej 3000 votash për krijimin e një partie. Të gjitha partitë politike fitojnë sot së bashku më pak vota sesa dy partitë e vitit 1991, mazhoranca fiton zgjedhjet periodikisht me rreth 300 mijë vota më pak sesa fitoi PPSH më 1991 dhe PD më 1992. Në vitin 1991, PPSH miratoi kalimin e komiteteve të partisë në seli të partive të reja, dhe prej atëherë, partitë shqiptare janë të vetmet në pjesën kontinentale me seli luksoze të dhuruar nga shteti, ato kanë financim vjetor rreth 120 herë më shumë sesa fondi shtetëror për shkencën, në fushatën elektorale ato janë punëdhënësit kryesore me mbi 60 mijë të punësuar në administrimin zgjedhor, si dhe direkt ose indirekt kanë të drejtë vote në zgjedhjen apo emërimin e të gjithë institucioneve kryesore kushtetuese. Pushteti i tyre absolut, shumëfish më i madh sesa më 1991-1992, në vitet e para të pluralizmit politik. Pas vitit 2008 ato kanë sanksionuar njësimin e pushteteve: kryetari i partisë emëron deputetët, emëron ministrat, është kryeministër dhe de facto kryetar shumice në parlamentin që duhet të kontrollojë qeverinë e tij, - cikli mbyllet dhe sistemi vertikal personalizohet në atë masë, sa fatet e shtetit, partisë dhe shoqërisë përcaktohen nga një individ.

Ky sistem vertikal, personal dhe i mbyllur nuk mund të sjellë demokraci funksionale dhe as shtet të së drejtës. Ai prodhon kriza periodike, destabilitet periodik, konflikt permanent, oligarki dhe arrogancë, sjell mungesë përfaqësimi dhe refuzim të ndryshimeve. Pasoja, fakti që në PS nuk votohet as formalisht për kryetar prej vitit 2009, se në PD përdoren trupa paramilitare për të zotëruar selinë, se në LSI rotacioni kalon brenda familjes dhe në asnjë parti tjetër nuk ka votim as garë, është vetëm një prej pasojave të dukshme të këtij deformimi të thellë, shumëplanësh dhe alarmues. Duke pranuar tezën e Ramës “nëse nuk merreni me politikë do të merret ajo me ju” dhe të Bashës “siç është partia sot do jetë Shqipëria nesër”, 30 vjet pas pluralizmit Shqipëria përballet me sfidën e rivendosjes së pluralizmit politik: pluralizëm politik me parti alternative konkurruese vs pluralizëm të kontrolluar dhe elita të emëruara. Zgjidhja? Vetëm një, reformim thelbësor të legjislacionit të partive politike, financimit, raporteve të partive me shtetin, vettingut në politikë dhe dekriminalizimit.




# BANAKING - SI VETË EMRI HISTORI ME KOKAINË NGA SUPERPRODHIMI

Si e raportoi televizioni RAI operacionin për kapjen e drogës në Itali në 31 dhjetor 2021. Në Belgjikë dhe Hollandë autoritetet shqetësohen nga superprodhimi i Kokainës. Pse në Shqipëri kokaina vjen akoma me banane, kur në botë linjat po zhvendosen te piperi, fasulet apo farat e sojes?

Nga **SOKOL BREGU**

"Banaking" nuk është thjesht një reklamë mediatike dhe një treg i ri në Shqipëri, "banaking", apo si do që ta ketë emrin më vonë, është një detyrim tregu i një superprodhimi të kokainës gjatë vitit 2021 në Amerikën Latine. Sot mund të ulërasim se si droga vjen në Shqipëri, kaq hapur, pse arrestohen vetëm kamionistë, dhe mund të ulemi në tryezë, si një opinionist opozitar me idenë se si qeveria është kthyer në narkoqeveri. Por të dhënat tregojnë të kundërtën në të gjithë tregun europian dhe botëror. Në BE, nuk "fitoi" vetëm pandemia, fitoi gjatë gjithë 2021-it edhe kokaina. Ka vetëm një ndryshim, të gjithë shtetet e pranuan me radhë në këtë fillim të vitit 2022, kuptohet në një mënyrë tepër të sofistikuar për të mos pranuar dështimin e plotë. Në Shqipëri, narkotrafiku është një çështje që u diskutua politikisht, me akuza dhe kundër akuza dhe asnjëherë gjatë këtij viti, dhe vitit tjetër, kësaj qeverie dhe qeverisë tjetër nuk ka për t'u pranuar kurrë se lufta ndaj drogës, dhe veçanërisht ndaj kokainës po humbet gjerësisht në botë. Shqipëria nuk është në gjendje të ngrejë strategji, strategjitë hartohen nga organe me dhjetra specialistë ndër më të mirët në botë, por Shqipëria mund të godasë kanabisin e mbjellë dhe ky është i vetmi instrument që e ka në dorë, kokaina nuk mund të preket, ajo s'është një histori "Banakingu", Porti Durrësit, skaneri, apo kamionisti. Kokaina është vrulli më i madh në kohë pandemie, që nuk mund ta ndalë dot askush.

#### TË PRANOSH HUMBJEN, DUHET TË JESH BELG

Belgjika ka sekuestruar sasinë më të madhe të kokainës ndonjëherë në historinë e saj në

Shqipëria e sjell ende me banane, për arsyen e vetme, se rrjeti i saj më i mirë funksionon nga ky shtet. Por po ti referohemi historive më të vjetra të linjave të drogës në Shqipëri, do ta gjejmë atë në vaj palme, nga Kolumbia. Kjo mënyrë ha kohë dhe do resurse në njerëz, dhe sjell vetëm dërgesa që nuk i kalon dot 200 deri në 300 kg.

2021-in, në porte dhe në banesa trafikantësh, por ministri i saj nuk mburret. Ai pranon se gjithçka është një histori mbiprodhimi i kokainës. Në datën 7 janar të këtij viti, Drejtoria e Shërbimit Doganor dhe Akcizës në Belgjikë, në një konferencë për shtyp, deklaroi se sasia e kapur gjatë vitit 2021 është 33% më e lartë se sasia e kapur gjatë vitit 2020 dhe është dyfishi i asaj që ishte pesë vjet më parë. Doganat belge thanë se 89.5 ton kokainë është kapur vetëm në portin e Antwerp gjatë vitit 2021 me një vlerë prej 12.76 miliardë eurosh. Shumica e kokainës vinte nga Ekuador, Panama dhe Paraguaj.

Por Vincent Van Peterghem, ministri i Financave nuk u mburr, ndërsa të gjithë e prisnin ta bënte një gjë të tillë në konferencën e parë për shtyp të qeverisë belge për këtë vit. Jo, sepse Peterghem nuk mendonte kështu, ai tha realitetin, se rritja e sasisë së drogës së kapur është pjesërisht rezultat i një rritjeje të trafikut ndërkombëtar të drogës. Megjithatë, ai sqaron se, Belgjika ka investuar mjaft në 2022, në asete dhe në përmirësimin e performancës së Shërbimit Doganor. Por dhjetra tonelata kokainë kapi policia belge nëpër banesa në qytetet kryesore të vendit, ajo arriti kulmin në prill, ku brenda një nate sekuestroi 17 tonë. Në të gjitha këto qindra tonelata, shqiptarët rezultojnë të kenë pak tonë të tyret, të tjerat janë mafia kryesisht vendas flamande, por edhe amerikanë, serbë, bullgarë, gjeorgjanë, turq, trafikantë nga Meksika apo edhe Kepi i Gjelbër.

Asnjëherë në Shqipëri, një ministër nuk mendon si një belg. Ne ende krenohemi me historinë se si i kapëm Arbër Çekajt 613 kg kokainë që ende nuk e dimë se kujt i përkiste, dhe kurrë nuk pranojmë si në Europë, se për të mundur mafian duhen investime në doganë dhe doganierë. Një doganier sot në Shqipëri paguhet me një pagë bruto 55 mijë lekë, dhe me ketë rrogë, kokaina jo në një vit si ky, por edhe në vitet pasardhëse të blen vetëm me katër gram në treg, aq sa i fal të dashurës në një pub të Tiranës, çdo shitës i vogël.

**KAMIONIST, TI DO BURGOSESH GJITHMONË**

Sot po kërkojmë bosin e drogës së gjendur brenda "Banaking". Për momentin në burg kemi dy kamionistë dhe një administrator.

Po të shohim se ç'ndodhi në Itali në të njëjtën javë që kontenieri i Banaking po vinte në Shqipëri. Rai, gjigandi mediatik italian në 31 dhjetor të 2021-it, njoftonte për një sekuestrim kokaine në portin e Gioa Tauro. Në dy aksione të Guardia di Finanza-s dhe doganës vendase, u identifikuan dhe u sekuestruan mbi 3 tonë kokainë dhe u arrestua drejtuesi i kamionit. U kontrolluan 3 mijë kontejnerë nga Amerika e Jugut, policia financiare dhe doganierët, dhe me ndihmën e skanerëve të sofistikuar, arritën të identifikonin 2,272,515 kg kokainë, të fshehura në 3 kontejnerë të ngarkuar me banane, thasë me kikirikë dhe piper.

Në një tjetër kamion u ndalua drejtuesi i kontenierit me furra elektrike. Në mes u gjetën edhe 855,690 kg kokainë. Në përgjithësi, raporton Rai, droga e kapur, e një cilësie shumë të pastër, mund të ishte prerë nga trafikantët e drogës deri në 4 herë përpara se të hidhej në treg, duke fituar një të ardhur prej rreth 1 miliard euro për trafikantët. Vetëm një shofer kamioni për tre tonë. Për Guardia di Finanzian kamioni me furra elektrike dhe kokainë mes tyre që vinte nga Kolumbia në Itali, ishte një shaka që nuk mund të qeshësh. Vetëm në një mentalitet si Shqipëria dhe me anë të një presioni





# KOKAINA TE BANANET, SKENAR PËR FILMA HOLLIVUDIANË

Një histori si për të realizuar filma. Me shumë enigma, shumë të pathëna, e shumë pikëpyetje. Revista NEWSBOMB ka siguruar dosjen e Prokurorisë së Tiranës për sekuestrimin e 119 kg kokainë në magazinën e kompanisë "ZICO SHA" në Vaqarr, Tiranë. Prokurori Arian Përmeti ka firmosur urdhër-arrestet për menaxherin e shitjeve të kompanisë, Marson Murataj dhe dy shoferët Gëzim Kalaja e Hasan Saliu

Të gjithë e kishin mendjen te Gjeli i Detit dhe Bakllavaja. Aty duhet ta kishin edhe oficerët e policisë që shkuan për kontroll në datën 30 dhjetor 2021 në ambientet e kompanisë Zico sha në Vaqarr të Tiranës, pas një denoncimi të pronarit Trifon Murataj, me telefon, që në datën 29 dhjetor, se një kamion me banane i dukej i dyshimtë. Policia e mori ngeshëm denoncimin, ndërsa për telefonatën më të vogël thotë se gjendet pranë qytetarit në kohën më të shkurtër. Madje policët kanë përtuar dhe të shkarkojnë vetë kamionin. Sipas thashethemit që qarkulloi, punëtorët e ngarkim-shkarkimit, u tregonin policëve se kush arka ishin më të rënda se të tjerat dhe këta i veçonin. E brenda atyre arkave, u gjetën plot 119 kilogramë kokainë vendosur në 10 pako. Dyshohet se sasia ka qenë shumë herë më e madhe. Por është shkarkuar në Itali. Se pse nuk ka zbritur edhe kjo pjesë e kokainës atje ngre shumë pikëpyetje. Një tezë është se në kohën kur trafikantët kanë marrë "mallin" në portin Italian, aq kohë kanë pasur në dispozicion dhe pjesën që u kanë mbetur e kanë lënë në kamion. Dyshimi tjetër është se e kanë lënë këtë sasi për të parë se kush do ta merrte në Shqipëri.

Çështja ka shumë pikëpyetje të tjera. Si është e mundur që në Durrës, në port, kur është parë se ky kamion e kishte plumbçen e dëmtuar, nuk u hoq mënjanë për kontroll. E për më tepër, pas skanerit që depërtoi nëpër media, nuk u pa në të asgjë e dyshimtë. Dyshimi vazhdon kur shoferi i kamionit Hasan Saliaj tregon se në Romanat i kanë dalë persona përpara, me maska, që kanë pretenduar se kanë qenë shteti, kanë bërë një kontroll të përciptë në

mediatik dhe politik, mund të pretendosh se një trafikant cilido qoftë arsimimi dhe mbulesa e tij mund të kapet brenda javës. Kjo është pika ku na ndryshon me vendet e BE-së, hetime të gjata dhe me një tendencë detyrimi për ta bërë kamionistin një të penduar që të mos bëjë burgim të gjatë; me një Shqipëri, ku hetimet për trafikun e drogës sidomos atë të kapur në porte përfundon brenda vitit, njësoj sikur të kemi të bëjmë me një mall të pazhdoganuar në port. Dhe në përqindjen më të madhe të rasteve për kokainën e kapur në porte, arrestohen vetëm kamionistë, kudo në Europë.

### ISHTE VAJ PALME, U BË BANANE, DHE SHPEJT DO BËHET PIPER, FASULE DHE KIKIRIKË

Bananet po zhduken shpejt nga rrjeti i dërgesave të Kokainës në Europë. Për momentin vetëm Ekuadori nis të tilla. Ato janë bërë kudo shënjestër e policive. Dhe Shqipëria e sjell ende me banane, për arsyen e vetme, se rrjeti i saj më i mirë funksionon nga ky shtet. Por po t'i






Faksimile e vendimit të Prokurorisë së Tiranës për kokainën

kamion, kanë zbritur poshtë kamionit disa arka me banane, nuk kanë gjetur gjë dhe janë larguar. Shoferit i kanë thënë se do ti vrasin fëmijët po foli, dhe ky i fundit nuk ka folur, derisa shkoi në kompani dhe më pas të gjitha deklarimet i ka dhënë përpara oficerëve të policisë gjyqsore.

Trifon Murataj në datën 29 dhjetor 2021 merr në telefon Gledis Nanon, drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. Ky I fundit autorizon Tonin Vocajn që të merret me çështjen. Vocaj, flet me menaxherët e kompanisë dhe vendos që të shkojë në Vaqarr, aty ku ishte kamioni, një ditë me vonesë, në 30 dhjetor në orën 10.30.

E kanë parë kamionin plot me banane dhe aty kanë filluar procedurat e shkarkimit të tij. Kur kanë ardhur drejt fundit, janë vënë re se disa arka ishin më të rënda se të tjerat. Dhe aty, policia ka evidentuar se ka kokainë.

Është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale dhe shtetasi Agron Jaku, me detyrë Drejtor Operacional i kompanisë së skanimit "S2 Albania", i cili ka dhënë shpjegime për procedurat e skanimit të mjetit.

Nga ana e Prokurorisë së Tiranës, janë marrë një kopje e materialeve të skanimit, lista e punonjësve dhe pamjet filmike DVD. Është marrë me kqyrje nga punonjësit e kompanisë ZICO SHA gjurma e rrugës me GPS që ka kryer kamioni me targë AA126RE/ABR604, më datë 28.12.2021; grafiku i orareve të lëvizjeve të këtij mjeti; pamjet e skanerit në Portin e Durrësit; raporti i autoriteteve italiane për kontroll kontenieri në portin italian të GIOIA TAURO; raport kontrolli nga autoritetet në Ekuador, kopje policë ngarkese të mallit, një DVD dhe një flash drive, ku gjenden pamjet filmike dhe materialet e mësipërme.

**I.XHAFAJ**

NEWS BOMB .al

AKTUALITET

referohemi historive më të vjetra të linjave të drogës në Shqipëri, do ta gjejmë atë në vaj palme, nga Kolumbia. Kjo mënyrë ha kohë dhe do resurse në njerëz, dhe sjell vetëm dërgesa që nuk i kalon dot 200 deri në 300 kg. Bananet mund të sjellin një shifër tejet të madhe. Në Itali sulmi dhe vrojtimi kryesor mbi trafikantët është për piperin, i cili largon çdo nuhatje të qenve antidrogë dhe kikirikë.

Por cili është trendi më i ri, që mendohet se të gjithë do t'i referohen. Ai vjen nga Amsterdami. 68 ton kokainë u kapën këtë vit në portet dhe aeroportet holandeze, 50 tonë më shumë se viti 2020. Shefja e doganave Nanette van Schelven, nuk u mburr, ishte e shqetësuar. "Ajo që na befason është rritja e madhe e dërgesave të mëdha", u shpreh ajo në mediat kombëtare. Dërgesat tani tha ajo janë me mbi 1000 kilogramë. Më e madhja, ishte 4.2 tonë, e fshehur në thasë me fasule soje, transporti më i fundit. 400 kamionistë shkuan në burg, qe prisnin në porte t'i transferonin dërgesat në shtete të tjera.

# SHTETI PA BREKË




Çfarë ndodhi me rrjedhjen e pagave dhe targave të makinave, në skandalin më të madh kibernetik, i padëgjuar në ndonjë vend tjetër në botë. Historia nisi që në vitin 2013, me vjedhjen e serverit të tatimeve. Vazhdoi me "patronazhistët" ku numrat e telefonit të 930 mijë personave mbërritën te çdo shqiptar. Si e kujton sot, gazetari që zbuloi skandalin... Shteti u zhvesh lakuriq dhe nuk dihet se çfarë do të dalë akoma...

Nga **NEWSBOMB.AL**

Nuk është titull i pahijshëm, apo vulgar në kuptimin gazetaresk. As mungesë respekti për publikun dhe standardet e profesionit.

Viti 2021 në Shqipëri do mbahet mend si viti i Zhveshjes Totale të shtetit dhe popullatës.

Popullata u zhvesh lart e poshtë nga çdo e dhënë personale. Shteti i kësaj popullate mbeti nga mesi e poshtë, "pa brekë", në kuptimin







digjital literal të fjalës.

Në Shqipëri, gjithkush mund të bëjë sot dedektivin privat, vrasësin, kriminelin, gjobaxhiun, hakerin me armë efikase kibernetike që i shpërndau vetë shteti, si dikur në ’97 kur hapi depot e armëve luftarake.

Në Shqipëri, sot gjithkush mund të jetë viktimë e abuzimit, lëndimit, shantazhimit dhe mashtrimit pikërisht se shteti shqiptar vendosi që të dhënat personale të shtetasve të vet t’ua japë gjithë botës, t`i nxjerrë në Pazar!

Sot, një grua apo vajzë shqiptare është me vulnerabël se kurrë, krahasuar me çdo grua tjetër në botë. Ajo mund të arrihet, të ngacmohet, intimidohet, dhunohet apo mashtrohet nga çdo maskara brenda dhe jashtë Shqipërisë, i cili ka shtënë në duar “armën” që shpërndau vetë shteti shqiptar përgjatë 2021, databazën e të dhënave personale.

• 12 Prill 2021 doli në rrjete komunikimi social “Data Tirana”, një bazë të dhënash për 910.061 shqiptarë. Një tabelë exeli ndarë në 20 rubrika, ku përveç 9.127 patronazhistëve alias aktivistët politikë të PS-së, mbante të dhënat personale të gati 1 milion banorëve shqiptarë: Nid-i, Emri, Mbiemri, Atësia, Datëlindja, Numri i telefonit, Vendlindja, Kompania/punësimi, Kodi i Banesës, Qendra e votimit.

• “Data Tirana” mund të përdorej si aplikacion i thjeshtë, ku nëpërmjet Numrit Unik të Identifikimit Kombëtar (NID) u dekonspirua si identitet sensitiv pothuajse gjithë popullsia shqiptare. Kombinacioni i të dhënave të kësaj data baze, mund të arrinte të identifikonte çdo banor apo votues në Shqipëri.

• 21 Dhjetor 2021 u përhap në rrjetin “Whatsup” një excel tjetër: “Rrogat - Janar 2021”. Kjo tabelë mbante të dhëna për 637.138 qytetarë shqiptarë: Numrin personal, Vendin e punës dhe Pagën.

• Në 23 Dhjetor u përhap në “Whatsup” -in popullor, një tjetër excel: “Rrogat – Prill 2021”

> Prokuroria në 7 Janar 2022, një ditë para datës finale të “zbythjes” nga zyra të Lulzim Bashës dhe të tijve, doli në një konferencë për shtyp për të lançuar suksesin e kapjes së fajtorëve. Punonjësi i tatimeve Agaraj ia kishte shitur për 20 mijë – 30 mijë lekë databazën “excel” disa herë “përmbaruesve privatë” Sota dhe Ikonomi.



Shteti u dorëzua me gjithë kryeministrin e tij, brenda një dite kur pa se shakaja me “patronazhistë” nuk mund të bëhej më, sado bukur të tregohej. Të dhënat sensitive të shqiptarëve, po përhapeshin në botën digjitale në formë eksponenciale nga ora në orë.

për 694.473 qytetarë shqiptarë. Tabela mbante dhe një databazë tjetër si faqe të dytë: Numrat e telefonit celular për 910.061 qytetarë.

• Në të njëjtën ditë (23 Dhjetor) u përhap një excel i tretë, me të dhënat mbi “Targat/ automjetet” e 591.965 qytetarëve shqiptarë.

Shteti u dorëzua me gjithë kryeministrin e tij, brenda një dite kur pa se shakaja me “patronazhistë” nuk mund të bëhej më, sado bukur të tregohej. Të dhënat sensitive të shqiptarëve, po përhapeshin në botën digjitale në formë eksponenciale nga ora në orë. Shteti s’mund të ndalonte asgjë, thjesht filloi të shfajësohej duke pranuar “fajin” për rrjedhjen dhe vjedhjen e rëndë të të dhënave sensitive dhe personale të shtetasve të vet.

### SHTETI KAP “FAJTORËT”

Ndjeshmëria popullore për daljen e “rrogave” rezultoi më e madhe se kur të njëjtët “viktima” digjitale lexuan se kush ishte patronazhisti i tyre që, komentonte dhe garantonte votën e fshehtë. Pagat po përpiheshin me kuriozitet të ethshëm, pastaj me seriozitet nga të gjithë pagamarrësit e Janarit dhe Prillit 2021. Dolën ca të vërteta që shteti nuk mund t`i justifikonte si zakonisht. Çështja “paga” mund të ishte një bombë psikosociale me të cilën as armët politike nuk mateshin dot. Ndaj shteti veproi menjëherë dhe… kapi fajtorët me shpejtësi shembullore, nga Krishtlindjet deri në Vit të Ri.

Eni Qirjako, Andi Agaraj - punonjës të tatimeve dhe dy biznesmenët Klodian Sota dhe Endri Ikonomi kapen nga shteti dhe nxirren para popullatës që ende nuk po gëlltiste dot të vërtetat “excel” të pagave Janar - Prill 2021.

Prokuroria në 7 Janar 2022, një ditë para datës finale të “zbythjes” nga zyra të Lulzim Bashës dhe të tijve, doli në një konferencë për shtyp për të lançuar suksesin e kapjes së fajtorëve. Punonjësi i tatimeve Agaraj ia kishte shitur për 20 mijë – 30 mijë lekë databazën “excel” disa herë “përmbaruesve privatë” Sota dhe Ikonomi.

Të dhënat mediatike dhe të prokurorisë u përplasën për dy emrat e biznesmenëve “përmbarues” që kishin blerë databazat dhe më pas i kishin nxjerrë për publikun. Nuk u tregua arsyeja apo qëllimi i tyre për këtë shpërndarje.

Në të njëjtën ditë, Dhoma e Përmbaruesve akuzoi prokurorinë dhe median për prishje të “imazhit”, duke deklaruar se Klodian Sota dhe Endri Ikonomi, nuk ishin përmbarues por mashtrues që merreshin me mikrokredi.

Të dhënat e publikuara në të njëjtën ditë nga media të ndryshme hodhën dritë mbi fakte interesante që prokuroria nuk i preku:

• Endri Ikonomi kishte qenë deri në shtator 2021 administrator i kompanisë “Credit 2 ALL” sh.p.k. Kompania “Credit 2 ALL” ishte krijuar në vitin 2017 për konsulencë dhe aktivitet mbi sistemet e informacionit. Kompania ishte blerë nga një miliarder rus, i quajtur Oleg Boiko, pr-



smile.al
DHURO
PËR NJË BUZËQESHJE!
FUQIZIMI I SHOQËRISË
DHE INOVACIONIT
E-mail: info@smile.al

onar i një grupi financiar, me qendër në Zvicër. Miliarderi rus Oleg Boiko akuzohej nga një raport i kongresit amerikan si person i lidhur me ndërhyrjet ruse në zgjedhjet amerikane.

• Endri Ikonomi kishte krijuar dhe një kompani tjetër, të quajtur "PRO 3VT"sh.p.k. në qershor 2020. Kjo kompani në QKB ishte regjistruar si Institucion mikrokredie, por në Regjistrin e Bankës së Shqipërisë kompania nuk dilte si e licensuar.

• Nga ana tjetër, biznesmeni Klodian Sota, personi që blinte për 20-30 mijë lekë excel-et me të dhëna nga Andi Agaraj, kishte krijuar kompaninë "SMART COLLECTION" sh.p.k. për mbledhje borxhesh. Kompania sipas përmbaruesve në denoncimin e tyre publik ishte një "Barakë Financiare" si disa të tjera të kësaj natyre, që mblidhte borxhe duke shantazhuar dhe mashtruar qytetarët.


Endri Ikonomi


Klodian Sota

Si u arrestuan me bujë të madhe, të katër "fajtorët" u liruan nga Gjykata e Tiranës. Gjykata vendosi masën e sigurisë "arrest shtëpie" për Klodian Sotën, Endri Ikonomin dhe Andi Agarajn, ndërsa Eni Qirjaku u la në masën e sigurisë "detyrim paraqitje".

Akuzat ndaj 4 "fajtorëve" që shkaktuan tërmetin publik, u shfrynë në gjykatë, ashtu si akuzat e të gjithë të arrestuarve për sulmin me "tokmak" të godinës së PD-së në 8 Janar 2021. Të gjithë u lejuan të shkojnë nëpër shtëpitë e tyre. Hetimi në Shqipëri si ngaherë gjen "fajtorët" por nuk e vërteton dot fajin e tyre para gjykatës.

Fabula e hedhur në publik nga letrat që "i rrëshqasin" si përherë sekretit hetimor, tregoi një histori diletantësh ordinerë që kishin bashkëpunuar me njëri - tjetrin sikur kishin vjedhur dhe shitur një biçikletë në një qytet periferik. Eni Qirjako i kishte dhënë me e-mail sa herë ia kërkonte tabelat e pagave shokut të punës në Drejtorinë e Tatimeve, Andi Agaraj. Ky nga ana e tij, megjithëse në gjykatë u mbrojt se i kërkonte për "qëllime studimore" u vërtetua nga hetimi që i kishte shitur tek Klodian Sota për 20-mijë lekë. Klodiani nga ana e tij i shiste për 30-mijë tek Endri Ikonomi. Nuk dihet ende se si ky i fundit ia shiti popullatës mbarë dhe për sa para. Hetimi vazhdon…

**DREJTESIA E ZHVESHUR NGA "WHATSUPI"**

Kur excel-i i fundit doli në pazarin digjital, u cënua rëndë jo vetëm siguria e qytetarit shqiptar por dhe ajo e sigurisë kombëtare. Disa link-e ekseli të paorganizuara në "whatsup", sollën një përçarje të fortë popullore. Sikur këto të dhëna të studiohen, analizohen dhe kryqëzohen nga individë, grupe apo struktura me synime jo të mira, apo ato kriminale, me siguri që do linte pa gjumë edhe vetë autoritetet e shtetit bashkë me strukturat që përgjigjen për sigurinë kombëtare. Dekonsipirimi i të dhënave, të identiteteve të punonjësve të shtetit në çdo strukturë dhe i familjarëve, veçanërisht atyre të sistemit të drejtësisë, prokurori, gjykata, polici, shërbim informativ, pa lënë pas shërbimin ushtarak, tatimet, doganat, do i kthejnë punonjësit që mbajnë këto detyra, në shënjestra të lehta të krimit brenda dhe jashtë vendit.

Rreziku elektronik është sot problem për shumë vende të zhvilluara të nivelit Gjermani, Itali, USA. Imagjinohet Shqipëria pas kësaj rrjedhje totale informacioni konfidencial dhe sensitiv.

Ndoshta kjo mund të jetë dhe një nga arsyet ose shkaqet që vetë SPAK nuk veproi në Prill 2021 kur rreth 160 qytetarë denoncuan vjedhjen e të dhënave personale nga Patronazhistët. Prova që s'kishin nevojë për një hetim të mirëfilltë profesional vërtetonin se numrat e telefonit të qytetarëve ishin marrë apo vjedhur nga portali e-Albania, kur këta kishin hapur llogari të detyrueshme për të përfituar nga shërbimet online. Portali e-Albania, në administrim të AKSHI-t, si pika e vetme e kontaktit,

*Faksimile e rekomandimit të komisionierit për të drejtën e informimit lidhur me "patronazhistët"


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 861/4 prot.

Tiranë më 19.8.2021

REKOMANDIM
Nr. 44, datë 19.8.2021
PËR KONTROLLUESIN "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar (në vijim, *"Ligji"*), ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"* (në vijim, *"Kodi i Procedurave Administrative"*), relacionit të hetimit administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve, datë 19.08.2021 (në vijim, *"Relacioni i Hetimit Administrativ"*), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrollesit *"Partia Socialiste e Shqipërisë"* (në vijim, *"Kontrollesi"* dhe/ose *"PSSH"*),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 57, datë 05.05.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, *"Komisioneri"*), u krye hetimi administrativ kryesisht, pranë Kontrollesit, me objekt:

➤ *Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike, si dhe verifikimi i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit.*

Zyra e Komisionerit, bazuar në pikat 1.5 dhe 1.6 të Pjesës 1, si dhe Pjesën 2, të Relacionit të Hetimit Administrativ, si dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Referuar deklarimeve të përfaqësuesve, konstatimeve në vend, si dhe të dhënave të web-ndërfaqes online të listës së zgjedhësve që administron PSSH, rezulton se ky kontrollues disponon dy kategori baza të dhënash. Konkretisht, njëra konsiston në të dhënat e anëtarëve të partisë dhe e dyta konsiston në të dhënat e listës së zgjedhësve.

Të dyja bazat e të dhënave mund të aksesohen nga një web-ndërfaqe e vetme online. Web-ndërfaqja online është e pajisur me 'emër përdoruesi' dhe 'fjalëkalim' për çdo nivel përdoruesi.

KOMISIONERI

që mundëson aksesin për aplikim në shërbimet elektronike online të ofruara nga administrata publike, sipas kategorive të ndryshme, është jo vetëm provë e pakundërshtueshme, por tashmë ky portal mbetet një minë me sahat që mund të plasë më fort se në dhjetor 2021 po nuk u mor në kontroll shtetëror.

Kontrolli shtetëror nga ana e tij është i ekspozuar keq pas daljes së ekselëve me të dhëna sensistive numrash telefoni, identitetesh, adresash, targash të punonjësve apo familjarëve të tyre të "SPAK", "BKH", "DPPP", "DPT", etj. Imagjinohet se një invasion psikologjik ka filluar të ndjehet tek këto struktura thjesht për faktin se ata njihen tashmë publikisht, dihet sa paguhen dhe detajet e kryqëzuara të informacionit mbi ta, do i bënin këto struktura krejt të padobishme për misionin që janë ngarkuar të kryejnë.

### DREJT EVROPËS ME TRANSPARENCË DHE "LAKURIQËSI"

Duke filluar nga Kushtetuta e Shqipërisë që nuk lejon të bëhen publike të dhënat personale pa pëlqim vetjak (neni 35) në legjislacionin tonë penal gjendet një korpus i tërë nenesh që dënojnë veprat penale në këtë drejtim.

Sipas avokatëve penalistë, Kodi Penal ka shtatë nene që dënojnë seriozisht konsumimin e këtyre veprave penale (nenin 122, nenin 143/a/2, nenin 293/a, nenin 293/ç, nenin 294, nenin 295, nenin 295/a). Asnjë prej këtyre neneve nuk u përdor për rastin e hetuar të patronazhistëve nga SPAK , apo të katër "fajtorëve" që nxorrën linqet e "pagave" dhe "targave" nga Prokuroria e Tiranës. Kjo është një pikëpyetje juridike dhe teknike po aq sa edhe natyrale, kur kujtohet se çfarë të bën Evropa apo USA kur ju nxjerr të dhënat pa leje shtetërore. Ata i quajnë "liking data" dhe protagonistët "tradhëtarë të kombit". Rasti Eduard Snoweden është më kuptimploti në këtë drejtim.

Shqipëria ka një ligj për mbrojtjen e të dhënave personale. Ligjin me nr. 9887, të vitit 2008. Zyrtari që mbron të dhënat e qyetarëve quhet Komisioneri për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit". Kjo zyrë me një staf që paguhet goxha mirë për të na ruajtur ne dhe "veten" nga rrjedhje të tilla si ajo e vitit 2021, u ekspozua më shumë se sa keq në rastin e patronazhistëve kur doli me një vendim administrativ **(VENDIMI FOTO*)** proqeveritar. Mungesa e pavarësisë së plotë që deklaroi kjo zyrë në këtë situatë kaq flagrante, tregoi anën komike sa dhe unike të funksionimit të shtetit shqiptar.

Për rastin e "pagave" kjo zyrë me siguri po pret hetimet e prokurorisë, para se të shprehet me rekomandimet e radhës proqeveritare përkundër ekspozimit kriminal të të dhënave sensitive dhe personale të të gjithë qytetarëve


Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Linda Karçanaj

të Shqipërisë.

Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit e qujatur AKSHI, me Ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" ka patur dhe ka çdo ditë përgjegjësinë direkte që nëpërmjet "Autoritetit Rregullator Koordinues" të sigurojë bazën e të dhënave shtetërore nga çdo problem i mundshëm.

Ngjarja e katër "fajtorëve" ku dy prej tyre janë direkt punonjës të AKSHI-t pavarësisht se u referuan si punonjës IT të tatimeve, tregoi "lakuriqësinë" e këtij institucioni.

Mosrespektimi i asnjë standardi bashkëkohor si ai ISO/IEC 27001 nga AKSHI, degjeneroi në rrjedhjen e të dhënave pa asnjë pengesë apo bllokim.

Katër "fajtorët" janë viktimat e një episodi që u kryqëzuan publikisht por jo ligjërisht. Lehtësia e marrjes apo nxjerrjes së të dhënave nga pajisjet e AKSHI-t në institucionet e shtetit shqiptar, do duhet të futet në analet historike të "pasigurisë kibernetike", ku me një USB çfarëdo dhe me 200-mijë lekë mund të kesh shtetin të pasqyruar në një telefon smart.

Historia e fajit shtetëror është më e madhe se ajo e katër "fajtorëve". Të gjithë kanë vite që ndjekin në TV, anoncime dhe reklama se si merret një kredi lehtë, online, madje për 7 minuta nga kompani mikrokredie. Shembuj tipikë janë Iutekredit dhe Kredo.al. Këto kompani "përpunojnë" të dhënat personale të çdo personi që paraqitet për të marrë kredi konsumatore për disa minuta. Si mund t'i përpunojnë të dhënat e një individi për pak minuta sa të "besojnë" të japin para këto kompani? Si sigurohen për punësimin, adresën dhe të dhënave të tjera kur qytetari dorëzon vetëm kartën e identitetit personal?

Në qendrat e mëdha të biznesit në Shqipëri, po të ndiqet puna rutinë e një shitësi mallrash, kjo mund t'i ofrojë prokurorisë fakte reale të "rrjedhjes" së të dhënave personale të qytetarëve. Të dhënat personale të secilit qytetar sigurisht që janë blerë nga këto biznese me qendra offshore në të njëjtën formë si blerja që po heton prokuroria për katër "fajtorët" që njohu publiku. Ata kanë çdo të dhënë që ju duhet për të "gjetur" më pas qytetarin që nuk paguan mbrapsht borxhin që lindi për shkak të blerjes së një lavatrice, televizori apo sobe me minikredi. Prokuroria aludoi se mund të jetë duke hetuar edhe në këtë drejtim, por nuk përmendi këto kompani.

> Shumë familje dhe individë kanë humbur gjatë vitit të ri 2022, ekuilibrin emocional. Janë dekurajuar shumë të rinj në vetëvlerësimin profesional dhe individual, ndërsa kanë parë nivelin dhe disnivelin e "rrogave". IT dhe Infermierë nuk mund të presin më asnjë sekondë dhe të punojnë pranë AKSHI-it dhe QSUT-së.



Si do mbrohemi sot, kur në aspektin psikosocial të shoqërisë është hedhur një bombë e tillë pesimizmi – rrogat?

Shumë familje dhe individë kanë humbur gjatë vitit të ri 2022, ekuilibrin emocional. Janë dekurajuar shumë të rinj në vetëvlerësimin profesional dhe individual, ndërsa kanë parë nivelin dhe disnivelin e "rrogave". IT dhe Infermierë nuk mund të presin më asnjë sekondë dhe të punojnë pranë AKSHI-it dhe QSUT-së.

Rrjedhja e rëndë abuzive me të dhënat personale të shtetasve shqiptarë, nxorri në këtë dimër të ftohtë pandemik dy trupa lakuriqë, shtetin shqiptar dhe popullatën e tij.

ATLAS

*Pasion për cilësi*

# MIELLI ASSOS




# MIELLI I PARË SHQIPTAR BIO

IQNet

ZERO NITRATE
I PASUR ME MAGNEZ

PREMIUM
QAFSHTAMA
UJI I SHËNDETIT
Nr:1
Albanian Mineral Water



# NË FORMATIN 19 L

**FURNIZIMI VJEN SË BASHKU ME PAJISJEN PËR UJË TË FTOHTË DHE TË NGROHTË**

**KONTAKT:**

**0697009900**



www.qafshtama.com




Faksimile e një memo të PS-së shpërndarë përpara zgjedhjeve të 25 prillit 2021

## RRËFEHET GAZETARI QË ZBULOI SKANDALIN

# DORIAN KODRA: "PATRONAZHISTËT" I GJETA LEHTË, QARKULLONIN NË SHUMË DUAR...

Më 11 prill 2021, vetëm 2 javë përpara zgjedhjeve të 25 prillit, Lapsi.al publikoi "skandalin e patronazhistëve", një databazë me të dhënat e 910 mijë votuesve në Tiranë. Ajo që u quajt më pas nga mediat e huaja një "Big Brother përgjimesh", u bë temë e përditshme përplasjesh politike deri në zgjedhje. Por, jehona vazhdon edhe sot.

Dorian Kodra është gazetari që publikoi për herë të parë artikullin me titull "Ja si na monitoron Rilindja nr. e ID, nr. e telefonit, vendet e punës për votuesit në Tiranë".

Në këtë intervistë për "Newsbomb", Kodra tregon si ra në kontakt me databazën e të dhënave që dispononte PS.



**Zoti Kodra, si e zbuluat lajmin e patronazhistëve? Kishit dëgjuar më parë për një listë të tillë, shkuat ju tek lajmi apo erdhi lajmi tek ju?**

Jam interesuar për mënyrën se si funksionon sistemi i patronazhimit në Partinë Socialiste, fillimisht për shkak të ankesave që kisha dëgjuar nga punonjës të administratës shtetërore. Gjatë fushatës elektorale, shumë prej tyre ishin nën presion për të bërë pëlqime/ shpërndarje dhe komente për çdo status të kryeministrit Edi Rama dhe të kandidatëve të Partisë Socialiste në Facebook. Përndryshe kërcënoheshin me largime nga puna.

Personalisht nuk kisha dijeni për ekzistencën e databazës me të dhëna personale. Kisha disa dëshmi për kërcënime nga puna dhe një memo që e hasa rastësisht në rrjetet sociale, e publikuar atëherë nga aktori Jul Deda ku përmendej "patronazhimi". Nisa të pyes pikërisht për fenomenin e presioneve në administratën shtetërore.

Më rezultoi se puna e patronazhistëve ishte dixhitalizuar dhe dirigjimi i të gjithë sistemit ishte perfeksionuar më tej.

E vërteta është që databazën me të dhënat personale e kam gjetur lehtësisht gjatë ditëve të fushatës në radhët e anëtarëve të PS. Kishte edhe socialistë apo socialiste të pakënaqura nga një rrjedhje e tillë të dhënash. Numrat e telefonit të gjithsecilit kishin rënë edhe në duar të gabuara. Duke qenë se ishte krijuar pikërisht për t'u përdorur në fushatë, databaza qarkullonte në dijeninë time në shumë duar. Jo rastësisht, u shpërnda menjëherë, sapo kolegë nga media të tjera mësuan për ekzistencën e saj.

**A prisnit të kishte aq reagim?**

Një lajm i tillë do të konsiderohej "scoop" nga çdo gazetar, por që do të merrte përmasa të tilla, nuk e mendova. As nuk e kisha imagjinuar, që prokuroria do të hetonte drejtuesit e portalit Lapsi.al dhe që do të tentonte të sekuestronte kompjuterat e redaksisë dhe celularët e gazetarëve. Kjo ishte e paimagjinueshme. Grumbullimi dhe kryqëzimi i të dhënave për 910 mijë banorë të Tiranës ishte e pamundur të "shpikej" nga gazetarët.

**Pse mendoni se nuk ka asnjë të penalizuar për këtë rrjedhje të dhënash?**

Në intervistën për Lapsi.al, burimi i lajmit më ka rrëfyer se sistemi që përdorin drejtuesit politikë të Partisë Socialiste në qarqe është shumë më i sofistikuar se databaza që u publikua. Besoj se askush nuk do të penalizohet për këtë, pasi një sistem i tillë kontrolli mbi zgjedhësit do të vazhdojë të përdoret edhe në zgjedhjet e tjera dhe institucionet tona të drejtësisë ende nuk e kanë ende fuqinë të godasin në nivelet më të larta të qeverisjes. Prokuroria nuk trokiti asnjëherë në dyert e zyrave të fushatës zgjedhore të asnjë partie për Tiranën.



# NXJERRJA E PAGAVE

# CILI ËSHTË DËMI EKONOMIK?

Për nga përmasat e të punësuarve të përfshirë, i yni përbën skandal unikal në botë për rrjedhjen masive të të dhënave mbi pagat dhe mbi numrat personal të qytetarëve. Po ashtu, nëpërmjet patronazhistëve, dolën në shesh dhe numrat e telefonit të shumë qytetarëve. Skandali u pasua me daljen e të dhënave të targave të automjeteve...

Nga **FATOS ÇOÇOLI**

Më 21 dhjetor 2021 në mbrëmje, përmes aplikacionit të telefonisë celulare "Whats'App" qarkulloi publike (mund ta merrte çdokush që ka telefon celular inteligjent) një bazë të dhënash (në anglisht "database") e 637,183 qytetarëve tanë, me numrat e tyre të kartës së identitetit, numri i NIPT po të kishte biznes të vetin, emër, mbiemër, si dhe rroga që çdo qytetar ka marrë në muajin janar 2021. Bëhet fjalë për shumicën dërrmuese të punonjësve të rregjistruar sipas ligjeve në fuqi, të cilët punojnë në shtet dhe në sektorin privat.

Më 22 dhjetor, një ditë më vonë, publikohet një tjetër listë po në formatin Excel, këtaj rradhe me rrogat e prillit 2021 dhe me të dhënat private dhe të ndjeshme të 694,473 qytetarëve shqiptarë, rreth 60 mijë më shumë se lista e janarit.

**PËRMASAT E SKANDALIT**

Deri tani në këtë shekull, pra në shekullin e 21, në botë kanë ndodhur 15 rrjedhje të rëndësishme të dhënash personale dhe sensitive të qytetarëve, kryesisht përdorues të platformave kërkuese në internet, si dhe të rrjeteve sociale, të tilla si Yahoo (gusht 2013), Alibaba (nëntor 2019), Linkedin (qershor 2021), Facebook (prill 2019) e me rradhë.

Skandali më i madh dhe më i njohur i rrjedhjes së të dhënave (ne anglisht "data leaks") është pa dyshim skandali me emrin e platformës online WikiLeaks (https://www.dailymail.co.uk/news/fb-5511985/The-WikiLeaks-scandal.html) në maj 2010, ku u publikuan më shumë se 700 mijë dokumente, video dhe kabllograme diplomatike sekrete të qeverisë së SHBA-ve.

Deri tani në botë ka patur raste (sidomos në vende të Amerikës Latine dhe në Afrikë) të zbulimit dhe bërjes publike të listë-pagesave. Por këto kanë ndodhur vetëm për kompani të ndryshme të mëdha, ose punonjës të sektorëve të ndryshëm (në naftë, shëndetësi, etj.) të shteteve përkatëse. Asnjëherë në nivel tërësor të të punësuarve. Në asnjë rast, nuk ka ardhur publikimi i plotë, zhveshja lakuriq e të dhënave



personale dhe sensitive të qytetarit-punëmarrës, sikurse na ndodhi ne në Shqiperi, ne skandalin e 21-22 dhjetorit 2021 të publikimit të rrogave të mbi 67% të qytetarëve të punësuar (duke përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi dhe pak përjashtime të tjera), *(Shih Tabelën 1)*.

**TABELA 1. TË PUNËSUARIT NË SHQIPËRI**

| Nr. | Treguesi | Numri në Nëntor 2021 |
|---|---|---|
| 1 | Të punësuarit në shtet | 121 mijë vetë |
| 2 | Të punësuarit e deklaruar në privat | 484,000 mijë vetë |
| 3 | Të vetëpunësuarit në qytet dhe në fshat | 413 mijë vetë |
| **Mbi 67% të të punësuarve në privat dhe në shtet u janë publikuar rrogat!** | | |

Burimi: INSTAT, institute jo-publike kërkimi

Databaza përmban numrat personalë, emrat, subjektet punëdhënëse, NIPT-i i tyre, si dhe pagën mujore të të gjithë personave të regjistruar si të punësuar në sektorin publik dhe atë privat në Shqipëri. Madje edhe sa orë kanë punuar!

### DËMI EKONOMIK I SKANDALIT TË PUBLIKIMIT TË PAGAVE

Dëmi ekonomik që i është shkaktuar ekonomisë dhe shoqërisë sonë në përgjithësi është shumëplanesh dhe i thellë. Në mënyrë të koncentruar, ai mund të përmblidhet në tabelën 2 si më poshtë:

**TABELA 2. DËMI ESENCIAL EKONOMIK I SKANDALIT TË PAGAVE**

| Nr. | Dëmi | Përshkrimi | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Dëm në imazhin e sigurisë së vendit | Shkurajim i përkohshëm planesh e projeksionesh të investimeve të huaja në vend | 32 milionë euro |
| 2 | Dëm i rëndë në imazhin e sigurisë së të dhënave në institucionet e Shtetit shqiptar | Stepje dhe mungesë bashkëpunimi në nivel të projekteve të përbashkëta me shtetet e tjera dhe institucionet ndërkombëtare | 15 milionë euro |
| 3 | Dëm në planet e reja të investimit të kompanive private | Janë goditur praktikat e punësimit në këto kompani, për shkak të zbulimit të të dhënave personale të kandidatëve për punësim dhe pengimit të investimeve të ardhshme, të bazuara mbi sigurimin e stafit të ri | 3 milionë euro |
| **TOTALI** | | | **50 milionë euro** |

Mjaft problematik është edhe fakti se në databazën e publikuar, pasqyrohen edhe shpenzimet për pagat e informatorëve të Shërbimit Informativ Shtetëror në Tiranë si edhe rrethe.

Për fat të mirë, emrat e të punësuarve të tillë nuk janë pasqyruar në dokumentet e skandalit.

Ajo që bie në sy është edhe fakti se pagat e deklaruara në nivele më të ulta, janë shumë më të vogla krahasuar me realitetin, duke dëshmuar kësisoj se bizneset në Shqipëri, vijojnë të operojnë masivisht me dy bordero.

Kur bien sistemet e sigurisë të një shteti, ka rënë i gjithë shteti!

Qeverisë sonë sot duket se i ka mbetur një sistem i vetëm në këmbë, ai i papërgjegjshmërisë absolute. Në sajë të papërgjegjshmërisë dhe të kërkimit zero të llogarisë, të ngritur në sistem, sot gjithkush mund të futet e të na marrë të dhënat e kartës së identitetit, të dijë për rrogën që marrim, pasurinë që kemi vënë si qytetarë, kreditë që kemi marrë në bankë.

Qeveria sot zotëron të gjithë informacionin personal kyç të qytetarëve (të dhëna për kartat e tyre të identitetit, për të ardhurat, për automjetet që kanë, për pronat në hipoteka, për marrëdheniet e tyre me bankat, etj.), të mbrojtur nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe vete e bën pronë të kujtdo nëpërmjet rrjedhjes më skandaloze të informacionit në botë!

Ndërsa ne si qytetarë, nuk kemi të drejtë dhe akses të dimë si shpenzohen paratë tona, si bëhen tenderat, kush janë kompanitë që marrin miliona euro nga taksat tona. Ne sot, për shkak të menaxhimit skandaloz qeveritar, mund të na dinë gjithçka: numrin e kartës së identitetit, rrogën, kreditë në banka, automjetin dhe targën, por ne si qytetarë që me taksat tona e mbajmë këtë shtet, nuk kemi mundësi të dimë se kush i merr paratë tona me sigla kompanish ekzotike apo guackë nëpër tendera publikë, në kufirin limit të fondeve.

Kjo rrjedhje është shumë më e rëndë nga skandali i WikiLeaks mbi informacionet konfidenciale (kabllogramet) të ambasadave amerikane në botë dhe nga skandale te tjera te shumë të dhënave konfidenciale e private të nxjerra në publik (https://www.csoonline.com/article/2130877/the-biggest-data-breaches-of-the-21st-century.html ).

VJEDHJA E PARALAJMËRUAR

# SI U ZHDUK SERVERI I TATIMEVE NË 2013

Nga NIKOLETA KOVAÇI

Në fund të nëntorit 2013, këshilltari i kryeministrit shkon te drejtoria e Tatimeve dhe urdhëron drejtorin e IT Renald Rista të merrte të gjitha të dhënat e bizneseve. Siç thotë prokuroria në dokumentet e saj, Këshilltari i kryeministrit shoqërohej nga deputeti Spartak Braho. Ish-drejtori i IT së tatimeve refuzoi të jepte të dhënat që sipas tij ishin sensitive, por më pas u urdhërua nga Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve. Çfarë hetoi prokuroria në dy vjet dhe çfarë nxorri në dritë? A pati ndonjë përgjegjës për zhdukjen e të dhënave nga sistemi për disa ditë me radhë?

Hije dyshimi mbi urdhërat e dhënë dhe mundësia e vjedhjes së të dhënave të biznesit.

'Newsbomb' disponon të plotë çdo moment të asaj jave që shënoi skandalin, me orë, minuta, biseda, akuza, kundërakuza dhe deri në momentin kur policia shoqëron stafin prej 22 personash të drejtorisë së IT-së së këtij dikasterit. Aso kohe u pretendua se për më shumë se 5 ditë serverat nuk u ndezën për të shënuar asnjë veprim, fakt që prokuroria nuk e shënoi në vendimin e pushimit të saj të publikuar në fundin e tetorit të dy viteve pas shpërthimit të skandalit! Mediat arritën të merrnin pamjet filmike të hyrjes në ambientet e Tatimeve të deputetit Spartak Braho dhe të këshilltarit të kryeministrit Ermal Beqiri, por akuza nuk vërtetoi ndonjë shkelje me praninë e tyre në drejtori. Gjithçka u tha se nisi si një kontroll auditi, në krye të të cilit gjendeshin Ermal Beqiri dhe Panajot Gjiknuri. Prokuroria arriti të dokumentonte gjithë dinamikën e më shumë se një jave të përfshirjes së 'grupit të auditit', mbështetur nga drejtoresha e Tatimeve, Brisida Shehaj për të mundësuar klonimin e qindra mijëra të dhënash që gjendeshin në servera. Madje u pretenduan se këta servera u kopjuan dhe u çuan në një ambjent tjetër jashtë territorit të Tatimeve po prokuroria nuk ka mundur ta vërtetojë këtë gjë. Skandali u mbyll me pushim të procedimit dhe me faktin: Nuk kishte elementë të veprës penale!

**RAPORTI**

Në 15 faqe të pushimit të çështjes nga Prokuroria e Tiranës, sqarohet gjerë e gjatë se kush ishin takimet e veprimet e personave të përfolur që nga data 12 nëntor 2013 e deri kur policia ndaloi plot 22 persona.


Brisida Shehaj, ish-Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve


Ermal Beqiri

Spartak Braho

Skandali i parë i vjedhjes së serverit të tatimeve në 2013. Cili ishte roli i deputetit Spartak Braho e këshilltarit të kryeministrit? Pse u pushuan hetimet nga prokuroria e Tiranës dhe a pati fajtorë mes 22 të ndaluarve nga policia e shtetit? A u fikën ndonjëherë serverat e Tatimeve? A u zhdukën bilancet e kompanive?



Sipas kronologjisë së ngjarjeve të atyre ditëve, me 24.11.2013 Renald Rista dhe Elton Ropi u paraqiten në gjykatë për t'u njohur me masën e sigurisë. Gjykata e cilësoi arrest të paligjshem veprimin e policisë dhe caktoi masë detyrim paraqitje deri në përfundim të plotë të hetimeve. Aso kohe u tha se më 27.11.2013 Renald Rista ishte njoftuar se ishte pezulluar nga detyra me vendim, deri në përfundim të hetimeve. Po ashtu u tha se serverat e tatimeve ishin të fikur nga data 25.11.2013 deri në datën 05.12.2013. Rista i tha prokurorisë se "Serverat dhe sistemet janë mbajtur të fikur deri në datën 05.12.2013 (nuk dihet i kujt ka qenë vendimi për t`i mbajtur fikur këto shërbime) dhe po në datën 05.12.2013 Ministria e Financave deklaroi se shërbimet janë operative dhe funksionale por, nga të gjitha shërbimet punonte vetëm faqa e internetit dhe asnjë nga sherbimet e deklarimit (të librave të shit-blerjes, TVSH, TF, faqja e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, list-pagesave etj). Po ashtu aso kohe u tha se shumë biznese nuk ishin në gjendje të shihnin deklaratat e tyre, gjë që çoi në dyshimin se të dhënat nuk ishin rikuperuar! Por më vonë, hetimet e thelluara, dhe mjaft të debatuara deri në Komisionin e Sigurisë të prokurorisë nuk rezultuan se kishte patur fshirje të dhënash, duke bërë që të dy palët të dilnin të pacënuar nga ajo histori që sot e asaj dite konsiderohet si 'Skandali i vjedhjes së serverave të Tatimeve".

**MBYLLJA E HETIMIT DHE PUSHIMI I ÇËSHTJES**

Prokuroria e Tiranës njoftoi se kishte përfunduar hetimet dhe kishte kërkuar pushimin e çështjes për fshirjen e të dhënave në Serverat e Tatimeve. Prokuroria rreth dy vite më vonë tha se përgjatë vitit 2013 nuk kishte patur asnjë fshirje të dhënash, ndryshe nga sa pretendonte ish drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Brisida Shehaj. U tha se serverit iu kishin kryer dy akt ekspertimi, në të parin policia shkencore nuk i kishte kapacitetet teknike dhe logjistike për ngritjen e serverit në gjendje pune dhe se nuk njihnin politikat e menaxhimit të serverit për të parë nëse ka fshirje apo jo. Ekspertimi i dytë i kryer në prillin e vitit 2015 evidenton se nga analiza e fileve nuk konstatohet asnjë e dhënë për fshirjen e deklarimeve pasi të dhënat ekzistonin në të dy skedarët e përcaktuar.

**NË RAPORTIN E PUBLIKUAR ASO KOHE THUHEJ:**

*"Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, mbia bazën e akteve të referuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, seksioni kundër Krimit Kompjuterik, më datën 22.11.2013 regjistroi procedimin penal nr 66 38 për veprat penale të;*

*a-"ndërhyrja në të dhënat kompjuterike dhe shpërdorim i detyrës parashikuar përkatësisht nga nenet 293/b dhe 248 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit Renald Rista dhe*

*b-'hyrje e paautorizuar kompjuterike parashikuar nga nenin 192/b të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit Elton Robi".*

Po a u zhdukën përkohësisht të dhënat në sistem ato ditë? Ekspertët thanë se "Proceset e brendshme që ekzekutoheshin në DPT për transportim, transferim, transformim, pastrim të dhënash mund të përfshinin operacione "TRUNCATE"; "DELETE"; "DROP". Shpesh në këto mjedise ku këto procese nuk janë plotësisht automatike mund të ndodhnin edhe gabime në konfigurime që mund të sillnin anomali. Ata thanë se të dhënat ishin në database dhe plotësisht të rikuperueshme. Ajo çfarë kishte ndodhur është anomali elektronike pa ndërhyrje të qëllimshme të individëve të caktuar.

**PËRFUNDIMI SIPAS PROKURORISË!**

*...pas ngjarjes ambientet dhe serverat e DPT kanë qenë të sekuestruar për nevojë të kryerjes së verpimeve hetimore deri në datën 25.11.2013 dhe nuk rezulton që serverat të jenë mbajtur të fikur për shkak të ndërhyrjeve të grupit të auditit pasi ky grup është larguar nga DPT që më në datën 18.11.2013.*

*Për sa më sipër duke qenë se në procedimin nr. 6638 të vitit 2013 nuk ka të konsumuar elementë të veprës penale të regjistruara dhe të hetuara apo të ndonjë vepre tjetër penale ndaj të hetuarve dhe atyre të kallëzuar nga shtetasi Renald Rista, ky provcedim penal pushohet për shkakun se në faktet e paraqitura nuk rezulton elementë që përbëjnë vepër penale. Për arsyet e lartpërmendura, bazuar në nenin 328/1, pika a të Kodit të Procedurës Penale*

*Vendosëm*

*1-Pushimin e procedimit penal nr 6638 të vitit 2013 në ngarkim të shtetasve Elton Robi dhe Renald Rista për veprat penale të parashikuara nga nenet 192/b, 293/b dhe 248 të Kodit Penal si dhe për faktet e kallëzuara si vepër penale nga shtetasi Renald Rista"!*



Renald Rista, ish-drejtori i sektorit të IT-së

# OSE S'KANË LEKË, S'KANË MEND!



**Nga LUELA MYFTARI**

## Çfarë gatuan televizionet shqiptare për fundvit? A hodhën para për të investuar në realizimin e spektakleve me humor e muzikë? Çfarë pritëm e çfarë shijuam këtë ndërrim vitesh në ekranet shqiptare?

Na ishte një herë një armik i padukshëm, një virus që qarkullonte në të gjithë botën, një pluhur magjik që na pengoi disi këto dy vite që të lëvizim, të shijojmë natën e ndërrimit të viteve me njeriun e zemrës pranë ndriçimit të kullës Eifel apo në sheshin e njohur të Vienës, ku karrocat me kuaj të ftojnë të mos kesh turp të nisësh vallëzimin pikërisht aty.

Ëndrra me sy hapur për disa, luks për disa të tjerë pa diskutim, por këtë periudhë fillimviti na lejohet të ëndërrojmë ndonëse lista e dëshirave është formuluar para Krishtlindjes dhe alternativa e vetme, na mbetet nata e ndërrimit të viteve pranë personave të zemrës; me tavolinën plot me dolli dhe padiskutim përballë televizionit, ku muzika alternohet me humorin e ku spektaklet nuk do të na lodhin kokën me politikën apo ngjarjet e shëmtuara të një viti që po lëmë pas. Për disa, njëlloj sikurse edhe për mua, koncerti i Vjenës, ai tradicionali që mbahet prej Filarmonikës së këtij vendi që prej 1939 është një nga spektaklet që e shijoj vitet e fundit. Nuk ka qenë traditë në familjen time të dëgjohej, por ishte alternativa më artistike që përmbante programmi i RTSH-së për vite e vite, ashtu sikurse edhe prindërit e mi ishin shikues tradicional të RTSH-së.

Im atë përsëriste shpesh këto vitet e demokracisë, se paguan për këtë televizion taksa, e minimalisht duhet ta shijojë. Mirëpo, vitet e fundit, sikur nuk e thotë më me krenarinë se po paguan taksa. Ftohja ka nisur që me Festivalin e Muzikës, që sipas tij nuk është më festivali i muzikës së lehtë, rrjedhimisht nuk është më festivali i tij, madje për shumë kohë nuk është më as televizioni i tij. E pyeta se si e kaloi ndërrimin e viteve, ndonëse e dija përgjigjen. Me mamanë në krah, me dolli dhe me RTSH-në. Kish pritur xhiron humoristike, se vetëm për Vitin e Ri i mblidhnin aktorët e gjithë Estradave në rrethe për popullin që paguante. Këtë vit edhe programi i estradave i ngjasonte festivalit sipas tij. Tekstet linin për të dëshiruar, sado aktorët ishin po ata, të mirët që ai kish duartrokitur prej vitesh. Entuziasmi i shuar më kujtoi fjalinë: "Tekstet këngësh janë këto, mor bab"? Këtë e kisha përjetuar edhe në rrjetet sociale këtë edicion të festivalit të këngës në RTSH, ndonëse nata e dytë e festivalit për mua ishte një nga spektaklet më të bukura që kisha shijuar vitet e fundit. Për shkak ndoshta edhe të përuljes që duhet herë pas here t'i bëjmë muzikës që i tejkon vitet dhe vijon ende të mbetet e bukur njëlloj si ditën e parë të jehonës së saj.

Megjithatë e shtyrë nga ky entuzisëm i shuar vit pas viti për taksat që pagueshin me krenari nga im atë, por këtu duhet thënë edhe nga shumë kryefamiljarë të tjerë, e shtyrë po ashtu edhe nga debati për tekstet e këngëve, sidomos për atë që do të dërgojmë në Eurovizion, mendova të shkruaj diçka për ato dy ditë të para të vitit, për "kazanin mediatik" në të cilën më kishte futur edhe kryeministri Rama publikisht, pasdiskutim edhe për kritikën e tim eti, që gjente vend edhe në shumë rrjete sociale nga miqtë e mi që kërkonin më shumë nga media. Një prej atyre që





# ÇFARË GATUAN, DO HASH!

Bisedë me Bujar Almanin, autorin e "Delegacionit", filmit që solli trofe nga Varshava dhe përfaqësuesin e Shqipërisë në OSCAR. "Virgjëresha shqiptare" është produksioni i fundit nga ku Alimani pret duartokitjet.

"Kam ndjekur aq sa më është dhënë mundësia e kohës programet e televizioneve më të njohura shqiptare, kryesisht ditët e festave te fundvitit. Një ritual normal ky për të gjithë emigrantët në përgjithësi. Por gjithnjë i zhgënjyer nga cilësia e programacioneve. Sikur të shtypësh butonin e ndërrimit të kanaleve sërisht të duket sikur je në të njëjtin program thjesht e ke shtyrë atë përpara ose pas me butonat e telekomandës". Kështu nisi bisedën një nga regjisorët më të përfolur këto vitet e fundit. Bujar Alimani, mendja e produksionit të fundit ku gjejmë portretin e jashtëzakonshëm të Xhevdet Ferit dhe sigurisht edhe filmit "Virgjëresha shqiptare" që këtë vit, nuk u kthye në vendin e gjuhës së vet, pa fituar çmime dhe shumë duartrokitje në festivalet e filmave të kategorisë së parë nëpër Europë.

Jeton prej disa vitesh në SHBA dhe ashtu sikurse për çdo shqiptar larg vendit, televizioni është dritarja që e afron në realitetin e prindërve, miqve apo të gjithë aty njerëzve të zemrës që ka lënë pas. Por, për një kineast, për një artist ku ekrani duhet të rrëfejë shumë, programi i fundvitit, njëkohësisht edhe ai i fillimvitit kthehet edhe në një lidhje profesionale ku mund të presësh apo jo art. "Të jem i sinqertë nuk është se pres shumë nga këto programe. Pasi cilësia e tyre duket gjatë gjithë vitit, janë të njëjtët njerëz që punojnë gjithë kohën aty, madje herë - herë kur ikin nga një kanal televiziv e shkojnë te tjetri thjesht bëjnë rrotacion vendi e jo idesh", më shkruan Bujar Alimani kur e pyes çfarë priti artististikisht nga programet e fundvitit.

> Me urimin që i shkrova Bujar Alimanit, shkoi edhe pyetja për emigrantët që ndjekin spektaklet tona me të njëjtin entuziasëm si im atë priste estradat e rretheve në RTSH. Shija e tij ishte po e njëjta, thënë me fjalë të tjera, por përafërsisht: "Ose s'kanë lekë, ose s'kanë mend".

dëgjoj e lexoj shpesh këto kohë më tha: "Ose s'kanë lekë, ose s'kanë mend". E pikërisht, kështu dua ta nis këtë shkrim, por pa e bërë tërësisht vetë. Mendova të merrja edhe mendimin e një prej kineastëve që vitet e fundit i kisha shtuar bisedat ndonëse jetonim shumë larg njëri-tjetrit. Me urimin që i shkrova Bujar Alimanit, shkoi edhe pyetja për emigrantët që ndjekin spektaklet tona me të njëjtin entuziasëm si im atë priste estradat e rretheve në RTSH. Shija e tij ishte po e njëjta, thënë me fjalë të tjera, por përafërsisht: "Ose s'kanë lekë, ose s'kanë mend".



# BUJAR ALIMANI: PO IMITOHET NË MËNYRË TË SHËMTUAR

Një sy t'i hedhësh programeve amerikane të televizioneve këtu ku jetoj, kupton menjëherë se thejshtësia merr kuptim tjetër. Ajo që të bie menjëherë në sy është pikërisht thjeshtësia dhe serioziteti i prezantuesve dhe të ftuarve, një gjë e cila në Shqipëri është shumë e vështirë për t'u konceptuar tashmë. Duket sikur prezantuesit bëjnë garë me njëri – tjetrin, kush të bjerë më shumë në sy e për pasojë të humbasë një lloj vetëndërgjegjësimi e vetëkontrolli; duke shkuar poshtë e më poshtë në kuptimin cilësor profesional. Kam dëgjuar madje për një emision ku kërkohet dress code e kjo më ka lënë me gojë hapur...

Kam frikë se kjo që ka ndodhur nuk riparohet më. Modelet që përcjell televizioni në Shqipëri po rrisin një brez, i cili për fat të keq po imiton vetveten në mënyrën më të shëmtuar. Pra, me pak fjalë edhe në këto ditë ndërrimi vitesh: "Asgjë e re nga Fronti i Lindjes..."





Më duket sikur thotë se "çfarë gatuan do hash", por duke qenë pjesë e kësaj bote mediatike, përpiqem t'i tregoj programet artistike. Mbase nuk ka pasur kohë t'i shohë të gjitha, ndonëse nuk ishte e vështirë se atë që shihje mbrëmjen e ndërrimit të viteve ta gjeje ritransmetim sërish, nga Klani në Klan Plus apo nga mbrëmja në një fashë tjetër orari. Pra mundësia që ai të më shkruante pa i parë këto programe ishte thuajse zero duke e njohur edhe përgjegjshmërinë e tij si artist, por unë e shtyrë nga bota ku punoj, u përpoqa t'i sillja ndër mend programin e Vizion Plus gjatë ndërrimit të viteve. Në programacionin e tyre mund të shijoje emrat më të duartrokitur të dhjetëvjeçarit të fundit, apo thënë ndryshe më të paguarit, e sidomos në ngjarjet e gëzueshme të familjeve shqiptare, këngëtarët më të paguar të dasmave e gëzimeve të tjera. "KËNGËZUAR", për shembull ishte një program i mirë për ata që e duan këtë lloj muzike.

"Pak emisione për kinematografinë, për pikturën, librin, koreografinë, muzikën e mirë. Edhe në rastet më të mira kjo bëhet në pak minuta, në krahasim me gjithë karnavalin tjetër zhurmësjellës të kanaleve kryesore televizive, përfshi politikën e kryesisht politikën", më shkruan ai duke më kujtuar se Vizion Plus mund të ishte një ndryshim i vogël mes Top Channel e Klan që kishin zgjedhur spektaklet e humorit, spektakle që duhet thënë frymëzohen shumë nga politika. Vizion Plus e kishte lënë teatrin e humorit për datën 1 Janar, por sërish shumë politikë. Politikë që në fakt më detyroi ta lëvizja kanalin më datë 31 dhjetor nga Top Channel. Këtë vit risia ishte te një teatër humori që përpiqej të bëhej përmes muzikës. Ishte humor muzikal, të paktën fillimi. Personazhet





# KLASIKËT TE KONCERTI I VJENËS U NDIKUAN NGA PANDEMIA

Mbahet prej Filarmonikës së Vienës që prej 1939 dhe padiskutim është një nga koncertet më të kërkuar në botë. Këtë vit, ai është transmetuar në 92 vende të botës, sigurisht edhe në Shqipëri. Më 1 janar të vitit 2022, në Wiener Musikverein, ky koncert i lakmuar nga të gjithë u shijua vetëm nga 1000 spektatorë. Ndonëse pa spektatorë, edhe vitin e shkuar, Viena nuk u dorëzua. Oguri i mirë i skenës për çdo vit të ri duhet të jehoë ashtu sikurse që nga viti 1939.

Maestro Daniel Barenboim, bashkëpunëtor i ngushtë muzikor me Filarmoninë e Vjenës që nga viti 1965, drejtoi këtë vit ngjarjen prestigjioze të koncertit për herë të tretë pas vitit 2009 dhe 2014. "Shpresoj që të frymëzojë disa nga politikanët në të gjithë botën që të mendojnë vërtet për rëndësinë e nevojës shpirtërore të muzikës për popullatën", u tha Barenboim gazetarëve dy ditë para ndërrimit të viteve dhe koncertetit të shumëpritur.

Programi i koncertit të Vienës ndahet në dy pjesë, dhe bazohet kryesisht në pjesë nga repertori muzikor i familjes Strauss (Johann Strauss babai, Johann Strauss JR, Josef Strauss dhe Eduard Strauss), të ekzekutuara nga *Wiener Philharmoniker*. Tradicionalisht, koncerti mbyllet me ekzekutimin e tre pjesëve. E para është një polka e shpejtë, e dyta është *An der schönen blauen Donau* (Mbi të bukurin Danub blu) e Johann Strauss JR dhe e treta është *Radetzky-Marsch* e Johann Strauss. Gjatë ekzekutimit të kësaj të fundit është traditë e konsoliduar që publiku i pranishëm në sallë të duartrokasë duke ndjekur ritmin e udhëzuar nga dirigjenti dhe ritmi i orkestrës.

Koncerti i vitit të kaluar, i drejtuar nga Riccardo Muti, pa polka dhe valse, u zhvillua në një sallë të zbrazët për shkak të pandemisë, por këtë vit numri i të pranishmëve u kufizua në 1 000 dhe ndonëse një format i vjetër festimi, Koncerti i Vienës mbetet një nga transmetimet më të bukura edhe në Shqipëri.

kryesore ishin Rama, Basha e Berisha, që sikur të mos mjaftonin çdo ditë me pushtimin e tyre të kohës televizive ngado, ishin edhe personazhet përzgjedhëse të hapjes së natës së ndërrimit të viteve. Bujar Alimani kishte të drejtë. Kishte shumë politikë edhe në një teatër humori. Dhe babai im kishte po të drejtë. Tekstet ishin po aq keq. Sidomos në muzikë, e më tepër në teatrin muzikor që më ofronte televizioni kombëtar Top Channel, që me siguri më datën 1 janar me 6 orë transmetim live të Reality show Big Brother Vip ofronte edhe bakllavanë e vitit.



# SEVDAJA e ALI PASHËS PËR VASILIQINË

Nga **DORIAN KOÇI**

Ngjarjet e Pashallëkut të Janinës edhe 90 vjet pas vrasjes së Ali Pashë Tepelenës vazhdonin ende të kishin jehonë në shoqërinë shqiptare të kohës. Eqerem Vlora në librin e vet "Ditar nga Berati në Tomorr dhe kthim" botuar në Konstandinopojë në 1910 mes këngëve popullore të mbledhura në Berat sjell edhe këngën popullore "Sevdaja e Ali Pashës për Vasiliqinë". Eqerem Vlora e ka përfshirë këngën e mbledhur në kapitullin e titulluar "Nga thesari i këngëve toske"/ Këngë dashurie. Ai shkruan se kjo këngë është një këngë e vjetër e kënduar shpesh në gjithë Shqipërinë. I këndohet dashurisë së madhe të Ali Pashës Tepelenës për gruan e tij të dytë, Vasiliqinë e krishterë.

Kush ishte Vasiliqia që mori mendtë e Ali Pashait që në moshën 12 vjeçare; Zonja me Kështjellë e me Kishë që ka hapur shumë debat mes shqiptarëve u shuajt në moshën 45 vjeçare. Historia tregon që pas vdekjes së Ali Pashës, ajo nuk u martua kurrë edhe pse pati kërkesa të shumta. Përmendja e saj prej dekadash në folklorin shqiptar, me tone pozitive, dëshmon se mbi të nuk rëndonte një akuzë mbi tradhëtinë e saj ndaj Ali Pashës, por përkundrazi kujtohej si një bashkëshorte e denjë e Luanit të Janinës

*Un i mjeri ç'jam goditur*
*Prej syve të tu jam venitur*
*Hund e faqe, buzë e gush,*
*Ma bën zembrën zjarr e prush.*

*Në lesh tënd dua të varem*
*Dhe na ty të mos ndahem*
*Se na grat këtu në jet,*
*Më e mira je ti vet.*

*Si thëllënza kur këndon*
*O! Sa fort që më gëzon*
*Të keqen moj fytyr lar*
*Që më ndritë po si ar.*

*Ali pasha tha k'to fjal,*
*Përtëritur porsi djal,*
*Rra në gji të Vasiliqis.*
*Në mes zjarrit dashuris,*
*Mendja iku mori rrug*
*Si një zog që kërkon drug.*

Vargjet e mbledhura nga Eqerem Vlora i këndojnë pasionit të Ali Pashë Tepelenës për dashurinë e pazakontë midis tij dhe vajzës rreth 45 vite më të re në moshë, Vasiliqisë.

**KUSH ISHTE VASILIQIA?**

Vasiliqi Kondakçi lindi në fshatin Plesovicë të Epirit në 1789.Fshati Plesovicë është ndërtuar në një lartësi prej 280 dhe 360 metrash. Ai gjendet në në skajin veri-perëndimor të krahinës së Çamërisë afër kufirit të sotëm me Shqipërinë. Fshati Plesovicë është një shembull karakteristik i një vendbanimi tradicional në këtë pjesë të veçantë të krahinës malore të Epirit. Pranohet gjerësisht që vendbanimi bashkëkohor ndodhet sipër rrënojave të një kështjelle të epokës bizantine, dhe ndoshta një fortifikimi të më vonshëm romak. Emri i fshatit i mëparshëm ishte Plisivitsa, dhe u kthye në Paravrisos në 1928 për vetëm një vit, e për t'u ndryshuar në Plesio, emërtim që vazhdon deri në ditët e sotme. Monumentet lokale përfshijnë kështjellën e Kasneciou, në majë të një kodre në formë konike si dhe xhaminë e Kocikas, e cila nuk përdoret më. Sipas konsullit francez Francois Pouqeuville, në Janinë në moshën dymbëdhjetë vjeçare, Vasiliqia tërhoqi vëmendjen e Ali Pashë Tepelenës pas një operacioni ushtarak të ndërmarrë nga Veziri për të shkatërruar një punishte të fallsifikimit të parave në Epir. Pas faljes të së atit, Pashai u martua me Vasiliqinë në 1808 dhe ajo iu bashkua haremit të tij. Ajo u lejua të praktikonte besimin e saj të krishterë brenda sarajeve të Pashait dhe dalëngadalë që nga viti 1812 filloi të kishte një influencë në oborrin e Janinës. Në 1818 besohet se ajo u bë anëtare e organizatës patriotike Greke "Filiki Eteria" e cila nuk kishte një karakter etnik grek, por shërbente si organizatë ombrellë për gjithë elementët e krishterë dhe antiosmanë.

E dua këtë vend, sepse dua familjen time, dua farefisin, qytetin e lindjes, dua vendet ku kam shkelur. Tani m'u dha mundësia pas '90'–ës të bredh nëpër kontinente. Nuk i kam parë të gjitha, por kam parë diçka nga bota dhe jeta. Dhe vendi ku dua të jetoj, është këtu

Vasiliqia besohet se u rekrutua drejtpërdrejt nga një prej tre themeluesve të organizatës, Nikolaos Skufas. Gjatë kësaj periudhe ajo ndërmori një numër nismash bamirësie dhe në 1819-1820 financoi një numër restaurimesh në manastiret e Malit Athos. Në janar 1822, gjatë fazës së fundit të rrethimit të Janinës nga forcat e sulltanit osman, Vasiliqia së bashku me Ali Pashën dhe besnikët e tij u vendosën në ishullin e Shën Pandalejmonit të Janinës.

Për herë të parë në historiografinë shqiptare për këtë ngjarje dhe rolin e Vasiliqisë në çastet e fundit të jetës së Ali Pashë Tepelenës është shkruar nga Mehdi Frashëri në artikullin e vet "Një studim kritik mbi vrasjen e Ali Pasha Tepelenës" që shoqëron librin e Robert Ëalsh "Koka e Ali Pashë Tepelenës dhe rrethanat e vrasjes" botuar në Tiranë në 1934. Përveç konsideratave të Mehdi Frashërit rreth veprimtarisë së Ali Pashë Tepelenës në libër përfshihet raporti i Robert Ëalsh, Kapelan i Ambasadës së Anglisë në Stamboll "Koka e Ali Pashë Tepelenës dhe rrethanat e vrasjes së tij" ku shkruhet se shumë pashallarë në një shkallë inferiore ditë për ditë vinin dhe e vizitonin Ali Pashën. Në shkurt, qeveritari i Moresë, Muhamet Pashai, erdhi për t'a përshendetur. Në mes tyre rrodhi një bisedim i fshehtë dhe një miqësi e përshkëmbyer u duk se ishte vendosur mes tyre. Muhamet Pasha i tha Ali Pashës që t'ia bënte të ditur se ç'pëlqente për të ngrënë, me qëllim që t'ia gjente dhe t'ia sillte. Plaku Ali Pasha, pasi bëri fjalë për ritet fetare, kërkoi një lloj vere, e cila iu premtua menjëherë. Pas disa fjalëve miqësore, Pashai i Moresë u ngrit për të marrë leje nga Ali Pasha dhe shkëmbyen me njëri-tjetrin fjalë miqësie. Me qenë se ishin të dy të një rangu, u ngritën në këmbë të dy menjëherë. Pashai i Moresë, duke u tërhequr, i bëri një përshëndetje ceremoniale, i përkulur shumë. Pashai i Janinës ia ktheu këtë përshendetje, duke u përkulur po aq. Po, para se të ngrihej, Muhamet Pashai hoqi shpatën dhe ia futi Ali pashës në trup me aq forcë sa që



Gjatë qëndrimit në Stamboll Vasiliqia pati kërkesa nga pashallarë, apo dhe princër të tjerë rusë për t'u martuar por ajo i refuzoi të gjithë duke qëndruar vejushë.

e depërtoi tej për tej dhe i shpoi zemrën. Aliu ra i vdekur në këmbët e tij... Walsh përmend në raport edhe dashurinë e veçantë të Ali Pashës për Vasiliqinë si dhe ndikimin e saj mbi vendimet politike të tij. Ai shkruan se..."Burri i saj e donte për vdekje. U përhap lajmi se kishte tradhëtuar të shoqin dhe si, shpërblim për këtë tradhëti, do të merrte tre çifligje. Është provuar se Vasiliqia përdori të gjitha mjetet për ta bindur Ali pashën të mos vërë në zbatim projektin e dëshiruar, të cilin kish formuar, për të hedhur në erë bashkë me Vasiliqinë dhe me thesarët. Gjithashtu dihet se ajo i përkrahu bisedimet që pati Aliu me Hurshit Pashën. Por nuk duket që dyshimet për të cilat u bë fjalë, qenë të bazuara. Nuk ka asnjë të dhënë mbi tre çifligjet e supozuara që i ishin dhuruar nga pushteti perandorak si shpërblim për tradhëtinë e supozuar të saj ndaj Ali Pashë Tepelenës".

**FATI I VASILIQISË PAS VRASJES SË ALI PASHË TEPELENËS**

Pas vdekjes së Ali Pashë Tepelenës, Vasiliqia u dërgua si e burgosur në kryeqytetin osman, Stamboll. Aty ajo u shoqërua nga besniku i Ali Pashë Tepelenës, Thanas Vaja. Gjatë qendrimit në Stamboll Vasiliqia pati kërkesa nga pashallarë, apo dhe princër të tjerë rusë për t'u martuar por ajo i refuzoi të gjithë duke qendruar vejushë. Vasiliqia qëndroi në Stamboll deri në vitin 1827 dhe pas betejës së Navarrinos ku flota osmane humbi përballë koalicionit anglo-franko-rus, u dërgua në internim sëbashku me Thanas Vajën në Brusa. Me ndërhyrjen e drejtë për së drejtë të Patriarkut të Patriakanës Ortodokse të



Stambollit u fal pak më vonë nga Sulltani dhe u kthye në Greqi, kur kjo e fundit ndërkohë fitoi pavarësinë e saj nga Perandoria Otomane. Në vitin 1831, shteti Grek i ofroi Vasiliqisë një kullë mesjetare në Katohi, ku ajo jetoi pjesën tjetër të jetës. Kulla gjendet edhe sot dhe quhet edhe “Kulla e Zonjës”. Në të njëjtin fshat ndodhej dhe Jani Kondakçiu, vëllai i saj dhe kjo ishte një nga arsyet që Vasiliqia u vendos në krahinën e Etolo Akarnisë. Ajo vdiq nga dizenteria në vitin 1834, në moshën 45 vjeçare. Në të njëjtin fshat ndodhet varri i saj dhe një bust në oborrin e kishës së Shën Nikoloaut që ishte dhe patroni mbrojtës i Plesavicës. Kishës së Kryengjëjve në Etoli ku është varrosur i bëri dhuratë një kambanë të derdhur në argjend ku shkruhej “Rroftë Mbreti Oton, Mbreti i Greqisë, 1834, Vasiliqi Kiçu”. Kambana mesa duket u dhurua nga Vasiliqia dhe vëllai i saj Jani në shenjë falenderimi ndaj mbretit të Greqisë, bavarezit Oton që u dhuroi atyre një pronë në Etoli. Më 1895, çanta prej kadifeje e qëndisur me ar, e cila i përkiste Vasiliqisë, u ble nga Nikolaos Konstantinidis për 25 dhrahmi.

**KUJT KOMBËSIE I PËRKISTE VASILIQIA?**

Vasiliqia në literaturën e shkruar rreth Ali Pashë Tepelenës është përcaktuar se i përkiste kombësisë greke duke u nisur kryesisht prej faktit se i përkiste besimit ortodoks dhe se një vëlla i saj u përfshi në Revolucionin grek. Pavarësisht këtyre fakteve është e vështirë të operosh mbi përcaktimin e kombësisë në Ballkanin e fillimit të shekullit të XIX bazuar mbi kritere të qarta etnike përsa i përket popullsisë ortodokse në Epir përderisa në Perandorinë Otomane popullsia ndahej sipas sistemit të mileteve dhe kritereve fetare. Në Perandorinë Osmane siç vëren historiani austriak Shmid në vitet para fillimit të përqafimit të nacionalizmit si ideologji shtetformuese në Ballkan, ishte feja dhe jo gjuha që përcaktonte vendin dhe të vetëkuptuarit e njerëzve. Dallimet gjuhësore pa dyshim që ndiheshin, por të qenët sëbashku në një bashkësi fetare, i kapërcente kufijtë gjuhësorë dhe lidhte me njëri-tjetrin besimtarët e ndryshëm. Këtë tipar të identitetit fetar në epokën para fillimit të ndërtimit të shteteve kombëtare do ta shfrytëzonte Megali Idea dhe politika agresive e shtetit kombëtar grek ndaj elementit ortodoks shqiptar duke deformuar shpesh herë të dhënat etnike në terren. Revolucioni Grek dhe lufta për pavarësi 1821-1832 do të shërbenin edhe si lakmues identitar për popullsitë e Epirit, ku suliotët e mes tyre familja e Vasiliqisë do të përqafonin identitetin kulturor helen. Për më tepër të vonuar do të ishin në këtë drejtim dhe klasa drejtuese e ajanëve myslimanë shqiptarë ku bënte pjesë dhe Ali Pashë Tepelena që shpesh herë në aksionet e tyre politike do të ishin transmetues solidaritetit të ummas islamike në territoret shqiptare duke krijuar konflikte të panevojshme me bashkësitë



BIBLIOGRAFI:

1- **Ark. Rest. Gentian Stratobërdha**. Restaurimi në proces i kishës së shën Nikollës në Porto Palermo, Himarë.

2- **Charitōn Monachos (1997)**. Maties ston Atho. p. 299. A more recent benefactor was the Christian wife of Ali Pasha, Vassiliki, who largely financed the restoration of the monastery in 1819–1820.

3- **Eqerem Bej Vlora.** “Ditar nga Berati në Tomorr dhe kthim”, Ditar. Tiranë: Koçi, 2003.

4- **Ibrahim Manzur Efendiu**. Kujtime për Ali Pashën, Globus R, Tiranë, 2004.

5- **Maria Lada-Minōtou**, I. K. Mazarakēs Ainian, Diana Gangadē, Greek costumes: collection of the National Historical Museum, Historical and Ethnological Society of Greece, 1993.

6- **Muhabat S.Kutukoglu**.Osmanli Belegerenin Dili, Instabul: Kubbealti Akademisi Kultur ve Sanat Vakfi, 1994, f.93 cituar në Nezim Berati. Divani Shqip. Edicioni tektual kritik Gencian Abazi-Egro, Botimet Toena, Tiranë, 2009.

7- **Oliver Jens Shmid**. Shqiptarët. Një histori midis Lindjes e Perëndimit. K&B, Tiranë:2012.







ortodokse shqiptare si Suli dhe Himara. Ndodhte shpesh që simbole të rëndësishëm kulturorë dhe administrativë të mos përcaktonin qartë etninë dhe besimin fetar të njerëzve që u përkisnin siç është për shembull vula personale e Vasiliqisë, të cilën ajo e mbajti deri në fund të jetës. Në të është shkruar në gjuhën osmane emri i saj Vasiliqi e rrethuar nga të dyja anët nga dy palma, simbole të qetësisë dhe mikpritjes në Islam. Sipër emrit të saj është një yll gjashtëkëndësh, heksagram që i përket sërish besimit islamik, simbol që gjendet në artin dekorativ islamik në xhami dhe teqe. Mbajtja e kësaj vule, sigurisht me aprovimin e Ali Pashë Tepelenës dëshmon për statusin e lartë të saj në oborrin e Janinës dhe mbi kufijtë jo shumë të qartë të përkatësisë fetare të lidhur ngushtë me gjuhët dhe kulturat që u definuan disa vite më vonë pas shpërthimit të Revolucionit Grek. Në Perandorinë Osmane përdorimi i vulave personale nga njerëzit e thjeshtë ka qenë një dukuri shumë e përhapur. Këto vula ishin në një madhësi më të vogël se vulat që përdoreshin në korrospodencat zyrtare. Përdorimi i tyre pranë emrit, në vend të firmës, konsiderohej si një fakt që provonte vërtetësinë e dokumentit. Ka gjasa që vula e Vasiliqisë të ishte një lloj vule e tillë.

### ZONJA ME KËSHTJELLË DHE KISHË

Ali Pashë Tepelena i kushtoi Vasiliqisë një kështjellë. Kështjella e vogël është e vendosur në një pozicion mjaft të bukur në një gadishull në gjirin e vogël tektonik të Porto Palermos (në antikitet e njohur si gjiri i Panormës). Për të respektuar besimin e saj fetar në hyrje të saj ndërtoi dhe një kishë që ka të ngjarë të ishte dhe patroni mbrojtës i vendlindjes së Vasiliqisë. Kisha e Shën Nikollës është i vetmi element që ka mbetur nga manastiri dikur i ndritshëm i Shën Nikollës së Panormës (sot gjiri emërtohet i Palermos). Egzistenca e kësaj kishe, dëshmohet nga burime të shkruara dhe gjetje të tjera. Bëhet fjalë edhe për përshkrimet tejet argumentuese që na japin udhëtarë dhe historianë të huaj që kanë kaluar në atë zonë. Konsulli francez Francois Pouqeuville, i atashuar në oborrin e Ali Pashës rreth vitit 1811 vizitoi trevën e Himarës dhe mbajti shënime, të cilat i botoi më vonë në Paris më 1820. Pouqeuville na jep një përshkrim të përsosur të peizazhit të gjirit të Panormës, të kështjellës dhe të rripit të ngushtë të tokës që e lidh atë me sterenë, pikërisht atje ku ndodhet kisha e Shën Nikollës dhe disa kasolle, që janë mbetje nga godina të tjera të manastirit të vogël që ishte atje. Duhet theksuar se rreth vitit 1798 Ali Pasha e mori trevën e Himarës dhe në vitin 1806 ndërtoi kështjellën. Në këtë kështjellë qëndroi Poukevili. Pra, më 1811 kisha e hirshme e Shën Nikollës me disa kasolle përreth ishte atje. Ky fakt hedh dritë mbi tolerancën fetare në Pashallëkun e Janinës, tolerancë që shërbeu disa dhjetëvjeçarë më vonë në ngjizjen e identitetit kombëtar shqiptar.

### IMAZHI I VASILIQISË NË LETËRSI DHE FOLKLOR

Vasiliqia është përshkruar nga artistë të ndryshëm. Përmendet shkurtimisht në disa romane të shekullit XIX si tek "Konti i Monte Kristos" të Aleksandër Dumas në kreun 77 dhe nga autori anglez Richard A. Davenport në librin e tij "Jeta e Ali Pashë Tepelenës, Veziri i Epirit". Së fundmi portreti i saj është risjellë sërish në poezinë shqipe mjeshtërisht nga Petrit Ruka në poemën e tij "Vërvitu Kokë e prerë" (1999) ku Vasiliqia ka imazhin e një gruaje të pafajshme e besnike ndaj Ali Pashë Tepelenës, ashtu si në folklorin shqiptar. Përmendja e saj dhe shumë dekada më vonë me tone pozitive në folklorin shqiptar dëshmon se mbi të nuk rëndonte një akuzë mbi tradhëtinë e saj ndaj Ali Pashës, por përkundrazi kujtohej si një bashkëshorte e denjë e Luanit të Janinës.


TOPTANI
SHOPPING CENTER
NJË FILLIM
PLOT STIL
DERI NË
50%
ULJE
www.toptani.com.al



ZGJEDHJET NË FSHF

# MOND DUKA & SHAKOHOXHA

# DASHURIA
## QË U SHNDËRRUA NË
# URREJTJE

"Ishte një mësues i arteve marciale dhe kishte një nxënës që e donte fort dhe e mësonte. Me kalimin e kohës, nxënësit i hipi vetja në qejf dhe e sfidoi. U vendos data kur do bëhej mundja në qendër të qytetit. Pati shumë njerëz. Djali ishte i ri dhe mësuesi me vitet e duhura mbi supe. Gara dukej të ishte e fortë, por... Djali dukej se do të fitonte, por në momentin e fundit, mësuesi përdori një teknikë dhe e la në tokë. Djali s'e priste sepse nuk e kishte parë asnjëherë këtë teknikë. Dhe mësuesi i tha: "Kjo është teknika ime. E kam krijuar vetë kur isha në moshën tënde. Nuk fiton forca. Fiton mendja dhe eksperienca. Merre dhe këtë mësim të fundit nga unë". Kjo është historia klasike se si "nxënësi" përpiqet të zërë vendin e profesorit. Një jetë i frymëzuar nga Armand Duka, Dritan Shakohoxha tashmë synon poltronin e drejtuesit të institucionit të futbollit shqiptar. Një dishepull që tradhëton profetin ka gjithmonë një fund me pendesë.

#### SHAKOHOXHA, PRESIDENTI DUKA E FUTI NË BOTËN E SPORTIT

Kishte mbërritur me sforco deri në atë stad të jetës dhe fati e donte që në rrugëtimin e tij, djali ambicioz të njihej me biznesmenin e suksesshëm. Ishte pikërisht ai, Armand Duka që askush s'e njihte fillimisht për pasionin e tij të madh për futbollin. Por, më vonë do të zgjidhej në




GENT SHKULLAKU

krye të Federatës Shqiptare të Futbollit. Me njohjet e veta e përkrahu Shakon t'i përkushtohej gazetarisë sportive. Talentin e kishte në të folur. Megjithatë me këmbënguljen e presidentit, arriti të futej në linjën e sportit shqiptar. Asesi, Duka s'e kishte menduar që nëse do t'i jepte "krahun", një ditë do të tentonte t'ia merrte. Jeta e kishte sprovuar shumë herë, por asesi s'e kishte menduar se një ditë personi për të cilin kishte investuar më shumë se kushdo tjetër, t'i dilte kundër.

"Kur të largohesh ti, do ma lësh mua postin e presidentit të Federatës Shqiptare të Futbollit", kjo kishte qenë kërkesa e hershme e Shakos ndaj Dukës, tregojnë njerëz të afërt pranë kreut aktual të FSHF-së. Fillimisht dukej si një batutë e komentatorit sportiv ndaj presidentit. E në fakt askush, 5 vite më parë, s'e kishte çuar në mendje se Shakohoxha do të provonte t'i dilte kundër atij që kontribuoi duke i dhënë mbështetjen maksimale në rrugëtimin e tij. Jo më kot thonë se asgjë nuk e lodh më shumë njeriun se sa të jetë mirënjohës gjatë gjithë jetës së tij. I madhi Gëte ka thënë: "Mosmirënjohja është gjithmonë një shenjë dobësie. Nuk kam parë kurrë që njerëzit mendjendritur të jenë mirënjohës". Megjithatë ky virtyt duket se është monedha e zakonshme me të cilët njerëzit paguajnë...

**MIQËSIA, DUKA - SHAKOHOXHA**

Aty një gotë verë, aty shopping, një çantë në dorë. Atmosferë miqësore, shikime admiruese. Gjuha e trupit dhe gjestikulacionet që tregonin qartësisht afrimitetin dhe rehatinë e prezencës së njëri-tjetrit. Ishte një marrëdhënie që e kishin zili të gjithë. Kilogramët ishin më të pakta, por miqësia në doza shumë të larta. Dukej si ato martesat që partnerët i premtojnë besnikëri njëri-tjetrit deri në vdekje. Fundja Duka e kishte rritur me duart e veta. Në gëzimet e veçanta nuk mungonte as bashkëshortja e presidentit Duka, Suela, si për të treguar miqësinë mes tyre, por edhe bashkëshortja e Shakohoxhës. Po sot? Thua a buzëqesh Shako me të njëjtin admirim kur dëgjon për atë që e rriti dhe integroi në shoqërinë shqiptare, Dukën? A ka më gotë dhe shopping së bashku? Saktësisht 4 vite më parë, ishin në një sallë. Shako dukej si ato ultrasit e stadiumeve që bëjnë tifo për ekipin e tyre të zemrës, i njëjtë ishte dhe ai në hotel "Adriatik" në Durrës. Asambleja numëroi votat dhe nxorri fitues presidentin aktual, Dukën. Miku i tij u ngrit në këmbë duke mos u përmbajtur nga gëzimi: "Ja pra si fitohet", duke u kthyer nga i ndjeri Bashkim Fino që rivalizonte asokohe Armandon. Edhe për 4 vite, Duka do të ishte në krye të FSHF-së. Gjithçka shkonte mrekullueshëm mirë mes tyre. As në ëndrrat e tij më të këqija, Shako s'mund ta kishte parë si kundërshtar Armand Dukën, edhe pse dikur e kishte hedhur një "shashkë" për postin e FSHF-së. Por, sot në vitin 2022 kjo shashkë plasi. Paradoks i madh, por Shako rivalizon mikun e tij të hershëm, Dukën për postin më të rëndësishëm në Federatën Shqiptare të Futbollit! 5 vite më parë të gjithë do të qeshnin dhe askush nuk do ta besonte. Dy miq të mirë, më saktë shefi që mbarte kudo me vete një nga "bijtë" e rritur me duart e tij në vitet e vështira të Shqipërisë demokratike. Janë kthyer edhe në rivalë, më saktë nxënësi po tenton të luftojë profesorin, njeriun që e futi në rrugën e jetës. "Lufta" po promovohet si e ashpër, edhe pse është vetëm fillimi. Miku më i madh që kishte Dritan Shakohoxha në botën e futbollit ishte Armando Duka. Dhe komentatori më i madh mik që ka pasur Armand Duka ishte Shakohoxha. "Do të kem përballë një komentator", shprehej presidenti Duka ironikisht kur u pyet në një intervistë televizive. Njohës i mirë i futbollit në vend, kreu aktual e di mirë se si veprohet në raste të tilla. Edhe pse Shako po mundohet të qëndrojë në majë të gishtave, në fund do të jetë po njësoj i gjatë. Thashethemet kanë qenë të mëdha për krisjen e marrëdhënies së tyre.

**PËRPLASJA, PRAPASKENAT E KRISJES DUKA-SHAKOHOXHA**

Duka - Shako, ndoshta gjithëkujt i vjen pak për të qeshur kur i sheh përballë njëri-tjetrit. Askush nuk do ta kishte çuar ndërmend që miku më i madh i presidentit të dalë publikisht kundër tij, madje ta rivalizojë për postin që ai mban aktualisht. Ftohja mes tyre ka nisur kohë më parë. Data shënonte 17 korrik. Ishte pisku i vapës së vitit 2017. Në krye të Kombëtares emërohet një emër i njohur i futbollit europian, Christian Panuçi. Kishte lënë gjurmë kudo kishte luajtur, megjithatë për Shakohoxhën nuk ishte i duhuri. E tha, e trumbetoi me të madhe, përdori dhe biznesin e presidentit Duka për të sponsorizuar largimin e italianit. Edhe pse e dinte



GENT SHKULLAKU

NEWS BOMB .al
SPORT

mirë se zgjedhja e italianit ishte bërë ekskluzivisht nga vetë presidenti Armand Duka, sërish nuk u ndal. Kulmi shënoi në 4 qershorin e vitit 2018-të. Si i vjetër në zanat tanimë, Shakohoxha që vijonte të mbante postin e drejtorit të Supersport urdhëron gazetarët e tij që t'ia bëjnë intervistën Panuçit përballë tifozëve kuqezi. Atë ditë, Shqipëria u mposht në miqësore 4-1 nga Ukraina. Një tifoz gjithmonë ka të drejtë dhe atë ditë koret kundër Panuçit ishin të shumta. Një "kurth" për të injoruar trajnerin italian. Ky i fundit irritohet dhe me të drejtë lë përgjysmë intervistën dhe largohet.

**FUNDI I MIQËSISË**

Nëse një ditë do të largohej nga komentimi, ashtu siç gjithë shqiptarët e njohin, Shakohoxha do ta bënte vetëm nëse do ta vendoste Armand Duka. Në fakt presidenti nuk mund ta përtypte faktin se ai që rriti me duart e tij, do të tregohej i vogël përballë zgjedhjeve të tij. E futi në shtëpi, i dha hapësirë, e drejtoi në rrugën e duhur, por ai ia "shpërbleu" duke tentuar t'i merrte kalanë nga brenda. Diçka që nuk mund të ndodhte kurrësesi me Dukën, presidentin e sprovuar me jetën dhe në simbiozë me suksesin. "Panuçi, je i ikur", me siguri këto fjalë vijojnë të mbahen mend edhe sot nga gjithë sportdashësit shqiptarë. E pakonceptueshme se si dikush që i dhe gjithë besimin tënd, të të kthehet kundër përmes pronës tënde, që ke investuar për vite me radhë. Duka nuk kishte ndërmend të humbte kohë, edhe pse ndjenja e krijuar ishte më shumë se zhgënjyese. E shkarkoi nga posti i drejtorit në Supersport dhe i la të bënte atë që dinte më mirë, komentimin e ndeshjeve. Edhe pse përdori çdo mënyrë, edhe pse doli kundër, sërish presidenti nuk e largoi përfundimisht. Pavarësisht gjithçkaje e la sërish pjesë të stafit, në biznesin që e njohu Shakohoxhën anembanë botës, kudo që flitej shqip. Për miqësi nuk mund të flitej më, njeriu të cilin e mori me vete në çdo vend që shkeli, i'u kthye kundër. Shpesh njerëzit bëhen të vegjël duke u përçapur të bëhen të mëdhenj.

Miq të të dy personazheve besojnë se edhe gjetja e një preteksti si Panucci për prishjen përfundimtare nuk qe e rastësishme. Shako donte të dilte te ëndrra e kahershme për të drejtuar FSHF-në.

**ZGJEDHJET, "NXËNËSI" PËRBALLË "PROFESORIT"**

Në 12 korrik të vitit të shkuar, Dritan Shakohoxha bën zyrtare atë që ishte aluduar prej disa muajsh: "Po, do të kandidoj për president të FSHF-së dhe do të fitoj", deklaronte duke treguar publikisht në këtë mënyrë se mes tyre nuk kishte më miqësi. Zgjodhi të hiqtë dorë nga komentimi, profesion që e kishte ushtruar prej shumë vitesh. Megjithatë do të tentojë të qëndrojë sërish pranë futbollit duke kandiduar në një post të lartë siç është kreu i FSHF-së. Njerëzit në përgjithësi kalojnë më shumë kohë duke folur keq për armiqtë se sa duke folur mirë për miqtë. Ndoshta Shako tanimë s'ka kohë të kujtojë atë që presidenti ka bërë për të, fundja duke i dhënë emrin që tanimë ka sot. Vitet mbi supe i krijojnë qetësi Dukës dhe me pak fjalë tregon shumë. "Do të kem përballë një komentator", u shpreh në një nga emisionet televizive. Kaq mjafton për presidentin që të përshkruajë me pak fjalë nxënësin e vet. Ndonjëherë njerëzit mendojnë se do të bëjnë gjëra të mëdha. Por, në fakt nuk bëjnë asgjë. Jeta përbëhet nga gjëra të vogla. Madhështia e njeriut është të jesh i madh në gjëra të vogla! Foto e shkurtit të vitit 2018-të ilustron më së miri një kornizë moderne të "Dorës së Judës" ngritur kundrejt profesorit.



**ZGJEDHJA E KRYETARËVE TË SHOQATAVE RAJONALE**

Aktualisht Armand Duka dhe Dritan Shakohoxha janë dy kandidatët që do të rivalizojnë për postin e presidentit të Federatës Shqiptare të Futbollit. Por, për të shkuar deri në ditën e verdiktit përfundimtar, fillimisht përzgjidhen kryetarët e Shoqatave Rajonale me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ZGJEDHJET PËR KREUN E FSHF-së**

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë legjislativ i Federatës Shqiptare të Futbollit. Në bazë të statutit të miratuar nga anëtarët, asambleja thirret për zhvillimin e punimeve, një herë në vit. Në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Federatës Shqiptare të Futbollit. Një herë në katër vjet, siç e përcakton edhe Statuti i Federatës Shqiptare të Futbollit, zhvillohet Asambleja Zgjedhore e FSHF-së, e cila zgjedh Presidentin e FSHF-së, 10 anëtarët e Komitetit Ekzekutiv si edhe Anëtarët e Komisionit Verifikues (këta, një herë në dy vjet). Me vendim te Komitetit Ekzekutiv cakohet çdo vit data, ora dhe vendi për mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të FSHF-së. Sipas rregullit, zgjedhjet për presidentin e ri të FSHF-së do të bëhen brenda 6-mujorit të parë të vitit 2022. Ende nuk është mbledhur Asambleja e Përgjithshme për të caktuar datën, orën dhe vendin ku do të bëhen zgjedhjet e radhës për kreun e ardhshëm të FSHF-së.

**ZGJEDHËSIT, 55 ANËTARËT ME TË DREJTË VOTE**

Zgjedhësit për presidentin e ri të FSHF-së janë të gjithë pjesë e futbollit. Aktualisht, Asambleja e Përgjithshme ka 55 anëtarë me të drejtë vote. Gjysma e tyre janë klube profesioniste nga Superiorja dhe Kategoria e Parë, saktësisht 10 në elitë dhe 16 në të Parën, me parimin një anëtar, një votë. 26 të tjerë janë të mandatuar nga Shoqata Rajonale që përfaqësojnë mijëra njerëz që luajnë futboll dhe përfaqësohen nga trajnerë, janë të gjithë nga futbolli. Ndërsa 3 anëtarët e mbetur janë nga shoqata e mjekëve, trajnerëve dhe arbitrave. Askush me staturë politike nuk mund të votojë dhe mandatimi bëhet nga organika e klubit.



WWW.ALBSIGINVEST.AL

ALBSIG PENSION



100%
Transparencë

Anëtarët pajisen me një përdorues dhe fjalëkalim, të cilin mund ta përdorin për të monitoruar online në çdo kohë llogarinë e tyre personale.

1,000
Vlera minimale lekë

Vlera minimale me të cilën mund të filloni investimin tuaj në Fondin e Pensionit ALBSIG është 1,000 lekë.

0%
Tarifë Hyrje/Dalje

Hyrja dhe dalja nga Fondi i Pensionit ALBSIG është FALAS.

MË SKANO

ALBSIG INVEST

# FUTBOLL TEATËR DHE LUFTË GJERMANO-SHQIPTARE

Shqiptarët dhe gjermanët jo vetëm kanë luftuar me njëri tjetrin, por kanë luajtur edhe futboll, tenis e ndeshje boksi! Kur guerilasit shpërndanin trakte në 1944, gazeta gjermane "Die Lage" i kushtonte një artikull të rëndësishëm ndeshjes mes skuadrës së Tiranës dhe përfaqësueses së trupave gjermane në Shqipëri. Ndërkohë gazetat pasqyrojnë aq bukur situatën kaotike të spektatorëve nëpër shfaqjet teatrale. Bashkëjetesa shqiptaro-gjermane në sport e teatro përfundoi pas atentatit të 23 tetorit 1944...

Nga ERGYS ALUSHI
VLORË

Kur në majat e maleve me dëborë kriste dyfeku e ndonjë top tek - tuk, në qytetet e mëdha të vendit jeta vazhdonte thuajse normalisht. Ishtin vitet 1943 -1944 dhe krahas luftimeve në periferi, në disa qytete në vend, u organizuan edhe disa ndeshje futbolli, gara atletike e tenisi, midis rinisë së qyteteve dhe ushtarëve gjermanë, të cilët kishin krijuar dhe skuadra të rregullta futbolli.

Kronikat nga shtypi i kohës raportojnë se njerëzit nëpër qytete mblidheshin në një numër të madh për t'i ndjekur ndeshjet. Mbështetja për djemtë ishte e madhe dhe fitorja kërkohej me çdo kusht aq sa shpesh shkaktonte nervozizëm e mund të rrezikonte shumë.

Ndërsa në male e zona të thella luftohej, më **3 shkurt 1944** një ekip i Tiranës zhvilloi një ndeshje miqësore futbolli me skuadrën ushtarake gjermane. Në fushën "Shallvare" në kryeqytet, megjithë kohën e keqe me erë e shi, u mblodhën një numër i madh qytetarësh tiaranas dhe ushtarësh gjermanë për të parë ndeshjen që filloi në ora 15.00, siç raportohet në median e kohës. Terreni ishte thuajse i papërshtatshëm për shkak të shiut të dendur që ra në drekë dhe gjatë zhvillimit të ndeshjes. Por, lojtarët futbollistë nuk e ndërprenë lojën. Pjesa e parë, përfundoi 2 me 0 për ekipin e Tiranës. Golat u shënuan që në minutat e para të lojës. Në pjesën e dytë u shënuan edhe dy gola, fillimisht gjermanët e në fund lojtarët e Tiranës e tundën për të tretën herë rrjetën gjermane. Golat e skuadrës së Tiranës u shoqëruan me brohoritje të shumta, e të gjata, aq sa buçima vinte thuajse në gjithë qytetin e të të krijohej ideja se ndeshja po luhej në një stadium gjigand.

### GAZETA GJERMANE 'DIE LAGE"

Ekipi i Tiranës ia mori dorën. Dukej i konsoliduar me djemtë e rinj që kishin aq dëshirë të mundnin gjermanët në fushën e lojës. Për shumë nga qytetarët aty, sidomos ata që mbështesnin hapur partizanët, kjo ishte një tjetër luftë, ndryshe nga ato me pushkë e mitraloza nëpër male.

Ndeshjet e futbollit dhe djemtë shqiptarë





SPORTI NË VLORË

Ndeshja miqësore midis Fanteris Gjermane dhe asaj të Grupit Sportiv Vlonjat 1-1 (2-3)

Mbas nji kohe të gjatë shofim Rinin Vlonjate që të rifilloje përsëri me një aktivitet lëmën e sajë Sportive.

Ndeshja fillojë n'orën 6.15, një publik i jashtëzakonëshëm e kishte mbushur fushen sportive të këtij qyteti.

Në fushë paraqiten që të dyja Skuadrat me këto formacione:

Grupi Sportiv Vlonjat: P. Vangjeli, J. Papasaia, C. Shal, P. Xhelali, H. Arapi, L.

tërhoqën vëmendjen edhe të gazetarëve gjermanë, që në fakt, raportonin për luftën, por edhe për aktivitetet që zhvillonin forcat gjermane.

Gazeta gjermane 'Die Lage" shkruante kështu për ndeshjen e datës **2 prill 1944** zhvilluar në fushën e Shallvares midis "Sport Klub Tiranës" dhe skuadrës përfaqësuese të trupave gjermane në Tiranë:

*"Përfundimi i barabartë 1:1 pasqyron me ma të plotën drejtësi lojën e zhvillueme prej të dyja skuadravet. Shqiptarët paraqitnë në fushë një skuadër që dijti t'u përgjigjet ma s'mirit shpresave të nguluna në'të me anën e nji loje kolektive të shpejtë dhe të shkathët. Veçanërisht e fortë u tregue mprojtja e tyne. Vlen të përmendet sidomos portjeri Stolz, që bani disa pritje të guximshme, të cilat i mbajtnë pa frymë jo vetëm shikuesit por edhe sulmuesit shqiptar...".*

Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi në barazim 0:0 megjithë rastet e pastra për shënim që u krijuan. Në pjesën e dytë, të parët shënuan shqiptarët dhe pak më vonë barazuan gjermanët, thuhet në artikullin e medias gjermane.

**"SPORT KLUB TIRANA" NË KORRIK 1944**

Fusha sportive e "Shallvareve" gumëzhinte përditë gjatë vitit 1944. Të rinjtë mblidheshin aty dhe praktikoheshin në disa sporte, kryesisht futboll, që ishte edhe sporti më i preferuar. Ky sport, nuk luhej vetëm aty. Kjo, siç shkruajnë kronikat e kohës, ishte fusha më e mirë, por në gjithë Tiranën, grumbuj fëmijësh e të rinjsh ishin pamja më e zakontë e ditëve të nxehta të korrikut 1944.

**JA SI E RAPORTOJNË GAZETAT DËSHIRËN PËR FUTBOLL:**

*"Ku ka një shesh, shpejt kthehet në një fushë skërmbylle për të vegjlit. Topi i tyre përbëhet prej leckash të ngjeshura në një si qese të rrumbullaktë e të qepur mirë. Portat e lojës janë shënuar me xhaketat. Distanca disa metrash. Lozin përgjithërisht këmbë zbathur, sepse mjer ata kur të kthehen në shtëpi. Këpucët kushtojnë aqë shtrenjtë, sot. Dhe kur u mungon sheshi, i shihni të lozin edhe anës rrugës…".*

"Sport klub Tirana" luante një rol të rëndësishëm në gjallërimin e jetës sportive të kryeqytetit. Selia e përkohshme e këtij klubi, ishte vendosur në shtëpinë foshnjore që njihej me emrin 'Hysen Nikolica". Ishte një seli e bukur për kohën, me mobilje të reja, kontribut i tregtarëve të Tiranës. Selia kishte dhe një bufe të pasur në asortimente, me çmime modeste për sportistët që



frekuentonin Qendrën e tyre. Kryetar i "Sport klub Tirana" ishte A. Shundi, një sportist i vjetër i Tiranës. Deri në korrik të vitit 1944, klubi numëronte 710 anëtarë të rregullt, nga të cilët 150 janë dashamirës, kurse të tjerët ishin anëtarë efektivë. Sportet më të frekuentura nga rinia ishin futbolli, atletika dhe boksi.

"Stradivari" – dramë me një akt e shkruar prej Galenos dhe e shqipëruar nga Kostaq Nase.
"Peshku në det, tigani në zjarr" – komedi me një akt, e shkruar nga Nikolla Laskari dhe e shqipëruar prej Kostaq Nase.
"Osman, opingaxhiu" – komedi me një akt e shkruar prej Viktor Eftimiut, shqipëruar nga Gjergj Bubani e Th. Duro.

## FUTBOLL DHE JASHTË TIRANËS

Të dielën e datës 2 korrik 1944 në Elbasan u luajt një ndeshje miqësore futbolli midis shoqërisë "Bashkimi Elbasanas" dhe ekipit të Vermach-it, që përfundoi me fitoren e ekipit vendas. Ndeshja filloi në orën 18.30 dhe u ndoq nga një numër i madh njerëzish që rrethonin fushën e futbollit. Gjermanët shënuan të parët në minutën e 10-të, ndërkohë që elbasanasit barazuan në minutën e 38-të. Në pjesën e dytë, lojtarët gjermanë e rrezikuan disa herë portën, por mbrojësi Gjeloshi ishte më i miri në fushë dhe largoi disa herë topin nga zona. "Bashkimi Elbasanas" shënoi dhe dy herë të tjera me N. Palin dhe Muzhaqin, dhe fitoi gjithë takimin me rezultatin 3:1.

Por pas suksesit të të rinjve elbasanas, një tjetër ndeshje u luajt në Vlorë në 20 korrik 1944. "Fonteria Gjermane" përballë "Grupit sportiv vlonjat", një takim shumë i luftuar nga të dy palët, por që përfundoi me rezultatin 3 me 2 për vlonjatët. Qindra banorë bregdetas rrethuan fushën ku po zhvillohej ndeshja pasditen e 20 korrikut në orën 18:15.

## NË MEDIA JEPET EDHE FORMACIONI I DY EKIPEVE.

"Grupi sportive Vlonjat" aktivizoi lojtarët: P. Vangjeli, L. Papasaia, C. Sharra, P. Xhelali, H. Arapi, L. Palla, M. Mina, Z. Muçaj, N. Dumani (kapiten), L. Ismaili dhe Papalilo.

"Fonteria gjermane" hodhi në fushë lojtarët: Kettner, Lindner, Schmid, Bruns, Maszar, Unrich, Ruzicha, Gerger, Kahtenbruner, Kettner (kapiten).

Ndeshja u arbitrua nga lojtari veteran i skuadrës vlonjate "Ismail Qemali", portieri i mirënjohur Llazar Vavypi. Golin e parë e shënuan gjermanët me anë të Gregorit. Pas pësimit të golit vlonjatët shfaqën nervozizëm, ndërsa publiku kërkonte barazimin. Në një prej sulmeve të vlonjatëve, Papalilo pengohet brenda zonës dhe arbitri vendos për 11 metërsh, të cilin Mina e ktheu në gol. Pjesa e parë mbyllet në barazim 1:1. Në pjesën e dytë, gjermanët shënuan sërish të parët, por vlonjatët barazojnë sapo nisën topin nga mesi i fushës. Goli i fitores erdhi vetëm disa minuta më vonë duke u mbyllur takimi 3:2 për vlonjatët.

Për të përgatitur ndeshjen me gjermanët, vlonjatët zhvilluan një ndeshje përgatitore me "Apoloninë" e Fierit. Rreth 2000 spektatorë ndoqën ndeshjen që u zhvillua në fushën përgjatë rrugës Vlorë-Skelë. Arbitri i ndeshjes, ishte portieri i ekipit të ushtarëve gjermanë. Ndeshja përfundoi 4 me 0 për ekipin e Vlorës.

Ndërsa përgatitej ndeshja kundër gjermanëve, çunat e Vlorës nuk mund të prezantoheshin pa uniforma. Për këtë u kujdesën tregtarët e Vlorës, Levi Jakoel, Qazim Sorra e vëllezërit e tij si dhe vëllezërit Bekosta, të cilët, me ndërmjetësimin e Eqerem Sorrës dhuruan vullnetarisht uniformat për ekipin.



## SPORTI I TENISIT DHE FUSHA E "TENIS NALLBANI"

Drejtuesit e "Tenis Nallbani" me dëshirën e vetë lojtarëve, organizuan disa ndeshje tenisi, nën kujdesin e Komitetit Krahinor të Tiranës dhe Shoqatës Mirëbërëse të Beratit. Të hollat nga shitja e biletave shkuan për të mjeruarit e luftës të rretheve të Tiranës e Beratit.

Në ndeshjet individuale u përballën Jusuf Vrioni kundër Sali Nallbanit dhe Hasan Meniku kundër Felatun Vila, sipas asaj që shkruhet në gazetat e korrikut 1944.

Fusha e "Tenis Nallbani" ndodhej në qendër të kryeqytetit, vetëm disa metra larg fushës sportive të "Shallvares". Një nga kampionët e kohës në tenis, ishte Salih Nallbani.

*"Fusha është e rrethuar me rjeta të larta teli dhe i ndan në mez një kopësht i gjerë plot pemë që bëjnë hije të këndëshme për këtë kohë vape….gjer tani dy janë fusha efektive të tenisit, tri tavolina ping-pongu, një shenjë qitjeje dhe një vokator për të shkrirë mushkujt në mëngjez. Mbi këto duhet të shtojmë dy dhoma çveshjeje, njëra për seksin e vrazhdet dhe tjetra për atë të ëmblin. Janë dy dhoma moderne me dushet aq të nevojshëm brenda… Janë nja pesëdhjetë meshkujt e nja tridhjetë femrat, amatore. Në garat e fundit që janë çfilluar ca kohë më parë u dalluan: Niko Bonati dhe Andrea Aroni, të cilët janë klasifikuar në kategorinë e parë. Nga vajzat më të mirat kanë dalë zonjushat Hando Hoxha dhe Viollca Grëblleshi"…(korrik 1944)*

## KUSH ISHTE SALIH NALLBANI?

Që në moshën 15 vjeçare, shtypi i kohës e përmend Salih Nallbanin si fenomen në sportin e






SPORTI N'ELBASAN
"Bashkimi Elbasanas" - Vermacht
(3-1) (1-1)
Të Dielën me datën
2-7-944 u-zhvillue nji ndesh-
je miqsore topi-kambe, në
mes të Shoqnis « B. Elbasa-
nas » dhe asaj të Wermach-
-it, e cila përfundojë me
timin e skuadrës vendëse.
Loja që mjaft tërheqse
ulli tifoz i qytetit pat
nue krejt fushen. Koha
bukur dhe n'orën 6.30
i fishkëllon fillimin e
Në të 10' e para skua-
ermane shënon golin
Atëhere lojtarët e
sanas » filluen të
e pasa të matun
38' skuadra e gy-
oj me anen e


SPORT
Skuadra ushtarake gjermane
Skuadra Tiranase 1-0
Të djelën, ora 5 m. d. në she-
shin « Shallvare » u zhvillua
ndeshja e footballit (révanche),
midis skuadrës ushtarake Gjer-
mane dhe asaj të Tiranës. Koha
e parë përfundoi 0-0, kurse në
të dytën gjermanët shënuan
goalin e fitimit.
Ndeshja e parë, dy javë të
kaluara, u fitue nga skuadra
Tiranase 3-1.
Mbi këtë lojë, e cila u zhvi-
llua para një publiku të shum-
të, dhe ishte interesante, do të
japim hollësira të veçanta në
numurin që vjen.



tenisit. Kur ishte në gjimnaz, stërvitej me të tjerë pasionantë tenisi, nga nga profesori Marchand. Pas dy muajsh stërvitje, u organizua ndeshja e parë me Tenis Mbretnor, skuadra e II. Në këtë ndeshje, ekipi ku përfshihej edhe Nallbani humbi 5:1, ndërsa të vetmen ndeshje e fitoi, ai.

Tre muaj më vonë, ndeshja u luajt sërish dhe skuadra e Nallbanit fitoi 5:1. Pas këtij suksesi, Nallbani u thirr nga "Tenis Mbretnor" që frekuentohej në ato vite nga elita e Tiranës dhe diplomatët e huaj. Lojtari më i mirë i Tenisit Mbretnor ishte gjermani Stahl, për 7 vite me rradhë kampion ndër shqiptarët e të huaj.

Gjashtë muaj pasi kishte kapur për herë të parë raketën e tenisit me dorë, Nallbani i mundi me radhë njëri pas tjetrit të gjithë lojtarët më të mirë të Tenisit Mbretnor, përfshi këtu edhe profesorin e tij Machardin, e më në fund, në vitin 1932, mundi edhe vetë Stahl-in, të cilin nuk e kishte mundur kush deri në atë kohë.

Tenisti shqiptar Salih Nallbani zhvilloi dhe takime ndërkombëtare: në Stokholm, Kopenhagen, Berlin, Romë etj., dhe fitoi disa ndeshje me tenistë të njohur në Evropë.

## PAK HISTORI PËR KOHËN

Në 8 shtator 1943 Italia fashiste kapitulloi dhe ushtria gjermane nuk e kishte të vështirë të hynte në Shqipëri e të vendoste kontrollin në pjesën më të madhe të territorit të vendit. Më shumë se 70 mijë ushtarë gjermanë mësynë në zonat kryesore në vend dhe u vendos gjendja e luftës. Historia tregon se një ndër masat e para të Komandës gjermane ishte çarmatosja e popullatës dhe kërcënimi se për çdo ushtar gjerman të vrarë, do të vriteshin 30 shqiptar dhe për çdo ushtar gjerman të plagosur do të vareshin në litar, 10 shqiptarë. Gjermanët u kujdesën dhe krijimin e organeve qeverisëse shqiptare që do të ishin në kontrollin e tyre. U thirr Asambleja Kombëtare; u krijua Këshilli i Lartë i Regjencës dhe më pas qeveria e Shqipërisë. Paralelisht me këto masa të gjermanëve për krijimin e organeve qeverisëse, erdhi dhe reagimi i parë kundër tyre, siç ndodhi më 18 tetor 1943 kur artileria partizane goditi me top, pallatin ku po zhvillonte pansambleja e thirrur nga gjermanët. Pushtuesit krijuan dhe ushtrinë e xhandarmërinë shqiptare për t'i patur në kontroll e për t'i përdorur kundër popullatës. Pas masave të marra, ushtria gjermane filloi atë, që në historinë shqiptare është njohur si Operacioni i Dimrit 1943-1944 duke ndërmarrë një ofensivë të gjerë kundër forcave partizane e pasuar kjo me djegie fshatrash e masakra në popullatë, për t'i trembur me qëllimin që të mos bashkëpunonin me forcat partizane.

**NDESHJE BOKSI NGA KAMPIONI RAFAIL DISHNICA**

Në sallën e kinema “Donika”, në ora 18.30 të datës 9 gusht 1944, në prani të një publiku shumë të madh dhe entuziast u zhvillua një ndeshje boksi midis boksierëve gjermanë dhe shqiptarë. Gjermanët ishin më me përvojë në boksim, pasi kishte zhvilluar mbi 20 ndeshje (apo dhe më shumë), ndërsa boksierët shqiptarët hipnin për herë të parë mbi dërrasat e ringut.

Për habi të gjermanëve, boksierët shqiptarë i fituan të gjitha ndeshjet, duke pasur me vete dhe mbështetjen e zjarrtë të publikut. Ra në sy menjëherë suksesi i kampionit profesionist të boksit shqiptar, Rafail Dishnica.

Myftar Marko fitoi në raundin e tretë ndaj gjermanit Rossner. Shqiptari Mehmet Kryeziu fitoi me pikë ndaj gjermanit Eulberg. Me pikë fitoi dhe Ali Kastrati ndaj gjermanit Jahn. Ndeshja më e bukur që arriti dhe kulmin e entuziazmit ishte ajo e zhvilluar midis Rafail Dishnicës dhe gjermanit Hofmeister. Boksieri profesionist shqiptar tregoi nje nivel të lartë boksimi sikurse shkruhet në median e kohës. Edhe boksieri gjerman ishte i një niveli të lartë, por në fund, fitorja i buzëqeshi shqiptarit Dishnica.

**NË TIRANË LUHEJ TEATËR!**

Në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë, jeta dukej sikur zhvillohej normalisht, megjithë lajmet e gazetave që flisnin gjithandej për luftime dhe “fitore të ushtrisë gjermane”. Kishte fusha tenisi, ring boksi e luhej teatër.

Të shtunën e datës 1 korrik 1944, grupi filo-dramatik i mikrofonit të Radio Tiranës dha një shfaqje teatrale për publikun e kryeqytetit duke interpretuar dramën “Stradivari” (me një akt) dhe komeditë, po nga një akt, “Peshku në det, tigani në zjarr” dhe “Osman, opingaxhiu”. Shfaqjet u dhanë në teatrin “Kosova” dhe u ndoqën nga spektatorë të shumtë në numër.

Sikurse shkruhet në shtypin e atyre viteve, Kostaq Nase u dallua në interpretimin e rolit të Zhanit, në dramën “Stradivari” dhe në rolin që kishte te “Osman, opingaxhiu”. E.Zoraqi spikati me lojën e saj në të trija pjesët edhe pse ishte një aktore e re, që dilte për herë të skenë para spektatorëve. U dalluan dhe aktorët e tjerë si Meri Harito, Mihal Stefa, Vanthia Zoraqi, Bardhyle Nase, Thomaidha Rako, Hasan Reç dhe regjisor Mihal Ciko. Shfaqjet patën sukses, me përjashtim të problemeve të zërit të aktorëve që nuk dëgjohej, ndaj shpeshherë, ata detyroheshin t’a ngrinin, ndonjëherë edhe me të çirrura gjatë interpretimit. Kjo sepse Teatri “Kosova” nuk kishte akustikë të mirë.

Në shtypin e kohës, shfaqjet u cilësuan si një hap pozitiv drejt formimit të një Teatri Kombëtar. Por kritikohej sjellja e publikut gjatë shfaqjeve.

**JA SI RAPORTON MEDIA E KOHËS:**

*“E para, një mungesë e plotë disipline. Vonesa e të ardhunit në Teatër. Gjetkë, kur një njeri arrin pesë minuta vonë dhe pjesa është duke u lojtur, ay prêt në këmbë të mbarohet akti pastaj të shkojë e të ulet në vënd të tij. Në çfaqjet tona, zihen, sepse zotnia që ka paguar paret, do vëndin medoemos. Dhe kështu shkaktohet një zhurmë prej dreqi, njerëzisë i hipin nervat dhe humbet vijimin e pjesës. Përveç kësaj, këtu ndër ne, kur venë në “teatro’, shkojnë me kuç e me maç, sikur të vinin në ndonjë panair: marrin me vete edhe foshnjat e djepit të cilat bërtasin (të mjerat foshnja se ç’prindër kanë) – Uaaaa!...Uaaa!...pikërisht kur publiku i emocionuar nga një sqenë patetike i ka sytë me lot. Mos kujtojmë pastaj turmën e kalamaqëvet nga 5 gjeri në 10 vjeç! Një ndeshje ‘Top këmbë” me një çfaqje theatrore, janë dy ekstreme!...Edhe të tymosurit në sallë gjatë çfaqjeve është një tjatër ves i keq që s’u ndreq, shkoi e vate”…(1944)*

## RADIO TIRANA

Ndërsa në Tiranë dhe në disa qytete të vendit zhvilloheshin ndeshje miqësore me ekipet e ushtarëve gjermanë, Radio Tirana argëtonte shqiptarët me programin e saj ditor.
Të dielën e datës 23 korrik 1944 nga shtypi i kohës shkëputëm programin e Radios:

| | |
|---|---|
| **Ora 07.00** | – Lajme gjermanisht |
| **Ora 07.15** | – Muzikë e ndryshme |
| **Ora 07.30** | – Lajme shqip |
| **Ora 08.00** | – Muzikë popullore |
| **Ora 08.25** | – Ora e katundarit dhe biseda e mjekut H. Sulçebe |
| **Ora 19.00** | – Ora gjermane |
| **Ora 20.00** | – Lajme gjermanisht |
| **Ora 20.15** | – Kuarteti shkodran |
| **Ora 20.45** | – Lajme shqip |
| **Ora 21.05** | – “Dy fjalë ndëgjuesit” |
| **Ora 21.15** | – Grupi filodramatik i Radios |
| **Ora 22.00** | – Lajme anglisht |
| **Ora 22.15** | – Muzikë e ndryshme |
| **Ora 22.45** | – Lajme shqip |
| **Ora 23.00** | – Muzikë vallzimi |





**LARG FUTBOLLIT, DREJT LUFTËS**

Kur situata e luftës sidomos në mal u rëndua, nuk mund të flitej më për sporte. Gjermania po pësonte humbje të konsiderueshme në të gjithë frontin e luftës, duke përfshirë dhe Shqipërinë. Forcat partizane të mbështetura nga aleatët dhe një pjesë e madhe e popullsisë, kishin fituar terren dhe ushtria gjermane u grumbullua në disa qytete.

Ngjarjet rrodhën njëra pas tjetrës. Ato kulmuan me dy vrasje në shtator – tetor 1994, ç’ka i dha fund bashkëjetesës kulturore - sportive mes gjermanëve dhe shqiptarëve.




Faksimilet e përdorura në artikull janë marrë nga gazetat e kohës

> Të shtunën e datës 1 korrik 1944, grupi filo-dramatik i mikrofonit të Radio Tiranës dha një shfaqje teatrale për publikun e kryeqytetit duke interpretuar dramën "Stradivari" (me një akt) dhe komeditë, po nga një akt, "Peshku në det, tigani në zjarr" dhe "Osman, opingaxhiu".

Të mërkurën e datës 6 shtator, rreth orës 23.00, u vra me armë zjarri në banesën e tij, Lefter Kosova, i sapoemëruar Ministër i Punëve Botore në qeverinë e krijuar nga Ibrahim Biçakçi. Vrasja e ministrit Kosova bëri një bujë të madhe. Tirana, e mësuar me atentate të ndryshme, po përjetonte një atentat të një niveli të lartë. Sapo u mësua lajmi, qeveria mblodhi një Këshill të Posaçëm, ku bashkë me masat për kapjen e autorëve, u vendos dhe për ceremoninë e varrimit që do të kryhej ditën e enjte (7 shtator 1944) në orën 15.00. Aty morën pjesë autoritetet më të larta të shtetit (për kohën) që nga Anëtarët e Këshillit të Lartë, Lef Nosi e Ceno Beg Ulqini, kryeministri, kryetari i parlamentit Mihal Zallari me të gjithë deputetët, ministra, prefekti i Tiranës e shumë drejtues institucionesh. "Kemi të bëjmë me një vrasje politike dhe kam frikë se vrasësit mburren për veprën e tyre", tha në ceremoni kryetari i Kuvendit Mihal Zallari.

Natën, duke u gdhirë 21 tetori 1944, në rrugën e Dibrës, në mes të Tiranës, u krye atentati kundër një automjeti gjerman. Viktimat ishin oficerë madhorë gjermanë dhe ushtarë. Ngjarja zemëroi keqaz Komandën gjermane. Në komunikatën drejtuar qytetarëve të Tiranës shkruhet:

*Durimi i Fuqive t'armatosura gjermane mori fund. Banorët që janë përreth vendit të ngjarjes nuk janë kujdesur të largojnë, ose të pengojnë krimin e shëmtuar. Si masa ndëshkimi urdhërohet për sa vijon: Lagjja rreth e përqark vendit të ngjarjes në rrugën e Dibrës, do të shembet. 2. 100 të burgosur komunist nga Tirana, që i përkasin rangut intelektual dhe që ndodhen në fushën e përqëndrimit të Prishtinës, do të pushkatohen menjëherë për hakmarrje. 3 80 pjesëtarë të njohur të "Nacional-Çlirimtares" në Tiranë do të mbahen peng dhe në rast të përsëritjes të atentateve kundër pjesëtarëve të fuqive të armatosura gjermane do të varen publikisht…"*



# Margarita Xhepa sezoni i një dame

Nga SUADA DACI

FRANC ZHURDA

Margarita Xhepa do të jetë gjithmonë! Për ikonën e artit shqiptar nuk ekziston fjala “na ishte dikur” ...Zonja e teatrit dhe filmit shkëlqen si “margaritar “ nëçdo stinë të jetës dhe duket sikur formulën magjike të rinisë do ta ketë përjetësisht aleate të sajën. Me Margarita Xhepën isha takuar në vitin 2010, (asokohe isha reportere në Agjensinë Telegrafike Shqiptare) dhe e shoqërova për në shtëpi pas premierës së filmit “Ne dhe Lenini”, ku Xhepa ishte një nga protagonistet kryesore të filmit të regjisorit Saimir Kumbaro. Dhe ja ku jemi sot fiks pas 12 vitesh, unë jo më poshtë pallatit të saj,por në shtëpinë e saj (me maskë) ku do të flasim gjatë për atë ç’ka ka ndodhur në këto 12 vite të karrierës së saj dhe jo vetëm. Ajo më tregon se është ruajtur shumë përgjatë periudhës së pandemisë dhe deri tani nuk është prekur nga virusi global që i mori jetën miliona njerëzve në botë.“Nuk më ka zënë covid-i, jam ruajtur. Kam patur shumë kujdes, kam bërë dy vaksinat madje edhe të gripit. Kjo është një pandemi globale, ndaj duhet të ruhemi…”, thotë artistja e madhe e skenës shqiptare e cila pjesën më të madhe të kohës e kalon në shtëpi duke lexuar. E në fakt një nga detajet që doja të ndaja me publikun është se apartamenti i saj i vogël është i mbushur plot me libra e çmime.



"Libri i parë që kam lexuar ka qenë Gremina e dashurisë", nga Mustafa Greblleshi, më pas "Nëna" e Gorkit dhe kam vijuar të lexojë përgjatë gjithë jetës sime. Për mua librat janë ushqim shpirtëror kaloj kohën më të mire në shoqërinë e tij", tregon ajo…

Margarita Xhepa është si orë nuk di të ndalet dhe më vjen mirë që e shoh të lumtur si një fëmijë për rolin e ri në filmin "Bolero në vilën e pleqëve", me regji të Spartak Pecanit.

"Më nxorri mallin dhe nostalgjinë e filmave të para viteve '90, jo vetëm për temën por edhe për punën e regjisorit dhe stafit realizues. Mu kujtua ajo kohë kur punohej bukur. Marrja e rolit për mua ka qenë një gëzim i madh. Im shoq ma thoshte gjithnjë

kur më shihte të lumtur çfarë roli ke marrë. Unë i thoja po ku e kuptove që kam marrë një rol? Nga mënyra se si e shtrove tavolinën", thotë Margarita Xhepa dhe sytë e kaltër i marrin një tjetër shkëlqim kur nis dhe flet për filmat ku ka interpretuar, ose me saktë për gjithë kohën dhe jetën që i ka kushtuar KINEMATOGRAFISË dhe TEATRIT...





"Jam e gëzuar që u bë një film i ri nga një roman shqiptar i Fatos Kongolit, të cilin e kisha lexuar më parë. Ajo që më bëri përshtypje ishte mesazhi që ngrinte në këtë roman. Ne kemi tema nga më të veçantat dhe tepër të bukura që nuk po bëhen skenare, këtu ndjej mungesën e Vath Koreshit, Kiço Blushit, Teodor Laços, Dhimitër Xhuvanit, Nasi Lerës, Nexhiti Tafës, që kanë bërë skenarët më të mrekullueshëm në Kinostudio. Kur më erdhi ky skenar në dorë e lexova me një shpejtësi të jashtëzakonshme sepse ishin përfshirë në të ngjarjet më interesante të librit dhe çdo ngjarje plotësonte tjetrën. Prindërit sot po mbeten vetëm dhe kjo është një dramë që e vuajnë shqiptarët", rrëfen Margarita Xhepa duke treguar se në rolin e saj të ri trajton dhimbjen e gjithë nënave shqiptare.

**35 VJET QË INTERPRETON ROLE NËNASH (DHE ASPAK TË NJËJTA)**

"Jo tani që jam kjo që jam por qysh atëherë kam patur merak për të gjetur të veçantën e çdo nëne. Fillimisht të veçantën e gjejmë tek halli, tek drama, tek vuajtja, tek dhimbja, tek marrëdhënia që ajo ka me të tjerët. Gruaja që luaj në filmin e fundit ka qenë artiste, balerinë. Në gjithë qënien e saj ka një elegancë, nuk ka banalitet edhe pse sëmundja e ka rënduar pak ajo përsëri nuk e ka humbur bukurinë e



> Në kohën tonë nuk lejoheshin as puthjet, ndërsa për t'u zhveshur s'kemi patur rast. Edhe në një skenë me Agim Qirjaqin (në filmin "Misioni përtej detit") edhe aty bëmë sikur po putheshim.

“Regjisorët ashtu e kanë parë të arsyeshme, nuk mund t’ua kërkoja unë të interpretoja krah djalit tim”, për të cilin flet pak por nuk ngurron të tregojë se së bashku me bashkëshortin e saj, ishin dy nga kritikët më të mëdhenj të Ndriçim Xhepës, që po njësoj si nëna e tij është një prej aktorëve më të jashtëzakonshëm të kinematografisë dhe teatrit…

saj si grua”, thotë Xhepa.

Por mua më pëlqen ta ngacmojë pasi dua të di se cila ka qenë nëna e saj e preferuar, ajo e Vlashit (te “Pylli i Lirisë”), e Arturit (te “Apasionata”) apo e Irenës (te “Pranvera s’erdhi vetëm), apo Besimit ( te “Dora e ngrohtë)…?!

“Këto nëna i kam pranuar sepse i kam parë tek vetja. Kush më ka pëlqyer më shumë?! Hmm… Roli im tek “Pylli i Lirisë” dhe e di pse?! Sepse aty brenda janë të gjitha nënat myzeqare. Në lagjen ku jam rritur kisha disa nëna që ishin model. Kisha fiksuar në kokën time të gjithë mimikat, lëvizjet e tyre, kisha material dhe u’a bashkangjisja roleve të mia. Aty edhe ecjen e kam bërë si nënat myzeqare, se kisha problem të ecja zbathur sepse isha mësuar që fëmijë. Unë vijë nga një familje e varfër , babai na blinte një palë sandale për Pashkë dhe me to kalonim gjithë vitin ( këtë ja kam thënë edhe Gëzim Erebarës)”.

Ama me Ndriçim Xhepën keni interpretuar rolin e nënës vetëm në dy filma “Shokët” dhe “I dashur armik”, pse kjo zgjedhje?

“Regjisorët ashtu e kanë parë të arsyeshme, nuk mund t’ua kërkoja unë të interpretoja krah djalit tim”, për të cilin flet pak por nuk ngurron të tregojë se së bashku me bashkëshortin e saj, ishin dy nga kritikët më të mëdhenj të karrierës së saj. Po nga kolegët e tjerë artist me cilin ke më shumë “kimi” skenike?!

“Jam ndjerë mirë me të gjithë, bashkëpunimi i fundit që kisha me Robert Ndrenikën në filmin “Bolero në vilën e pleqve” ishte fantastike. Ata në film janë një çift që e duan njëri-tjetrin deri në vdekje, madje Bertit i thashë s’do të të them i dashuri im por o xhan. Kur vdes në fund personazhi im nuk kërkon fëmijët por bashkëshortin e saj.

### SKENAT “NUDO” TEK FILMI I RI

Po është e vërtetë dal paksa e zhveshur në një nga skenat e filmit. Futem në dush dhe shërbyesja ime e cila interpretohet nga Gentiana Ramadani, më ndihmon të lahem. Pra unë shfaqem me shpinë në dush, ndërkohë që Gentiana ka një skenë të sajën ku bën dush “topless”.

### I KE PATUR TABU SKENAT EROTIKE NË FILMA?!

Në kohën tonë nuk lejoheshin as puthjet, ndërsa për t’u zhveshur nuk bëhej fjalë. Edhe në një skenë me Agim Qirjaqin (në filmin “Misioni përtej detit”) edhe aty bëmë sikur po putheshim.

**E meqënëse jemi tek këto skenat e guximshmem më lind pyetje vetvetiu, po rrjetet sociale a i përdor??** Aaa këtu do të të them një shprehje të Tinka Kurtit. Kur e pyesin Tinkën a ka “Facebook”?! Posi thotë kam veç bukë, jo Facebook. (Qesh) Edhe unë si Tinka Kurti kam një telefon fiks dhe një telefon modest celular.

### MARGARITA XHEPA NUK I KISHTE KOMPLEKS ROLET DYTËSORE

“Dritë i pastë shpirti Viktor Gjikës, i cili më dha rolin dytësor “ Tek Gjeneral Gramafoni”. Megjithatë edhe aty arrita që të bëja një batutë timen pa qenë në skenar. Nuk e di nëse ju kujtohet skena tek ballkoni ku unë them “ U ndez fukaraja” dhe regjisori e pëlqeu pa masë atë batutë. Edhe një rol të vogël aktori duhet ta mbushë me batuta e gjeste. Madje rolit të vogël duhet t’ja bësh më shumë shërbimin…”, tregon Xhepa…

Por sa ndërhyn Margarita në skenaret teatrale dhe ato kinematografike?!





"Bisedat me aktorin dhe regjisorin janë shumë të rëndësishme. Ne e vendosim bashkarisht si do të trajtohet karakteri, ndonjëherë regjisori e pranon ndonjëherë jo. E kam bërë gjithnjë edhe në teatër dhe film. Madje edhe në filmin e fundit kam shtuar disa batuta nga vetja. Kam një bisedë me Olta Dakun (vajzën time), e cila zbulon që shërbyesja ime është lezbike dhe unë i them po ti çfarë ke, ajo na shërbën, na ndihmon. S'ke faj ti moj vajzë, ti e more shërbyesen tënde për të pastruar dhe ajo të mori burrin. Kjo është një batutë e imja..."

**KARRIERA E GJATË DHE RIVALITETI NË ART...**

Megjithatë jo çdo që shkëlqen është ar e në këtë rrugëtim të gjatë me siguri edhe Margarita Xhepa do të ketë patur rivalet e saj. Përshembull Tinka Kurti, nuk e di pse ne publiku i kemi cilësuar gjithnjë si rivale...

"Unë dhe Tinka kemi të dyja titujt "Nderi i Kombit" dhe "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Kurrë nuk ka patur rivalitet mes nesh. Unë e kam çmuar gjithnjë Tinkën, madje ajo ka një plus më shumë se unë sepse luan bukur edhe në komedi.



"Vendlindja është gjë e madhe, sepse çdo ditë merr virtytet e vendit ku je lindur. Jam shumë e mbushur me kujtimet më të bukura, duke filluar që nga prindërit e që edhe pse njerëz pa shkollë i donin njerëzit dhe dera e tyre rrinte hapur duke pritur këdo"

**POR SI I KUJTON KOLEGËT QË NUK JETOJNË MË?**

"Ata kanë qenë kollozë ( i dridhet zëri ). Po të them tre emra do të gaboj, po të them trembëdhjetë po ashtu... Ishte koha e të mëdhenjëve. Punonim me një dashuri të madhe, përkushtim të jashtëzakonshëm, kurse sot ka të tjera raporte midis pasionit për punën dhe shpërblimit. Unë kam ende kënaqësi kur marr një rol. Në fillim më gëzon shpirti kur marr në dorë skenarin pastaj diskutoj pagesën. Nuk vjen më ajo kohë, ishte kohë e artë... Se si ne e ndihmonim njëri-tjetrin, a ma pe proven më thoshte Drita Pelingu, Violeta Manushi, Besa Imami...

**LUSHNJE, LUSHNJE, LUSHNJE...**

Tjetër orientim merr biseda kur flasim për qytetin e saj të lindjes. Madje regjisori Spartak Pecani ka vendosur që filmin "Bolero në vilën e pleqve " ta shëtisë në shumë qytete të Shqipërisë dhe i pari qytet pas Tiranës do të jetë pikërisht, Lushnja.

"Vendlindja është gjë e madhe, sepse çdo ditë merr virtytet e vendit ku je lindur. Jam shumë e mbushur me kujtimet më të bukura, duke filluar që nga prindërit e që edhe pse njerëz pa shkollë i donin njerëzit dhe dera e tyre rrinte hapur duke pritur këdo. Të duash punën dhe njerëzit, marrëdhënia njerëzore është gjëja më e madhe... Ky ka qenë parimi im në jetë, ma ka mësuar babai im...




*Historia flet, tradita vazhdon!*

Kantina Gjergj Kastrioti Skendebeu - Durrës

kantinaskenderbeu

E-Mail: info@kantinaskederbeu.al / Mob: 068 20 91 886 / Web: www.kantinaskenderbeu.al



# TË VARFËR NË LETRA TË PASUR NË JETË

# ZBULOHEN RROGAT E FUTBOLLIT ELITAR

Nga RETIN TOKA

Gashi (Gugash Magani) kishte marrë një telefonatë si në çdo kohë merkatoje. E njihnin si ekspert në fushën e trajningut, por dyshimet për një projekt të qëndrueshëm i ngacmonin gjithmonë trurin. Drejtuesit e Egnatias ishin të bindur se ai do të arrinte të krijonte një grup kompakt për të sjellë mes më të mirëve, rrogozhinasit. Magani kishte eksperiencën e nevojshme për të drejtuar një skuadër në kampionatin shqiptar, mirëpo stofi i elitës dukshëm i rri më bukur veshur. Si një peqinas i palëkundur, ai i tha “Po” sprovës që e priste. Kishte provuar edhe vetë për shumë vite të luante në moçalet e shumë stadiumeve në Shqipëri, por kishte pasur edhe mundësinë të provonte emocionet në legjendarin “Qemal Stafa”, asokohe më i miri në vendin tonë. Fillimisht duhej formuar grupi që do të kontribuonte për të sjellë në Superiore Egnatian. Njohjet i kishte të shumta. Telefonatën e parë e pati me presidentin Agim Demrozi: “Do të më thuash sa buxhet kam, më duhet të marr lojtarët”. Në dispozicion të tij u vu një shumë e konsiderueshme, por asesi nuk ishin si ato shifrat me shumë zero si në Superiore. “Një skuadër e mirë fillon gjithmonë me një kapiten të fortë”, mendonte ai me vete. “Do të marr dikë që të më ndriçojë udhën drejt Superiores. Madje nuk duhet ta zgjas. Po e kontaktoj menjëherë”, vijonte më tutje duke pasur në mendje Ndriçim Shtubinën, mesfushorin e Vllaznisë që në elitë kishte qenë gjithmonë në të njëjtin nivel. 34-vjeçari u njoh me ofertën e drejtuesve rrogozhinas. Ishte e papërfillshme krahasimisht me atë që ishte mësuar në elitë.

Megjithatë mënyra se si po trajtohej te Vllaznia s'i kishte hije një njeriu që kishte dhënë “shpirtin” për atë ekip. Mes parave dhe krenarisë, zgjodhi këtë të dytën. I tha “Po” profesor Gashit, ia njihte mirë karakterin dhe dëshirën për të qenë “on top”. U vu nën urdhrat e tij duke fituar menjëherë shiritin e kapitenit pasi eksperienca në Shqipëri ia ofronte një luks të tillë. Në fushë nisi të bënte mirë, pa marrë aspak parasysh shifrat që kaloheshin në llogarinë e tij. Te Vllaznia, informaliteti ishte në nivele minimale për të mos thënë që gjitha pagat deklaroheshin duke paguar tatimet e nevojshme. Kapiteni atje ishtë më i sigurtë se të gjitha rrogat me apo pa hir do t'i merrte sipas asaj që ishte shkruar, “e zeza mbi të bardhë”. Ndërsa te Egnatia ishte ndryshe. Kishte arritur një marrëveshje xhentilmenësh, ku në kontratën e tij ishte paga minimale: 30 mijë lekë në muaj. Për këdo që e dëgjonte ishte e pakonceptueshme, por kjo ishte Kategoria e Parë. Këto ishin mundësitë që të ofronte kjo ligë e kampionatit shqiptar. Shtubina s'e kishte bërë për para. I kishte dhënë fjalën e burrit profesorit të tij që e njihte mirë. Nëse do të bënin mirë do të kishte shpërblime, por këto ishin opsionale. Praktikisht ai duhej të mbante familjen me aq të ardhura sa ishin të shkruara në kontratë. Juridikisht vetëm ato njiheshin.

Kategori e Parë apo Abissnet Superiore? Duket si një pyetje që i bëhet një fëmije për të zgjedhur mes një lodre të thjeshtë dhe një të shtrenjtë, ku përgjigja është e pandryshueshme: Më të mirën! Futbolli në Shqipëri ka evoluar, ka njohur progres duke u bërë i njohur edhe për Europën. Po, edhe në vendin tonë luhet, ka pasion, dëshirë dhe ëndrra për të bërë përpara. Megjithatë hendeqet mes elitës dhe kategorive inferiore janë vërtetë të mëdha.

**RROGAT, DEKLARIMET NË TATIME TË 10 KLUBEVE TË SUPERIORES**

Nëse gjithëkush mban mend që te Skënderbeu çdo lojtar apo të gjithë pjesëtarët e stafit laheshin në "ar", kjo tashmë ka mbetur vetëm një mit. Klubi korçar është pjesë e Superiores, megjithatë deklarimet në tatime i ka njësoj për të gjithë futbollistët. Çdo lojtar i Skënderbeut, sipas tabelës së publikuar në fund të vitit të shkuar, paguhet 30 mijë lekë në muaj. Shifra qesharake këto në krahasim me atë që dikur futbollistët e korçarëve paguheshin kur ishin në majën e elitës së futbollit shqiptar. Shefi i klubit, Ilirjan Përmeti dhe ish-trajneri, Julian Ahmati kanë pasur rrogat më të larta, me 50 mijë lekë në muaj. Ndërkohë Ardjan Takaj s'figuron askund si pjesë e klubit korçar. E njëjta histori duket dhe me Laçin që veç administratorit Laska dhe ish-trajnerit Duro me 70 mijë lekë, lojtarët paguhen me pagën minimale 30 mijë lekë në muaj. Ndërkohë te Kukësi, janë treguar disi më të kujdesshëm duke e bërë list-pagesën më të larmishme. Vesel Limaj ka qenë më i paguari me 100 mijë lekë në muaj, por pjesa më e madhe e futbollistëve vijon po njësoj me pagën minimale 30 mijë lekë në muaj. Tirana është klubi tjetër që duket se rrogat i deklaron më afër nivelit të Superiores. Grend Halili kryesonte listën me 200 mijë lekë në muaj, ndërsa pjesa tjetër e ekipit paguhej sipas kontratave të firmosura që vijojnë me 130 mijë lekë, 100 mijë lekë etj. Çudia është te Kastrioti që nuk figuron te tatimet. Asnjë lojtar nuk bën pjesë në list-pagesat e publikuar në fund të vitit të shkuar. Administratori Gazmend Vogli figuron si nëpunës sporti në Bashkinë e Krujës me vetëm 48 mijë lekë në muaj. Sakaq Teuta kampione nuk i ka të publikuara të dhënat e lojtarëve të vet. Vetëm presidenti Edmond Hasanbelli me statusin e administratorit paguhet 50 mijë lekë në muaj. Ndërsa për të tjerët nuk ka shifra.

**VLLAZNIA DHE PARTIZANI, KLUBET ME RROGAT MË TË LARTA NË TATIME**

Është quajtur "djepi i futbollit" shqiptar dhe jo me pa të drejtë. Vllaznia është një nga klubet më korrekte në Kategorinë Superiore sa i përket detyrimeve ndaj shtetit. Të gjitha rrogat janë të deklaruara, ashtu sikurse lojtarët paguhen. Miliona lekë në muaj për organikën shkodrane, të cilët i marrin të gjithë përmes bankës. Më i paguari rezulton Ardit Hoxhaj me 488 mijë lekë në muaj. Në të njëjtën kategori vijojnë dhe shokët e tij, Dilaver dhe Gurishta. Trajneri i zgjedhur si më i miri i vitit të shkuar, Thomas Brdariç i shkodranëve paguhet në muaj plot 427 mijë lekë në muaj.

**LISTA E RROGAVE TË EKIPIT TË VLLAZNISË**

| | | |
|---|---|---|
| Ardit Hoxhaj | 488,000.00 | Futbollist |
| Haris DILAVER | 475,000.00 | Futbollist |
| Erdenis Gurishta | 460,400.00 | Futbollist |
| THOMAS Berdaiç | 427,570.00 | Trajner futbolli |
| MEVLAN ADILI | 320,000.00 | Futbollist |
| VICTOR MATHEUS DA | 320,000.00 | Futbollist |
| ALEKSANDER ISAEVSK | 310,000.00 | Futbollist |
| Elom Kodjo NYAVEDJI | 301,000.00 | Futbollist |
| Milos KALEZIC | 101,000.00 | Futbollist |
| Eni Imami | 253,277.00 | Futbollist |
| Albion Avdijaj | 253,277.00 | Futbollist |
| Ardit Krymi | 250,000.00 | Futbollist |
| Herald Marku | 250,000.00 | Futbollist |
| Abdurrahman Fangaj | 250,000.00 | Futbollist |
| DEMIR IMERI | 250,000.00 | Futbollist |
| BOJAN ZOGOVIC | 240,000.00 | Futbollist |
| Arsid Kruja | 175,550.00 | Futbollist |
| Fjoart Jonuzi | 175,500.00 | Futbollist |
| Dajan Shehi | 162,500.00 | Drejtor në klube të futbollit |
| Matko Djarmati | 140,800.00 | Futbollist |
| Florind Bardulla | 125,000.00 | Futbollist |
| Salim CISSE | 103,700.00 | Futbollist |
| Nertil Hoxhaj | 100,000.00 | Futbollist |
| Uheld Hoxha | 100,000.00 | Futbollist |
| Arlind Kalaja | 95,000.00 | Trajner futbolli |
| Ideal Lekiqi | 90,000.00 | Drejtor në klube të futbollit |
| Arben Maliqi | 80,000.00 | Trajner futbolli |
| Safet Osja | 80,000.00 | Drejtor financiar i administratës |
| Denisa Domni | 72,000.00 | Trajner futbolli |
| Luan Zmijanej | 70,000.00 | Trajner futbolli |
| Elvis Plori | 70,000.00 | Drejtor në klube të futbollit |
| Qashif Hoxha | 60,000.00 | Jurist për administratë publike |
| Gëzim Selmani | 59,000.00 | Instruktor sportesh |
| Suad Lici | 57,000.00 | Trajner futbolli |
| Fatjon Hasanaj | 56,800.00 | Futbollist |
| TIM BRDARIC | 55,500.00 | Gazetar |
| Gjergj Kola | 55,000.00 | Nëpunës sporti |
| Alban Neziri | 55,000.00 | Futbollist |
| Kristi Qarri | 50,000.00 | [illegible] |

Ols Rama | 820,000.00 | Drejtor në klube të futbollit

LISTA E RROGAVE TË EKIPIT TË PARTIZANIT



Duhet veçuar fakti se te Vllaznia asnjë lojtar nuk merr pagën minimale sikurse në klubet e tjera, 30 mijë lekë në muaj. Madje këtë e bën edhe Partizani, klubi që ka njeriun më të paguar zyrtarisht në futbollin shqiptar. Bëhet fjalë për drejtorin e përgjithshëm, Olsi Rama. Vëllai i kryeministrit Edi Rama që drejton klubin e kuq paguhet plot 800 mijë lekë në muaj. Pas tij është presidenti Gazmend Demi, me statusin e administratorit që merr 600 mijë lekë në muaj. Në sy bie organigrama e Partizanit që është shumë më e zgjeruar se e klubeve të tjera duke treguar se janë korrekte në detyrimet ndaj qeverisë. Ndërsa ish-trajneri, Ilir Daja paguhej 152 mijë lekë, së bashku me ndihmësin e tij, Ilir Bozhiqi.

**DIFERENCAT, PAGAT STRATOSFERIKE TË SUPERIORES VS KATEGORIA E PARË**

Dihet që çdo ligë kryesore si në vendin tonë, por edhe në botë ofron kushte shumë herë më të mira se ato inferioret. Megjithatë hendeqet në Shqipëri mes kategorive janë të mëdha. Infrastruktura nuk diskutohet, por edhe pagesat janë shumë larg njëra-tjetrës. Në Superiore, ka futbollistë që kanë marrë rroga me shifra të çmendura. Rastet "Edgar Çani", "Ferhan Hasani" apo edhe "Ergys Kaçe" që kalojnë shumën e 100 mijë eurove në sezon. Ndërsa në Kategorinë e Parë, drejtuesit janë modestë dhe nuk i kalojnë kufijtë e të paimagjinueshmes. Pas publikimit të të dhënave, ku 670 mijë shqiptarëve u dolën në shesh pagat e tyre, ishte shumë e thjeshtë të shikoje diferencat mes elitës dhe kategorive inferiore. Asnjë lojtar nuk e kalon pagën minimale, 30 mijë lekë në muaj. Edhe pse gojarisht mund të ketë shifra të tjera, nëse drejtuesit nuk janë korrektë, gjykata njeh vetëm atë që është e shkruar. Kësisoj risku për të luajtur në Kategorinë e Parë, ashtu siç bëri edhe Ndriçim Shtubina është mjaft i madh.

LISTA E RROGAVE TË EKIPIT TË TIRANËS



**KRAHASIMI, FUTBOLLISTËT DHE TRAJNERËT E SUPERIORES ME TË KATEGORISË SË PARË**

Jo vetëm prestigji e bën Superioren më të lakmuar nga të gjithë protagonistët e fushës dhe të pankinës, por edhe pagesat janë të çmendura. Në Shqipëri rroga mesatare ka kapur shifrën e 40 mijë lekëve në muaj, ndërsa në elitën e futbollit shqiptar aq paguhen punëtorët. Duke iu referuar edhe një herë Ndriçim Shtubinës si kapiten i Egnatias, skuadër që u ngjit në elitë shihet se paga e tij ka qenë 30 mijë lekë në muaj. Ndërkohë, në ekipin e vendlindjes, te Vllaznia, kapiteni Erdenis Gurishta paguhej 460 mijë lekë në muaj. Pra, më shumë se 15-fishi i Shtubinës. Të luash në elitë, padyshim u bëke dhe i pasur me rroga të tilla. Për të




# KASTRIOTI, KRUTANËT "FSHIJNË" RROGAT NGA TATIMET

**Në hulumtimin e imtësishëm të bërë në tabelën e pagave që u publikua në fund të vitit të shkuar, rezulton se lojtarët e Kastriotit apo dhe pjesëtarët e stafit teknik nuk figurojnë në tatime. Vetëm Gazmend Vogli, si administrator i këtij klubi merr një rrogë prej 48 mijë lekësh në muaj. Ai figuron në bordoronë e Bashkisë së Krujës si nëpunës sporti. Nuk dihet se si krutanët kanë manovruar duke mos qenë pjesë e kësaj liste, pasi në Federatën Shqiptare të Futbollit mësohet se janë depozituar kontrata për gjithë futbollistët që janë pjesë e organikës. Megjithatë në listën e dalë nga tatimet për 670 mijë shqiptarë, askush veç Gazmend Voglit, nuk figuron si paga-marrës.**

vijuar sërish krahasimin, shohim trajnerët e dy skuadrave. Morëm si rast referues Egnatian, duke qenë se ishte skuadra që u ngjit në elitë. Pagat e publikuara nga Tatimet janë në prill të vitit 2021. Sipas kësaj tabele, Gashi i rrogozhinasve ka një pagë modeste që kap shifrën e 40 mijë lekëve në muaj. Njihet si një nga më punëtorët në kampionatin shqiptar, me karakter të fortë. Mesa duket pranimi i postit për të drejtuar Egnatian ka qenë një sprovë personale dhe tregoi që ia doli mbanë duke e sjellë mes më të mirave. Sakaq, homologu i tij në Superiore, Thomas Brdariç i Vllaznisë merr në muaj plot 427 mijë lekë. Në futbollin shqiptar, Magani është një nga emrat më të njohur me një përvojë të madhe, ndërsa Brdariç erdhi si një i panjohur. Por, të jesh pjesë e Superiores vlen 10-fish më shumë se Kategoria e Parë.

### ADMINISTRATORËT, GAZ DEMI I PARTIZANIT VS AGIM DEMROZI I EGNATIAS

Nëse përmendim emrat e Gaz Demit, president i Partizanit dhe Agim Demrozit, në krye të klubit të Egnatias, gjëja e parë që na vjen në mendje është respekti për këta dy biznesmenë





LEJONI VETES PRIVILEGJIN DUKE SHIJUAR LUKSIN DHE PRIVATËSIN MË UNIKE

PRIVILEGE
Hotel & Spa

Adresa:
Rr.Haxhi Dushku, pranë TEG, Tiranë

+355 69 704 0401

www.privilege.al
hotelprivilege.al

privilege.hotel
buddha.spa
buddha.spa

që kanë kontribuar në futbollin Shqiptar. Demi, prej vitesh po hedh paratë e familjes së tij te 16-herë kampionët e Shqipërisë, ndërsa Demrozi ka pak kohë që është bërë pjesë e futbollit shqiptar. Tashmë janë të dy pjesë e elitës, ndërsa në sezonin e shkuar, konkretisht në muajin prill, Partizani luante në Superiore, ndërsa Egnatia në të Parën. Referuar pagave të deklaruara në Tatime, shihet që të dy janë në statusin e administratorëve në klubet e tyre. Paga e Gaz Demit, pjesë e elitës kap shifrën e 600 mijë lekëve në muaj. Ndërsa e Agim Demrozit, që luante në Kategorinë e Parë ishte vetëm 50 mijë lekë në muaj. Çfarë diferencë e frikshme. Jo vetëm në nivele lojtarësh, por edhe drejtuesish, rrogat janë shumë të larta në Kategorinë Superiore.

**DREJTORËT, OLSI RAMA MILIONERI I FUTBOLLIT SHQIPTAR**

Gjithmonë ishte parë në tribunë duke ndjekur pranë presidentit Gaz Demi ndeshjet e Partizanit, por prej vitit 2017-të, Olsi Rama zgjodhi të kontribuonte zyrtarisht në futbollin shqiptar. Vëllai i kryeministrit Edi Rama, u emërua drejtor i përgjithshëm i 16-herë kampionëve të Shqipërisë. Ai mori përsipër të krijonte një klub modern i orientuar nga modelet europiane. Me bashkëpunëtorët e tij, në vitin 2019 fitoi titullin kampion me të kuqtë. Puna e tij duket se është shpërblyer edhe në bordorotë e klubit të Partizanit. Olsi Rama paguhet plot 800 mijë lekë në muaj, rrogë kjo e deklaruar në tatime. Drejtori i përgjithshëm i të kuqve është zyrtari më i paguar i kampionatit shqiptar. Në gjithë klubet e elitës apo edhe në Federatën Shqiptare të Futbollit, askush s'e ka pagën sa ai. Thirrjes së vëllait të tij kryeminister, për

**LISTA E RROGAVE TË EKIPIT TË EGANTIAS**

| | | |
|---|---|---|
| Agim Demrozi | 50,000.00 | Administrator |
| Gugash Magani | 40,000.00 | Trajner futbolli |
| Olsi Dranga | 40,000.00 | Drejtor në klube të futbollit |
| Klaudian Dervishi | 35,000.00 | Trajner futbolli |
| Gerim Bidaj | 30,000.00 | Mjek |
| Jackson Kenio Santos | 30,000.00 | Futbollist |
| Guilherme Silva | 30,000.00 | Futbollist |
| Marcos Matheus de r | 30,000.00 | Futbollist |
| Arjanit Ballhysa | 30,000.00 | Trajner futbolli |
| Ndriçim Shtubina | 30,000.00 | Futbollist |
| Eduart Tharteri | 30,000.00 | Trajner futbolli |
| Orjan Xhemalaj | 30,000.00 | Futbollist |
| Gerim Krasniqi | 30,000.00 | Futbollist |
| Klevis Murati | 30,000.00 | Drejtor në klube sportive |
| Endrien Magani | 30,000.00 | Futbollist |
| Rilind Juba | 30,000.00 | Shofer |
| Ildian Shyti | 30,000.00 | Futbollist |
| Jurgen Vogli | 30,000.00 | Futbollist |
| Artur Magani | 30,000.00 | Futbollist |
| Alked Çelhaka | 30,000.00 | Futbollist |
| Fadil Meta | 30,000.00 | Futbollist |
| Brixhild Brahimaj | 30,000.00 | Futbollist |
| Mario Tegja | 30,000.00 | Futbollist |
| Ilir Allmuça | 30,000.00 | Fizioterapeut |
| Fisnik Manushi | 30,000.00 | Futbollist |
| Klevis Hasanbelli | 30,000.00 | Futbollist |
| Xhonatan Lajthia | 30,000.00 | Futbollist |
| Bruno Puja | 30,000.00 | Futbollist |
| Oren Gashi | [illegible] | [illegible] |

**LISTA E RROGAVE TË EKIPIT TË DINAMOS**

| | | |
|---|---|---|
| Ermal Barushi | 50,000.00 | Administrator |
| MOUSTAPHA ENOCK | 30,000.00 | Futbollist |
| DIOGO ARMANDO LC | 30,000.00 | Futbollist |
| JOSE ANDRES SALAZA | - | Futbollist |
| DARIO DIAN | - | Trajner i atletikës |
| DAMIANO PONTRELI | - | Futbollist |
| MATTEO ORTOLANI | - | Futbollist |
| ANTONIO MICCOLI | - | Futbollist |
| WELBER ALMEIDA SA | - | Futbollist |
| Edvan Bakaj | - | Futbollist |
| Olsi Uku | - | Trajner futbolli |
| Miklovan Pere | - | Futbollist |
| Xhorxhian Boçi | - | Futbollist |
| Klaudjo Hyseni | - | Futbollist |
| Erald Kolgega | - | Futbollist |
| Artion Alillari | - | Futbollist |
| Elvi Bogdani | - | Futbollist |
| Emiljano Hidri | - | Futbollist |
| Ardit Jaupaj | - | Futbollist |
| Kevi Berberi | - | Futbollist |
| Plarent Fejzaj | - | Futbollist |
| Englis Kodra | - | Futbollist |
| Xhoel Plaku | - | Futbollist |
| Drilon Mati | - | Futbollist |
| Endri Reçi | - | Futbollist |
| Mateo Haxhillari | - | Futbollist |
| Mariglen Mhillaj | - | Futbollist |
| Kevin Fetishaj | - | Futbollist |
| Alesio Mija | - | Futbollist |
| LIBORIO FABRIZIO CA | - | Trajner futbolli |
| NICO PATERNI | - | Futbollist |

**LISTA E RROGAVE TË EKIPIT TË TEUTËS**

| | | |
|---|---|---|
| Edmond Hasanbelli | 50,000.00 | Administrator |
| Bobi Celeski | - | Sportist profesionist |
| Blagoja Todorovski | - | Sportist profesionist |
| Roni Gashi | - | Sportist profesionist |
| Florent Avdyli | - | Sportist profesionist |
| Iran Da Conceicao | - | Sportist profesionist |
| Bledar Hodo | - | Trajner futbolli |
| Renato Arapi | - | Sportist profesionist |
| Emilian Vila | - | Sportist profesionist |
| Stivi Frashëri | - | Sportist profesionist |
| Rustem Hoxha | - | Sportist profesionist |
| Mirban Gorenca | - | Ndihmës mjek i ndihmës së p |
| Albano Aleksi | - | Sportist profesionist |
| Aleksandros Kuro | - | Sportist profesionist |
| Fabjan Beqja | - | Sportist profesionist |
| Lorenco Vila | - | Sportist profesionist |
| Ildi Gruda | - | Sportist profesionist |
| Dejvid Kapllani | - | Sportist profesionist |
| Ledio Beqja | - | Sportist profesionist |
| Artan Jazxhi | - | Sportist profesionist |
| JACSON Ferreira Silve | - | Sportist profesionist |



# PAS FESTAVE SI TË DUKENI ORIGJINALË E TË BUKUR

Të gjithë janë të lodhur nga festat. Vajzat e gratë, pse jo dhe meshkujt, kanë nevojë në këtë muaj për t'u kujdesur për lëkurën e tyre. Dhe siç do të lexoni më poshtë, Comfort Zone, ka disa zgjidhje efikase për një lëkurë të butë, një pamje natyrale dhe ushqim të fytyrës suaj. Tani boll më i dhatë mbingarkesë stomakut, dhe lëkurës suaj me tualetin e veçantë në dhjetorin e festave. Duhet pak qetësi dhe pak ushqim për lëkurën. Ndaj, produktet e reja, mund t'ua japin zgjidhjen përfundimtare. E këtu, na hyjnë në punë këshillat e Comfort Zone

Vitet e fundit, dëshira për të ruajtur një pamje të freskët dhe të re si edhe prezantimi i shumë teknikave të reja minimalisht invazive me efekte natyrale ka bërë që të ketë një boom në kërkesën për trajtime estetike si fillers dhe botox.

Pritshmëritë nga produktet kozmetike janë rritur dhe këto të fundit konsiderohen si thelbësore për të mirëmbajtur bukurinë dhe shëndetin e lëkurës sonë. Njëkohësisht nga këto produkte pritet që efekti të jetë menjëherë i dukshëm, duke kërkuar në të njëjtën kohë që të plotësohen kriteret e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Për të garantuar efikasitet maksimal dhe për të ndjekur ritmet e kohës, [comfort zone] ka zgjedhur të rilancojë linjën anti-rrudhë të kujdesit për lëkurën .

TË GJITHA FORMULAT JANË TË PASTRA, të testuara dermatologjikisht edhe në lëkurat më të ndjeshme, të përshtatshme për veganët dhe ka deri në 99.5% të përbërësve me origjinë natyrale.

Linja garanton rezultate edhe më të dukshme që zgjasin edhe më shumë nëse ndiqet një rutinë e mirë e kujdesit në shtëpi që përfshin një fazë pregatitore për trajtimin me **MICROPEEL LOTION**, një locion fytyre i formuluar me 2.5% acid laktik dhe 2.5% glukonolaktone për mikro-eksfolim progresiv të përditshëm që i jep shkëlqim lëkurës dhe përmirëson teksturën e saj.

Kur lëkura ka nevojë për një trajtim të menjëhershëm, ampulat e reja **LIFT & FIRM AMPOULES** me Faktorët e Rritjes së Epidermës (EGF) dhe peptide, janë një zgjidhje shumë e mirë. Trajtimi zgjat një javë dhe ampulat përdoren çdo mëngjes e darkë.

Një tjetër rutinë intensive mund të arrihet edhe duke përdorur **PEEL PADS** si një trajtim mujor me tamponët e pambukut që ofrojnë eksfolim të dyfishtë mekanik dhe kimik me një kombinim të acidit laktik, glikolik, citrik dhe hialuronik.

Si pjesë e përpjekjeve të [comfort zone] për të rritur qëndrueshmërinë, një vlerësim i ciklit të jetës (LSA) është realizuar për linjën Sublime Skin, që ka bërë të mundur të llogaritet niveli i $CO_2$ i emetuar përgjatë ciklit të jetës së produktit dhe më pas e kompenson atë plotësisht falë projektit të ripyllëzimit dhe zhvillimit social Ethio Trees.

- PERFORMACA MAKSIMALE
- KËRKIM I RI SHKENCOR
- FUQIZIMI I ARCHI-LIFT TECHNOLOGY™
- TESTE EFIKASITETI
- PAKETIM INOVATIV
- FORMULA EDHE MË TË PASTRA, TË SIGURTA DHE TË QËNDRUESHME




- Pa silikone, derivate të kafshëve, vajra minerale, ngjyrues artificialë
- Aromë e re natyrale, me lule dhe femërore
- Tekstura me ngjyra me lëndë të para natyrale
- E përshtatshme për veganët
- Formulë dermatologjikisht e testuar

**SUBLIME SKIN INTENSIVE SERUM**

- SERUM PËR SHKËLQIM DHE BUTËSI
- LUFTON PLAKJEN QELIZORE
- EFEKT FILLER TEK RRUDHAT
- TENDOS LËKURËN NË MËNYRË TË DUKSHME, PËR KONTURE TË FYTYRËS MË TË THEKSUARA
- PËR TË GJITHA LLOJET E LËKURËS DHE KLIMAT



**EKSTRAKTI I PEONIAS RIMBUSH KONTURIN E FYTYRËS**

Stimulon transformimin e pre-adipociteve në adipocite

Mbron përbërjen lipide të fytyrës






## TRAJTIMET PROFESIONALE TE ORIENTUAR NGA REZULTATET, TESTE EFIKASITETI ZGJIDHJE SPECIFIKE, TË PERSONALIZUARA PËR TË GJITHA SHENJAT E MOSHËS

REZULTATE TE MENJËHERSHME
DHE EKSPERIENCË PREMIUM

1- SUPER PEEL peeling i personalizuar për lëkura delikate ose të maturuara

2- ULTRA GLOW PEEL për shkëlqim, kundra njollave

3- PRO-LIFT veprim mbushës, efekt filler natyral

## SI TË GJENI RUTINËN E DUHUR PËR JU?

Çdo lëkurë tregon një histori unike me SKIN TEST.
Prenoto një check-up të personalizuar tani!
Një teknologji koreane e cila realizon analizën e detajuar të lëkurës, me një ekran që zmadhon 50 herë për të parë problematika të ndryshme.

**ZBULO**

- PLAKJEN E LËKURËS
- OKSIDIMIN E LËKURËS
- SASINË E YNDYRËS
- THELLËSINË E RRUDHAVE
- HIDRATIMIN
- ELASTICITETIN DHE KOLAGJENIN
- FOTOTIPIN

Analiza bëhet nga specialistë të kozmetologjisë të cilët gjatë vëzhgimit arrijnë të kuptojnë cilat trajtime ju nevojiten e gjithashtu cila është rutina e duhur e kujdesit të lëkurës në shtëpi.

PRODUKTET E LISTUARA NË KËTË ARTIKULL
I GJENI TE DYQANI NEW LOOK TINA
TEK ISH-EKSPOZITA "SHQIPËRIA SOT"

ComfortZoneskin_al



# VIT I RI, STIL I'RI

Nga SUADA DACI

Është janar… përsëri ftohtë… Dita është e shkurtër, nata e gjatë dhe temperaturat e ulëta. (Pavarësisht se ne shqiptarëve na ka bekuar Zoti pasi temperaturat në këto ditë të para janari janë mbi 10 gradë celcius)…

Prandaj edhe në garderobën tonë duhet të ndihet një "detox" veshjesh dhe stili, për ta nisur Vitin me energji, e cila duhet të ndihet pse jo edhe në pamjen tonë të jashtme. Personalisht vij nga një mini udhëtim nga Kosova dhe e kam thënë gjithnjë me zë të lartë që vajzat dhe djemtë vishen më bukur se ne shqiptarët e Shqipërisë. Më pëlqeu shumë mënyra e kombinimit të disa detajeve tepër dimërore ( kambale bore) të ndërthurura me veshje mbrëmjeje, që për çudi i vë re edhe tek blogerët apo influencerët e Instagramit. E di që do më thoni se keni shpenzuar shumë për Krishtlindjet dhe Vitin e Ri, e ndoshta tani s'keni shumë buxhet për rinovim garderobe, poooorrr ka dy lajme të mira. E para në janar fillojë uljet drastike dhe e dyta mund të ricikloni apo miksoni veshjet e vjetra dhe të dukeni shumë stil. Në fund të fundit askush s'do ketë nerva të bëjë "scroll" deri në fund të fotove tuaja të vjetra në Instagram 😉😉





## VISHNI KËPUCË MALI ME FUNDE ME PALA

Fundet me pala nuk ikin kurrë nga moda, për më tepër që mund t'i veshësh në çdo stinë. E nëse do t'i shtoni edhe një palë këpucë të trasha dimri do ta bëni këtë veshje super komode, stil dhe mbi të gjitha s'do ndjeni kurrë të ftohtin… 🤷‍♀️





## HIQNI SHAJET E LESHIT DHE VENDOSNI ATO MËNDAFSHI

Një shall i hollë i lehtë rreth qafës do t'ju bëjë të dukeni më femërore. Nëse një shall të tillë do ta lidhni përreth qafës disa herë do të mbroheni nga i ftohti por do ta bëni veshjen tuaj të duket më shik dhe klasike.



## PELLUSHAT ME NGJYRA...

Thamë erdhi Vit i Ri, por jo se iku i ftohti. Ndaj dhe pellushat shumëngjyrësh janë shumë në modë këtë vit. Zgjidhni një pellush të gjatë me një palë xhinse dhe T-shirt dhe do të dukeni super "cool" dhe rehat. (Sidomos juve që s'ju mbledh shtëpia) 😌









## INVESTONI TEK GJËRAT BAZIKE

Përshembull një palë xhinse të zeza dhe një pulovër “oversize” kashmiri nuk duhet të mungojnë kurrë në garderobën tuaj. Ngjyrat bazike dhe veshjet e tilla po aq të thjeshta nuk të tradhëtojnë kurrë. Në ditët kur nuk jeni të frymëzuar për të bërë kombinime të çuditshme, me një veshje të tillë do të jeni në zonën tuaj të sigurt.

## MOS ANASHKALONI GJËRAT ME SHKËLQIM

Nuk duhet të jetë domosdoshmërisht mbrëmje për të veshur gjëra me shkëlqim. Këtyre pantallonave apo fundeve argjendi e floriri, mjafton t’i vishni sipër një pulovër oversize dhe do të dukeni bukur si për në punë, për “brunch” pse jo edhe për ndonjë takim më special...

## NGJYRAT

E nëse vdes për ngjyra (si unë) kurrë mos u mjafto dhe guxo. Me to veshja duket shumë stil dhe për më tepër këtë vit janë kryefjala e çdo fotografie, pasarele dhe garderobës të çdokujt që e adhuron modën.





## ZËVENDËSONI TË ZEZËN ME GRINË

Me pranverën në pritje mirë është që për ju që e adhuroni ngjyrën e zezë dhe që nuk guxoni të vishni ngjyra të ndezura, grija do të ishte zgjedhja perfekte. Ajo është një nga ngjyrat që i jep dritë dhe jetë veshjes suaj...



# VISHNI PIZHAMA NË RRUGË

Që prej vitit 2020 ky trend duket se po gjen gjithnjë e më shumë terren në garderobën tuaj. Pizhama mëndafshi me ngjyra, të zeza dhe të cfarëdolloj natyre nuk duhet të mungojnë në garderobën tuaj.



# BËNI KOMBINIME TË NJËJTA

Një nga trendet e këtij sezoni kanë qenë kombinimet e njëjta. Përshembull me të njëjtin material që keni xhupin mund të keni edhe çantën.





# JU PREZANTOJMË ME KËPUÇËT E 2022

Platformë, platformë, platformë... Vajzat “petite” po hidhen përpjetë nga gëzimi sepse me këpucët më “in” të momentit do të duken jo vetëm shumë stil por mbi të gjitha të gjata. Dhe Lori Hoxha është njëra prej tyre...



# NXIRRNI FUSTANET E VJESHTËS

Fustanët e gjatë të vjeshtës mund të na bëjnë punë edhe tani në dimër. Me xhaketa lëkurë apo edhe pulovra oversize ato ngjajnë një kryevepër. Mos harroni t’i shtoni veshjes edhe një palë çizme kauboj.

# QUIZBOMB



© COPYRIGHT

Nga KADRI VOKOPOLA

## KINOFJALËKRYQ



**HORIZONTALE**
**1.** Roger, që thirrej *Doctor Mirabilis.*
**5.** Janë gjitarë.
**9.** Brown i Kodi i Da Vinici-t.
**12.** Është vota në favor.
**13.** Një nderim i thellë.
**15.** Carol aktore.
**18.** Rrallë është përgjysmë.
**20.** Sheshi i akejve.
**22.** Tefta_Koço.
**25.** Lind në ekstreme.
**27.** Fillon nga lindja.
**29.** Ente Financiare Romë.
**31.** Janë të paralizuar në gjymtyrët e poshtme.
**35.** Qyteti i Aristotelit.
**37.** Aktorja në foto.
**38.** Kështu fillon motivi.
**39.** Një dru në gardh.
**40.** Aktori në foto.
**42.** Të parat në ambient.
**43.** Kështu fillon lidhja.
**44.** Parlamenti i Gjermanisë.
**46.** I ka tek thana.
**47.** Zaha që qe arkitekte.
**48.** Fare pa fe.
**49.** Inicialet e Cameron regjisor.
**51.** Është shpinë.
**52.** Rosberg që qe kampion i botës në Formula 1.
**54.** Është skuadra.
**55.** Kufizojnë rajonin.
**56.** Një mund të jetë autonom.
**57.** Ruhen në fund.
**58.** Tom Selleck.
**59.** Nëna e Perseut.
**60.** Morricone që qe kompozitor.
**61.** Inicialet e Spacey aktor.

**VERTIKALE**
**1.** Inicialet e Pasternak.
**2.** Është tokë buke.
**3.** John që qe saksofonist.
**4.** Inicialet e Nolte.
**5.** Në hyrje të sallës.
**6.** Titulli i Elton John.
**7.** Organizonte atentate në Spanjë.
**8.** Tirana East Gate.
**9.** Bo aktore.
**10.** Është mallkim.
**11.** Kështu fillon nata.
**14.** Një cocktail kuban.
**16.** Në krye të tabelës.
**17.** Ajo e Plumbit është në shkodër.
**18.** Emri i Amundsen.
**19.** Kështu thirren lojëtarët e përfaqseses së Zelandës së Re në rugby.
**21.** Shpiku makinën e parë llogaritëse mekanike.
**23.** Film i Sam Mendes.
**24.** Është një degë e teknologjisë që merret me studimin dhe përdorimin e temperaturave shumë të ulëta.
**26.** Shkronja e grykëderdhjes.
**28.** Egoyan regjisor.
**30.** Mercury që qe frontman i Queen.
**32.** Drejtohen në quiz.
**33.** Grupon pa çifte.
**34.** Janë të ndryshmet në janar.
**35.** Bie një me rrebesh.
**36.** Në hyrje të tunelit.
**41.** Kështu tregohet ai që nuk gabon.
**43.** Partia e Benjamin Netanyahu-t.
**44.** Nganjëherë nuk e vlen qiranë.
**45.** Qytet në Itali.
**47.** Ekstreme në hektar.
**50.** _dei që u themelua nga Escrivá de Balaguer.
**53.** Loach regjisor.









# MOJ E BUKURA SHQIPËRI!

**HORIZONTALE**

**1.** Një gjah në Afrikë.
**6.** Janë zana mali.
**10.** Kush ka... i ecën.
**11.** Immanuel filozof.
**12.** Inicialet e Asimov.
**13.** Erosi i romakëve.
**16.** Të parat në orkestër.
**17.** Kështu fillon romani.
**19.** Foto 1.
**22.** Është vendi në bjeshkë.
**25.** Ndahet pa det.
**27.** Regjisori i .
*Guess Who's Coming to Dinner.*
**28.** Foto 2.
**33.** Është dhëmbi i parë.
**34.** Marshi_ i Aida-s.
**36.** Foto 3.
**39.** Në krye të detyrës.
**40.** Janë klasat e njëjta.
**41.** Përvishen për punë.
**45.** Peter që humbi hijen.
**46.** Ndal në kufij.
**47.** Mbyllin portat.
**48.** Është edhe ai i detit.
**49.** Gjysmë erotik.
**50.** Fundi i një samurai.
**51.** Është lloj njeriu.
**53.** Mund të jetë e hollë dhe therëse.
**54.** Të parat në pistë.
**55.** Të parat në stafetë.
**57.** Ka stelit Umbriel.
**58.** Agolli që qe aktore.
**59.** Foto 4.
**60.** Është babai.

**VERTIKALE**

**1.** Lindi Isakun.
**2.** Mbyllin një dyqan.
**3.** Inicialet e Truffaut.
**4.** _de Janeiro.
**5.** Inicialet e Adjani.
**6.** Inicialet e Kokoschka-s.
**7.** Ente Kërkimore Autonome.
**8.** Gjysmë turneu.
**9.** Ai i rekordeve është Guinness.
**10.** Një autograf.
**11.** Janë aktorët për cabaret.
**14.** Një marrëveshje që nënshkruhet.
**15.** Kush i ngre... dorëzohet.
**17.** Ato lehtësuese mund të ndikojnë në uljen e dënimit.
**18.** Film shqiptar.
**20.** Upper East Side.
**21.** Nono Rota.
**23.** Pavarotti që qe tenor.
**24.** Qendër për roja.
**25.** Hoxha që qe këngëtare.
**26.** U shkrua nga Shakespeare.
**29.** Merret për të kërcyer.
**30.** Gjysmë efekti.
**31.** Është ishull i yni.
**32.** Organimza Lokale Has.
**35.** Janë figurat si metafora.
**37.** Ekstrene në sirtar.
**38.** E dashura e Hernanit.
**39.** Kështu fillon debati.
**40.** _Saint0-Germain në futboll.
**42.** Nasi shkrimtar.
**43.** Musk i SpaceX.
**44.** Është mosha më e bukur.
**45.** Carvalho i Manuel Vázquez Montalbán.
**52.** _art i Andy Warhol.
**55.** Sapo fillojnë.
**56.** Kështu fillon seanca.
**57.** Bujë në qendër.








## HARD SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| | 3 | | 7 | | 9 | | | |
| 6 | | 9 | 5 | | | | 2 | |
| | | | | | | 5 | | |
| 1 | | | | | 3 | | | |
| | 8 | 3 | 1 | | | | | 7 |
| | 1 | | | | | 7 | | 6 |
| | | 8 | 4 | 2 | | | 1 | |
| | 5 | | | | | | | 4 |

## MESATAR SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 8 | | 5 | | | 7 | |
| | | | 4 | | | | | 2 |
| 7 | | 3 | 6 | 9 | | | | |
| | 2 | | | 8 | | 7 | 3 | |
| | 7 | | | | 5 | | | |
| | | 6 | | | | | 1 | |
| 1 | | 2 | | | | | | |
| | | | | 3 | | | 5 | 8 |
| 8 | | | | | | | 4 | |

## I LEHTË SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 3 | 7 | | | | 9 |
| 2 | | | | | | | | 4 |
| | | 6 | | | | 5 | | |
| | 9 | | | 1 | 3 | 8 | | |
| | | | | | 8 | | | |
| | 5 | | | | | | | |
| | | | | | 4 | | | 6 |
| | 7 | | | 2 | | 4 | | |
| | | 8 | 9 | | 6 | 3 | | |



# KURIOZITETE

## PSE SHTËPIA E NJOHUR E AUTOMOBILËVE QUHET AUDI?

Sepse kjo shtëpi u themelua nga August Horch, mbiemri i të cilit në gjuhën gjermane do të thotë “dëgjo”. Sigurisht që themeluesi i saj donte që markës së makinës t’i vinte emrin e vet, por e kishte të pamundur, sepse në atë kohë ekzistonte një markë tjetër makine me të njëjtin emër. Kur po mundoheshin t’i gjenin një emër makinës, djali i njërit prej bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë e gjeti zgjidhjen. I sugjeroi që gjithsesi ai kishte mundësi që në një farë mënyre ti vinte markës emrin e tij. Kështu ai e përktheu mbiemrin e tij në latinisht, pra AUDI, që do të thotë pikërisht “dëgjo”. Ide që themeluesit August Horch i pëlqeu së tepërmi dhe nuk hezitoi aspak ta quante pikërisht AUDI



## PËRSE DEGA E MJEKËSISË PËR KAFSHËT QUHET VETERINARI?

Sepse kjo fjalë vjen nga latinishtja veterina, që do të thotë kafshë barre. Pra bëhet fjalë për kafshë pune, që zakonisht ishin kafshë të vjetra dhe të papërshtatshme për gara apo për luftë. Dhe duke qenë të vjetra ishin kafshë që sëmureshin më shpesh dhe sipas studiuesve, ishin pikërisht këto kafshët e para për të cilat njerëzit filluan t’i kuronin sipas parimeve të mjekësisë. Që këtej pra edhe dega e mjekësisë që merret me to u quajt veterinari.

# PËRGJIGJET

PËRGJIGJE **KINO**FJALËKRYQ




| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | B | A | C | O | N | ■ | S | I | S | O | R | E | T | ■ | D | A | N |
| | | | | | P | R | O | ■ | N | ■ | A | ■ | I | ■ | ■ | T | E | M | E | N | A |
| | | | | | ■ | A | L | T | ■ | X | ■ | R | R | A | ■ | A | G | O | R | A | ■ |
| | | | | | L | ■ | T | A | S | H | K | O | ■ | L | D | ■ | ■ | J | E | T | A |
| | | | | | E | F | R | ■ | P | A | R | A | P | L | E | G | J | I | K | E | T |
| ■ | S | T | A | G | I | R | A | ■ | E | M | I | L | Y | B | L | U | N | T | ■ | M | O |
| ■ | H | U | ■ | ■ | B | E | N | I | C | I | O | D | E | L | T | O | R | O | ■ | A | M |
| L | I | ■ | B | U | N | D | E | S | T | A | G | ■ | T | A | A | ■ | | | | | |
| I | ■ | H | A | D | I | D | ■ | A | R | ■ | J | ■ | J | C | ■ | O | | | | | |
| K | U | R | R | I | Z | I | ■ | K | E | K | E | ■ | E | K | I | P | | | | | |
| U | ■ | ■ | R | N | ■ | E | N | T | ■ | E | N | ■ | T | S | ■ | U | | | | | |
| D | A | N | A | E | ■ | ■ | ■ | E | N | N | I | O | ■ | ■ | K | S | | | | | |

PËRGJIGJE **MOJ E BUKURA SHQIPËRI!**

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | S | A | F | A | R | I | ■ | O | R | E | T | ■ | L | ■ | F | A | T |
| K | A | N | T | ■ | I | A | ■ | K | ■ | K | U | P | I | D | I | ■ | ■ |
| O | R | ■ | ■ | R | O | ■ | P | ■ | K | A | R | A | B | U | R | U | N |
| M | A | L | O | R | ■ | N | A | H | ■ | ■ | ■ | K | R | A | M | E | R |
| I | ■ | U | J | E | V | A | R | A | E | S | O | T | I | R | E | S | ■ |
| K | I | C | ■ | T | R | I | U | M | F | A | L | ■ | ■ | T | ■ | ■ | L |
| E | ■ | I | S | H | U | L | L | L | E | Z | H | E | ■ | ■ | ■ | D | E |
| ■ | P | A | R | A | L | E | L | E | ■ | A | ■ | L | L | E | R | E | T |
| P | A | N | ■ | N | L | ■ | A | T | ■ | N | I | V | E | L | I | ■ | R |
| E | R | O | ■ | A | I | ■ | T | I | P | I | ■ | I | R | O | N | I | A |
| P | I | ■ | S | T | ■ | S | ■ | ■ | O | ■ | U | R | A | N | I | ■ | R |
| E | S | M | A | ■ | V | E | L | I | P | O | J | A | ■ | ■ | A | T | E |

PËRGJIGJE **HARD SUDOKU**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | 4 | 5 | 2 | 3 | 1 | 6 | 7 | 9 |
| 2 | 3 | 1 | 7 | 6 | 9 | 4 | 5 | 8 |
| 6 | 7 | 9 | 5 | 8 | 4 | 1 | 2 | 3 |
| 9 | 2 | 4 | 6 | 7 | 8 | 5 | 3 | 1 |
| 1 | 6 | 7 | 9 | 5 | 3 | 8 | 4 | 2 |
| 5 | 8 | 3 | 1 | 4 | 2 | 9 | 6 | 7 |
| 4 | 1 | 2 | 3 | 9 | 5 | 7 | 8 | 6 |
| 7 | 9 | 8 | 4 | 2 | 6 | 3 | 1 | 5 |
| 3 | 5 | 6 | 8 | 1 | 7 | 2 | 9 | 4 |

PËRGJIGJE **MESATAR SUDOKU**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 9 | 8 | 3 | 5 | 1 | 6 | 7 | 4 |
| 6 | 1 | 5 | 4 | 7 | 8 | 3 | 9 | 2 |
| 7 | 4 | 3 | 6 | 9 | 2 | 5 | 8 | 1 |
| 5 | 2 | 1 | 9 | 8 | 4 | 7 | 3 | 6 |
| 3 | 7 | 4 | 1 | 6 | 5 | 8 | 2 | 9 |
| 9 | 8 | 6 | 7 | 2 | 3 | 4 | 1 | 5 |
| 1 | 5 | 2 | 8 | 4 | 7 | 9 | 6 | 3 |
| 4 | 6 | 7 | 2 | 3 | 9 | 1 | 5 | 8 |
| 8 | 3 | 9 | 5 | 1 | 6 | 2 | 4 | 7 |

PËRGJIGJE **I LEHTË SUDOKU**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 8 | 4 | 3 | 7 | 2 | 6 | 1 | 9 |
| 2 | 1 | 9 | 6 | 8 | 5 | 7 | 3 | 4 |
| 7 | 3 | 6 | 1 | 4 | 9 | 5 | 2 | 8 |
| 4 | 9 | 2 | 5 | 1 | 3 | 8 | 6 | 7 |
| 3 | 6 | 7 | 4 | 9 | 8 | 2 | 5 | 1 |
| 8 | 5 | 1 | 2 | 6 | 7 | 9 | 4 | 3 |
| 9 | 2 | 5 | 7 | 3 | 4 | 1 | 8 | 6 |
| 6 | 7 | 3 | 8 | 2 | 1 | 4 | 9 | 5 |
| 1 | 4 | 8 | 9 | 5 | 6 | 3 | 7 | 2 |

# HOROSKOP BOMB

## JANAR 2022

## DASHI

Pritet një periudhë përgjithësisht e mirë për të gjithë ju që i përkisni kësaj shenje, që gjithsesi jeni të tunduar për të hedhur një hap vendimtar, apo të ndërmerni një vendim për t'u shkëputur nga ndikimi apo varësia nga dikush. Ndikimi i dyshes Mars-Afërditë ju sjell energji pozitive, por nuk duhet që të shpenzoni shumë energji për probleme pa ndonjë interes të madh për ju. Jeta juaj semtimentale pritet të jetë mjaft interesante. Më shumë kujdes me shpenzimet.

## DEMI

Ndikimi i Uranit në shenjë do të jetë dominues përgjatë gjithë kësaj periudhe dhe për shkak të këtij ndikimi shumë prej jush do të jenë të paparashikueshëm, në një masë të tillë që do të venë në vështirësi edhe ata që punojnë për ju. Shpirti juaj i aventurës mund t'ju shtyjë të ndërmerrni iniciativa pa u menduar shumë gjatë, prandaj ju këshillohet të tregoheni më të matur. Raportet jo fort të qëndrueshme në planin sentimental mund të njohin zhvillime më pozitive.

## BINJAKËT

Edhe pse kuadri ujor është përgjithësisht pozitiv, ka diçka tek ju që hera-herës jua turbullon mendimet dhe në ndonjë rast bini pre e ndonjë dyshimi hamletian që mund t'ju mundojë për një farë kohe. Për fatin tuaj të mirë hyrja në shenjë e Mërkurit ju rikthen kthjelltësinë e qetësinë shpirtërore. Në planin sentimental raportet janë kryesisht normale, por për ata që janë single, një takim i rastit mund të shenjojë jetën tuaj me ndryshime rrënjësore.

## GAFORRJA

Megjithëse do të jeni nën ndikimin e yjeve të mirë, problemi juaj është se i merrni gjërat jo shumë serizosisht dhe është vërtet e vështirë për t'ju ndryshuar mendjen për t'ju bërë më fleksibël. Sidoqoftë natyra juaj e prirur për të biseduar edhe për të negociuar sa herë të jetë e nevojshme është aseti më i mirë që keni. Në përgjithësi fusha sentimentale karakterizohet nga monotonia, por sa më shpejt ta kuptoni se është momenti për të hapur një faqe të re aq më mirë është.

## LUANI

Nuk do t'ju mungojnë stimujt për të cilët keni shumë nevojë për aktivitetin tuaj të përditshëm, që vijnë edhe nga ndikimi i Marsit, çka do të bëjë që edhe rezultatet të mos vonojnë të vijnë. Për ata që kanë kohë që presin për një kthesë domethënëse në sferën profesionale do të keni më shumë se një mundësi për ta bërë. Në planin sentimental mund të keni ndonjë situatë disi të koklavitur gjatë kësaj periudhe, por i keni të gjitha aftësitë për ta kaluar pa ndonjë problem.

## VIRGJËRESHA

Pritet një muaj mjaft pozitiv për ju që i përkisni kësaj shenje, pasi do të jeni nën ndikimin e një Plutoni mjaft aktiv. Forca juaj e vullnetit dhe aftësia për të krijuar grup do të bëjnë që t'ia dilni mbanë edhe në situata të vështira. Megjithatë duhet të tregoheni më të matur në aspektin financiar, pasi e keni në natyrë që ta lëshoni dorën më shumë nga ç'duhet. Duket se do të jetë një periudhë mjaft interesante në planin e dashurisë. Një lidhje e re në horizont?

## PESHORJA

Një kuadër yjor shpesh i paqëndrueshëm do të bëjë që shumë prej jush ta kenë vërtet të vështirë të ruajnë ekuilibrat apo të mbajnë një pozicion të caktuar në raportet me të tjerët, prandaj edhe këshilla më e mirë për ju është të evitoni sa më shumë qëndrimet ekstreme. Qëndroni në pozita pritjeje, sidomos në dhjetëditëshin e parë, derisa situata të bëhet më e qartë. Si të gjithë edhe ju mund të keni ndonjë problem me partnerin, por dini ta kaloni me shumë elegancë.

## UJORI

*Prania e Saturnit në shenjë pritet të ketë një impakt të ndjeshëm tek të gjithë të lindurit e kësaj shenje që kanë në dorë një projekt të ri për ta vënë në jetë. Vetëm se duhet të hiqni dorë nga kujdesi i tepërt, lëvizjet shumë të kontrolluara edhe dyshimi në çdo hap që hidhni, sepse kur të arrini në destinacion ndoshta do të jetë shumë vonë. Megjithatë në fushën sentimentale gjithçka do të jetë e bukur, pasi keni mbështjen e Afërditës gjatë gjithë kësaj periudhe.*

## AKREPI

Merkuri dhe Saturni nga pozicioni i tyre tek Ujori kanë një ndikim shumë pozitiv, duke ju rritur kreativitetin nga njëra anë dhe duke ju forcuar vullnetin dhe besimin në forcat tuaja. Elemntë këto që mund të përbëjnë një garanci për të arritur objektivat tuaja. Në planin sentimental gjërat duket se do të shkojnë mirë, por ajo që mund t'ju cënojë në një farë mënyre qetësinë shpirtërore është ndjenja e superioritetit dhe protagonizmit edhe në raportet me partnerin.

## BRICJAPI

Vijon tranziti i Saturnit tek Ujori, çka do të thotë se do të jeni të privilegjuar në planin profesional. Parashikohen zhvillime interesante në këtë drejtim, gjë që do të bëjë që edhe ekonomia juaj të njohë një rritje të ndjeshme. Është një periudhë mjaft interesante edhe në planin sentimental, sidmos për ata që janë single dhe janë në kërkim të shpirtit binjak. Nga ana tjetër, nuk përjashtohet edhe ndonjë udhëtim romantik, sidomos në dhjetëditështin e dytë.

## SHIGJETARI

Duhet të keni kujdes sepse pozicioni i dyshes Jupiter-Neptun tek Peshqit mund të ketë ndikim në planin emotiv duke bërë të ndjeheni shumë të sigurtë në vetvete edhe atëherë kur duhet të tregoheni shumë të matur. Që qëndrim me këmbë në tokë do të jetë shumë i efektshëm e do të evitojë që me krahët e entuziamit të pavend të shkelni në dërrasë të kalbur. E njëjta gjë ju këshillohet edhe në planin sentimental. Mos u nxitoni t'i thoni "po" dikujt që s'e njihni mirë.

## PESHQIT

Nuk ka më kuptim të prisni akoma që gjërat të ndryshojnë për mirë në raportet me dikë, pasi kjo do të bëjë të humbni rastin për të rifilluar nga e para. Marrëdhëniet shumë të komplikuara me partnerin nuk mund të zgjidhen duke i lënë mënjanë në pritje të kohëve më të mira, por duhen zgjidhur një herë e mirë. Dhe për këtë duhet vendosmëri. Edhe në planin profesional duket se ka ardhur momenti të mendoni për një qasje të re. Pse jo edhe për një aktivitet të ri.

NEWSBOMB.al



# ABONOHU TANI!

REVISTË E PËRMUAJSHME POLITIKO-KULTURORE




ANALIZA
INTERVISTA
**INVESTIGIME**
KULTURË
SPORT
**DOSJET E KRIMIT**
**ARGËTIM**
POLITIKË

**PËR TË BËRË ABONIMIN KONTAKTONI:**

POSTA SHQIPTARE:

Cel: **+355 68 50 80 753**

REDAKSIA NEWSBOMB.AL KONTAKT:

Cel: **+355 69 67 32 020**

E-mail: **abonime@newsbomb.al**

**newsbomb.al** 191 532 FOLLOWERS **newsbomb.al** 42.2k FOLLOWERS **NewsbombAl** 2,909 FOLLOWERS